

## PROCESVERBAL

### SEANCËN E DREJTON KRYETARJA E KUVENDIT ZONJA JOZEFINA TOPALLI (ÇOBA)

(Seanca filloi në orën 11:00)

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 18.04.2013.

2. Projektligji “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë Rapiscan Security si koncesionar për financimin ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteniereve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (përgjegjës)

Relator: Igli Cara

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

3. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (përgjegjës)

Relator: Albana Vokshi

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

4. Projektligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (përgjegjës)

Relator: Sherefedin Shehu

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

## LEGJISLATURA VII - PROCESVERBAL - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 25 PRILL 2013

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;  
 - në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.  
 Koha e votimit

5. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave(përgjegjës)

Relator: Gjokë Uldedaj

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;  
 - në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.  
 Koha e votimit

6. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna’A dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’A ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit të Durrësit”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave(përgjegjës)

Relator: Ledina Aliolli

Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Luan Skuçi

Shprehet Komisioni i Jashtëm

Relator: Pulina Hoti

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.  
 Koha e votimit

7. Projektligji “Për ratifikimi i marrëveshjes Istisna’A dhe marrëveshjes së agjencisë Istisna’A ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për ndërtimin e seksionit Qukës – Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë – Korçë”

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (përgjegjës)

Relator: Iglj Cara

Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator:Astrit Bushati

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;  
 - në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.  
 Koha e votimit

8. Projektligj “Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, Grupimit të MORPHO dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”.

Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Gent Strazimiri

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;  
 - në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

## Koha e votimit

9. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”.

Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Fatos Hoxha

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

10. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829 “Për noterinë”, të ndryshuar”.

Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Paulina Hoti

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

11. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese”, të ndryshuar”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (përgjegjës)

Relator: Vath Tabaku

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

12. Projektligji “Për sistemin e pagesave”.

Shprehet Komisioni i Ekonomisë dhe Financave (përgjegjës)

Relator: Selami Xhepa

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

13. Projektligje “Për disa shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. (2 projekte) (vazhdon shqyrtimi në Komisionin e Ligjeve)

Shprehet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator:

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

14. Propozime për reformën parlamentare. (Projektvendimi “Për shtesa dhe

ndryshime në Rregulloren e Kuvendit”si dhe Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8550,datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, i ndryshuar”)

Shprehen bashkëkryetarët e grupit të punës, deputetët Jemin Gjana dhe Namik Dokle

Pyetje

Diskutime

Koha e debatit

*Sipas nenit 80, pika 2 të Kushtetutës, anëtarit të Këshillit të Ministrave “i jepet fjala sa herë që e kërkon”.*

*Pas përfundimit të diskutimeve:*

- në emër të grupit parlamentar të PS-së, z. Gramoz Ruçi, kryetar grupi;

- në emër të grupit parlamentar të PD-së, z. Astrit Patozi, kryetar grupi.

Koha e votimit

#### **Për votim:**

*1. Projektligj “Për nëpunësin civil”*

*2. Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”.*

15. Projektvendim “Për miratimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”.

16. Shqyrtimi i kandidaturave për vendet vakante në institucione.

#### **Jozefina Topalli – Mirëdita!**

Hapim seancën.

Për projektligjin e parë kanë regjistruar emrat nga opozita: Ilir Bejtja, Albert Çaçi, Edison Konomi, Ervin Koçi dhe Erion Braçe.

Në emër të Komisionit, zoti Cara?

*(Zoti Cara shprehet dakord.)*

Faleminderit!

Zoti Bejtja, urdhëroni!

**Ilir Bejtja – Mirëmëngjesi të gjithëve!**

Sot po kalojmë një koncesion të çuditshëm, dhënien e një shërbimi një kompanie private për skanimin e kontenierëve, mallrave apo

kamionëve, mjeteve, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Them i çuditshëm, sepse është praktikë unike. Në përgjithësi këtu na është thënë se po e bëjmë këtë gjë për përafrimin e legjislacionit tonë apo të procedurave me ato europiane. Cili vend i Europës e ka shërbimin e skanimit me koncesion? Ose cili vend i sistemit harmonizues të doganave e ka këtë shërbim me koncesion? Këto pyetje i kemi bërë edhe në komision, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Mos vallë kanë zgjedhur doganat europiane, të cilat janë të pranishme në doganën e Shqipërisë, të eksperimentojnë për herë të parë një risi kaq të madhe lidhur me kontrollin antikontabandë që bëhet në dogana dhe t’ia lënë këtë një kompanie private, duke hequr dorë nga e drejta që të ushtrojnë autoritetin e tyre, që u ka dhënë ligji dhe Kushtetuta? Në mënyrë absolute, jo.

E gjithë historia lidhet me një çmim prej 39 eurosh që do të paguhet për çdo mjet që do të skanohet, dhe me një përafrim që na u tha në komision, do të sjellë një të ardhur prej rreth 15 milionë eurosh në vit, e përkthyer në 15 koncesione shkon 200 milionë euro e ardhur për një ndërmarrje të huaj, e cila ka edhe autoritetin e prodhimit të këtyre pajisjeve. Pra, treg i garantuar, zinxhir vlere e mbyllur.

Nuk e di se ku mund të gjendet një mrekulli e tillë, një favorizim i tillë, që prodhuesit t’i jepet mundësia të prodhojë një skaner dhe të mos ketë nevojë ta shesë, ta vërë në punë direkt në doganat shqiptare, t’u marrë paratë bizneseve shqiptare nëpërmjet detyrimit që bën shteti, në këtë rast dogana, dhe biznesin ta ketë të garantuar.

Unë them se këta zotërinj, që kanë këtë koncesion, do ta hedhin kapelën mbi sy për 15 vjet dhe nuk do t’ia dinë nëse ka ose jo rëndësi se çfarë ndodh në biznesin e tyre, sepse është biznes i garantuar me të ardhura të shitura. Shërbimet koncesionare jepen me idenë që do të ndërtohet, do të investohet diçka, që më pas t’i shërbejë si e mirë publike atij që e ka dhënë koncesionin. Sa do të rrojnë këto pajisje? Sa kohë ka që është instaluar skaneri në portin e Durrësit? Sa herë është vënë në punë skaneri në portin e Durrësit? Punon sot? Na është thënë se nuk punon, sepse ka kosto të lartë. Mos vallë nuk punon, sepse është i prishur? Mos vallë nuk punon, sepse skanerat nuk rrojnë kaq shumë?

Këto përgjigje nuk na janë dhënë asnjëherë. I gjithë problemi qëndron në faktin se ne, nëse bëjmë biznese të tipit monopol, e kemi shumë të thjeshtë ta marrim atë bakshishin sipas formulës së sotme, nëpërmjet doganierëve, që janë bërë një armatë banditësh, duke bërë taksidarin në çdo kamion. Kështu e kemi shumë të thjeshtë. Zotëria merr 39 euro për çdo kamion, bën paratë në fund të vitit, na mbush zarfin dhe na i sjellë dhe ne nuk kemi pse të fëlliqemi, mbetemi zotërinj. Është një tarifë plus për të gjitha bizneset.

Në Shqipëri ka biznese që lëvizin një sasi të madhe kamionësh gjatë gjithë vitit. Shkojnë nga 200 deri në 300 kamionë. Në qoftë se ju bëni llogari shpenzimin që do të kenë, është rreth 7 mijë euro plus në vit. Pra, nuk e zgjidh problemin e korrupsionit. Na është thënë se tani e tutje nuk do të kemi nevojë për komunikime me euro-doganën, si nisen mallrat, që në fund të fundit është gjëja më e thjeshtë që mund të bëhet, por do t'i skanojmë të gjitha mjetet një për një dhe pastaj do të vendosim se cili prej tyre do të dalë me kod të kuq, që të kontrollohet, duke evituar kështu kalimin pa kontroll.

Në fakt, kjo do të ushtrohet vetëm në 5 pika doganore, ndërkohë që Shqipëria ka 5 herë më shumë pika doganore. Kur i kemi pyetur se si do të zgjidhet problemi në pikat e tjera, nëse do të shikojmë se kemi devijim të fluksit të mallrave, ata na thanë se do ta s'potojnë skanerin nga një pikë doganore tek tjetra. Me çfarë do të merremi më shumë? Do të merremi me instalim dhe çinstalim skanerash apo me kapje të korrupsionit në dogana? Ky do të vazhdojë të jetë një version i djemve të mirë, siç sillemi në dogana me njerëzit, që kanë licenca dhe nuk pranojnë të bëjnë korrupsion me shtetin. Në këto pika, ku do të vendosen skanerat, të themi: "ja, zotërinj, në Shqipëri nuk ka korrupsion, nuk hyn asgjë pa doganë". Ndërkohë që në doganat e tjera të tipit Tre Urat, apo dogana e Bllacës, apo dogana e Goricës, ku mezi kalohet, duken si dogana të vogla, se fatmirësisht e kemi lënë dhe rrugën pa rregulluar, bëhet nami. Kur të marrim vesh se atje fluksi është shumë i lartë, do të marrim mjetet t'i instalojmë dhe t'i çojmë në këto dogana. Më pas do t'i çojmë në një doganë tjetër.

Kjo do të jetë një lojë turpi, e cila nuk e zgjidh problemin. Përkundrazi, bën të mundur që herë pas here oficerët e doganës, drejtoritë e

doganave nëpër rrethe, të ushtrojnë presion ndaj tyre e t'u thuhet: "Shiko, nuk e ke sjellë gjobën! Kujdes, se ta solla skanerin, të lashë pa lekë!" Kjo është një histori që vazhdon në këtë shtet. Përveç kësaj i krijohet mundësia dikujt të majmet në kurriz të bizneseve me një tarifë jo pak të kripur prej 39 eurosh për çdo deklaratë doganore.

Me këtë shteti heq dorë nga të ardhurat, ashtu siç ka vazhduar të heqë dorë nga të gjitha të ardhurat që vijnë nga investimet publike, të cilat janë e drejtë e qytetarëve, ashtu siç kemi tentuar të privatizojmë shumë të mira publike, të cilat vazhdojnë t'i japin sot ekonomisë shqiptare të ardhura, të cilat përkthehen në investime në sektorët strategjikë dhe me rëndësi për vendin. Kështu po bëjmë edhe në këtë rast. Duket qartë që interesi është shumë i ulët, sepse këtu ne jemi mësuar që të kalojmë me dhjetëra koncesione të tilla. Në këta 4 vjet që kemi këtu në parlament gjëja e parë që ne bëjmë është të gjejmë një vend ku mund të vendosim një koncesion mbi pasuritë publike, mbi të drejtat publike, në mënyrë që të krijohet mundësi që dikush të fitojë para.

Pse duhet të vazhdojë kjo lloj historie? Kjo lloj historie duhet të vazhdojë për të ngritur një institucion, që tashmë është themeluar në dogana, korrupsionin pasiv dhe aktiv, i cili në mënyrë konstante deformon, shtrembëron si konkurrencën në treg, ashtu edhe lobimin që bën për të favorizuar biznese të ndryshme, duke krijuar monopole në Shqipëri.

Favorizimin e biznesit e bëjnë nëpërmjet çdo rregulli apo ligji që nxjerrin, duke filluar me koncesionin e parë të pullave fiskale dhe duke vazhduar më tej me ndryshimin e ligjit "Për akcizën", që iu dha kompetencë doganave, duke vazhduar më tej me shtrembërime tregu, ku këta të fundit sulmojnë firma të ndryshme që t'i dëmtojnë ato dhe të ngrenë në këmbë firma të cilat paraqiten më pranë biznesit, si dhe sjellje arbitrare të vazhdueshme dhe konstante ndaj bizneseve në dogana. Sot nuk ka një biznes të vetëm që të hyjë në doganë e të mos i dridhen gjunjët, pavarësisht nga mosha, pavarësisht nga kapitali, pavarësisht nga pastërtia me të cilën ata administrojnë biznesin, duhet të kenë një doganier, një avokat të tyre brenda doganës që ta ndiejnë veten komod. Çfarë do të bëhet me këtë skanim? Në qoftë se ju kujtohet, para disa kohësh u vendosën peshoret nëpër dogana. Atje

ishte një taksidar ordiner, i cili thoshte: “Më sill mua 200 lekë në dorë, ndryshe nuk të fus në peshore”. Më pas u vendos si detyrim që të futeshin patjetër në peshore. Vijonte varianti, që ai i peshores kishte edhe çelësin, me të cilin prishte peshoren. Po tani për skanerët, e njëjta gjë do të jetë? Nëse do të hysh në skaner, duhet të japësh ca lekë? Ti që do të hysh në skaner mos e vrit mendjen. Thjesht do të turbullojmë pak pamjen. Ti që do të hysh në skaner mos e vrit mendjen, se je yni. Kjo nuk është një histori që mund të vazhdojë dhe të jepet me koncesion. Është një detyrim që dogana t’i ketë të vetat këto shërbime. Nëse sot ajo nuk ka para, le t’i vendosin kur t’i gjejnë paratë. Ka kanale për të luftuar korrupsionin.

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Konomi!

**Edison Konomi** – Të nderuar kolegë!

Sot po diskutojmë në lidhje me dhënien me koncesion të shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe mjeteve të tjera, të cilat hyjnë apo dalin në kufijtë e territorit të vendit tonë.

Sipas raportit të paraqitur në komision, ky shërbim do të ofrohet në pesë pika doganore, nga të cilat vetëm 3 do të kenë mundësinë e skanimit të përhershëm, kurse dy të tjera do të jenë në shërbim operativ.

Sot në vendin tonë operojnë 20 pika doganore. Gjithashtu, është propozuar që çmimi i tarifës së shërbimit të jetë 39 euro për deklaratë. Kjo tarifë do të rrisë në mënyrë direkte koston e çdo deklarate doganore.

Një nga pikat e tjera, ku ju e mbështesni këtë koncesion, është edhe parandalimi i kontrabandës për mallrat e akcizës apo lëndët narkotike, armët e të tjera. A e zgjidh ky koncesion parandalim e kontrabandës, pasi, ashtu si ju e keni parashikuar, do të jenë tre skanera të palëvizshëm dhe dy të tjerë të lëvizshëm në bazë të flukseve? Kush e garanton që mallrat kontrabandë nuk do të devijojnë në pikat e tjera doganore të hyrjes dhe të daljes në Republikën e Shqipërisë? Çfarë është bërë deri më sot me këto mallra kontrabandë? Për fat të keq, vendi ynë shpeshherë është përmendur nga organet ndërkombëtare të specializuara në luftën kundër krimit dhe transporteve të paligjshme, si një vend me potencial në rritje në transportin e lëndëve narkotike apo edhe armëve.

A do të jetë i mjaftueshëm për të luftuar fenomenet e trafiqeve dhe korrupsionin vetëm montimi i këtyre skanerëve? Të gjithë mund ta japin përgjigjen. Në radhë të parë, duhet të rishikojmë strukturat tona dhe forcën e shtetit ligjor, në mënyrë që ai të funksionojë vërtet si i tillë. Duhet të kujtojmë se nuk është vetëm Partia Socialiste që ka denoncuar korrupsionin në dogana apo edhe në hallka të tjera, por edhe dhomat tregtare, si ajo amerikane apo gjermane. Përfaqësuesit e këtyre dhomave kanë shprehur shpeshherë shqetësimin e tyre në lidhje me çështjen e korrupsionit. Pikërisht ky fakt e bën korrupsionin në dogana një problem madhor, pasi ai ndikon ndjeshëm në uljen dhe frenimin e investimeve të huaja, sidomos të atyre kompanive serioze, të cilat presin një ambient ku të dominojë ligji.

Ne disponojmë ligje të mira, të cilat përputhen me standardet europiane, por problemi ynë është moszbatueshmëria e tyre. Është për t’u theksuar se raportet e institucioneve ndërkombëtare, si DAVOS apo edhe Banka Botërore, e cilësojnë korrupsionin si një nga faktorët më problematikë të biznesit në Shqipëri.

Për këtë arsye, do të theksoja edhe një herë, se është shteti ligjor me strukturat e tij, që do të bëjë të mundur luftën ndaj trafiqeve dhe korrupsionit. Por, për ju shteti ligjor mbetet vetëm një togfjalësh në fjalor dhe asgjë më shumë. Çdo qytetar shqiptar në këto 8 vjet ka parë se si e përdorni ju të ashtuquajturin shtet ligjor, duke favorizuar klientët tuaj dhe duke goditur biznesin e ndershëm. Të mos harrojmë se ishte ky shtet ligjor, i cili mori vendimin e turpshëm të shkatërrimit të institucionit të zgjedhjeve, duke shkarkuar dhe emëruar anëtarë të KQZ-së persona vetëm për interesa personale elektorale. Ishte ky veprim, i cili e vuri edhe një herë tjetër Shqipërinë në qendër të vëmendjes së organeve ndërkombëtare dhe vendeve partnere të saj. Kjo, jo për arritjet e saj në luftën kundër trafiqeve dhe korrupsionit, por për mënyrën e vetme që dinë të bëjnë këta pushtetarë për të vendosur nën kontroll institucionet e pavarura. Ishte ky veprim, i cili komprometoi edhe një herë tjetër ligjshmërinë e institucioneve të pavarura në vend dhe prishjen e imazhit të Shqipërisë, duke treguar edhe një herë se interesat politike personale vijnë përpara nevojave të vendit.

Ne mund të diskutojmë për përmirësimin e pikave tona të kontrollit doganor, por do të jetë forcimi i strukturave në shërbim të shtetit dhe jo të pushtetit, që do ta bëjë vërtet ndryshimin.

Po në lidhje me luftën kundër trafikëve: duke qenë se ky është një fenomen permanent, përse studimi që na paraqitet sot nuk është bërë më parë nga ju, qoftë nga administrata doganore apo nga strukturat e specializuara në luftën kundër trafikëve? Kjo vjen si pasojë e studimit të një kompanie private. Të mos harrojmë se të ardhurat e këtij koncesioni, minimalisht, duke mos llogaritur rritjen natyrale ndër vite të import-eksporteve, arrijnë në 180 milionë euro, ashtu siç u raportua edhe në komision.

Gjithashtu, u vu theksi se këta skanera do të menaxhohen nga punonjës të kompanisë, pasi ne nuk kemi burime njerëzore në administratën doganore, të specializuara për të lexuar imazhet. Personalisht, mendoj se ne kemi kapacitete. Falë trajnimeve profesionale, ky shërbim mund të kryhej edhe nga administrata jonë doganore, siç ndodh në të gjithë Europën. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave në komision deklaruan se në bazë të të dhënave që ministria dispononte gjatë kohës së shqyrtimit, kur u bë studimi lidhur me këtë projekt, rezultoi se asnjë nga vendet e Europës nuk e ka të koncesionuar këtë shërbim. Pra, nuk është i koncesionuar te një subjekt privat, por i mirëkontrolluar nga administrata doganore.

Ne jemi pro si ndaj shërbimeve, që do të përmirësonin shërbimin ndaj subjekteve private, si një detyrim që kemi ndaj tyre, ashtu edhe përmirësimin dhe kontrollin më të mirë të pikave tona doganore, duke shmangur, parandaluar dhe goditur në këtë mënyrë, me masa efektive trafikët e paligjshme, evazionin fiskal, si dhe korrupsionin në pikat doganore. Gjithashtu, duhet të vlerësojmë edhe kapacitetet tona për ofrimin e këtyre shërbimeve, për të pasur nën kontroll kostot e këtyre shërbimeve apo duke vlerësuar përfitueshmërinë e tyre, në mënyrë që të shmangen abuzimet.

Pas 23 qershorit, me qeverisjen e Partisë Socialiste, duke u dhënë vendin e merituar profesionistëve në drejtimin e strukturave shtetërore dhe duke shtrirë bashkëpunimin me partnerët tanë ndërkombëtarë, duke shfrytëzuar në mënyrë më të efektshme mundësitë që ofron teknologjia, të jeni të sigurt se kontrolli doganor,

dhe jo vetëm ai, do t'u afrohet standardeve europiane, duke rikthyer përgjegjshmërinë dhe sigurinë e pikave tona doganore në luftën kundër trafikëve.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Urdhëroni, zoti Koçi!

**Ervin Koçi** – Të nderuar kolegë!

Çështja që po diskutojmë, miratimi i kontratës koncesionare për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera, është një tjetër veprim abuziv i Kryeministrit në ikje, duke dëmtuar interesin publik dhe duke rritur ndjeshëm kostot e biznesit në dogana.

Dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit doganor, është një biznes i pastër qeveritar, duke i vënë një gjobjë prej 39 euro çdo kontejneri dhe automjeti që hyn dhe del në pikat doganore të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas qeverisë dhe relacionit që ajo ka paraqitur, e gjitha kjo do të shërbejë për të shmangur në raportimin e deklaratave doganore, dhe do të parandalojë kontrabandën, kryesisht atë të produkteve të akcizës, të lëndëve narkotike, të produkteve të dëmshme, të armëve dhe municioneve, pasi ka qenë një shqetësim shumë i madh i qeverisë.

Sipas përfaqësuesve të qeverisë në komision, administrata doganore është e paaftë dhe nuk ka kapacitetet e duhura për të kryer këtë shërbim.

Nëse qeveria e ka pasur kaq shqetësim kontrollin nëpër dogana për shmangien e evazionit, përse nuk e ka marrë vetë iniciativën më përpara, por ia ka lënë kompanisë që ta kërkonte këtë shërbim? Por, si çdo koncesion që ka dhënë kjo qeveri në 8 vjet, edhe ky është një propozim për ta bërë ciklin e një veprimi abuziv më të plotë. Ka qenë vetëm një kompani që ka marrë pjesë në këtë procedurë, ajo që ka bërë kërkesën që ky shërbim të jepet me koncesion.

Sipas vetë Ministrisë së Financave, nuk ka asnjë eksperiencë europiane në koncesionimin e këtij shërbimi. Asnjë vend në botë nuk e ka me koncesion këtë shërbim. Si ka mundësi, kur në asnjë vend tjetër ky shërbim nuk jepet me koncesion, kompania më e madhe e prodhimit të skanerëve, i kërkon qeverisë shqiptare të marrë shërbimin e kontrollit doganor me koncesion? Cila është arsyeja që nga 200 shtete, kjo

kompani përzgjedhi Shqipërinë për koncesion? Nga e kishte siguruar kjo kompani këtë informacion për vendin tonë, që, për hir të së vërtetës, është një treg me pak transaksione tregtare krahasuar me vende të tjera? Nuk është një treg atraktiv për kompanitë lider në botë. Dalin edhe shumë pyetje të tjera, por përgjigjet të çojnë qartësisht tek ajo që dhënia me koncesion është një biznes i qeverisë në ikje ose një nder që qeveria i bën ndonjë kompanie lobuese të qeverisë, e cila punon për të mbrojtur imazhin e Kryeministrit nga bëmat e tij antiligjore, por që është kundër interesit të tij publik.

Kolegët e djathtë në komisionin e mbronin se është një kompani amerikane dhe nuk duhet kundërshtuar. Po përse, kur partneri ynë strategjik, SHBA-ja flet për mbajtjen e zgjedhjeve të lira e të ndershme, qeveria nuk e dëgjon dhe ju deputetët heshtni? Pse, kur partneri ynë strategjik, ju kërkoi publikisht të mos ndryshoni anëtarin e KQZ-së, Kryeministri në ikje jo vetëm nuk e dëgjoi, por i bëri edhe karshillëk kërkesave të tyre? Pse kur partneri ynë strategjik deklaroi publikisht se cenimi i standardeve ndërkombëtare, që po u bëhet zgjedhjeve, do të sjellë kosto të larta për Shqipërinë dhe do të ketë pasojat të pariparueshme për vendin, pushteti që qëndron në këmbë me vota të blera, nuk i merr parasysh?

Kur qeveria bën biznes për një interes personal, ju pëlqen të mbroheni, duke thënë se është kompani amerikane, pavarësisht se dëmton interesin publik, si atëherë kur privatizuat shoqërinë ARMO, kur përmendnit çdo ditë që është një shoqëri amerikane, si me përrallën e Albpetrolit apo për Lotarinë Kombëtare, që është kompani austriake, por që realisht është një biznes i klientëve pranë pushtetit.

Kur përpiqeni të formoni vullnetin popullor nuk e dëgjon partnerin strategjik. Kur vidhni Shqipërinë nga fillimi në fund, përmendi se janë interesuar kompani, që e kanë selinë te partnerët tanë strategjikë. Ishte kjo qeveri në ikje që dha me koncesion shërbimin e kolaudimit të automjeteve. Tarifa e shërbimit është rritur 3 herë.

Ishte ky Kryeministër në ikje që dha me koncesion administrimin e pullave fiskale të mallrave të akcizës dhe rriti tarifën e shërbimit me dhjetëra herë, tarifa më e lartë në të gjithë Europën. Është ky pushtet në ikje që po jep me

koncesion markimin e karburantit dhe që do të rrisë çmimin e naftës edhe me 100 lekë të tjerë. Tani vini me një propozim për koncesion, për shërbimin e kontrollit në doganë, që për herë të parë në të gjithë botën aplikohet në Shqipëri, me një afat për 15 vjet. Një biznes ky që u shkakton qytetarëve shqiptarë 300 milionë euro dëm.

Shkoni qeveritarë dhe pyesni në vendet e rajonit se si administrohet ky shërbim. Cilat janë tarifat. Do të shikoni që shërbimi doganor i kontrollit administrohet nga vetë doganat dhe biznesi nuk paguan asnjë lek. Pyesni në Greqi apo në Itali! Kurse në Shqipëri çdo automjet, çdo kontenier që hyn dhe del, që ka vlerë mbi 1000 euro do të pagujë 39 euro.

Kjo është qeveria që trumbeton nga mëngjesi në darkë se jemi vendi me taksat, tatimet e tarifat më të ulëta në Europë, por që sipas *Doing bussines*, jemi të 160-ët në botë. Për më tepër, justifikimi i qeverisë se do të luftojë evazionin fiskal bie, sepse ky shërbim do të jetë vetëm në 5 pika doganore kufitare, nga 20 që ka Shqipëria.

Mallrat që janë objekt i evazionit, i veprimtarisë kriminale do të shmangen nga këto pika doganore, ku do të bëhet skanimi dhe do të shkojnë drejt 15 pikave të tjera. Pra, justifikimi juaj se kjo bëhet për të mos pasur kontrabandë dhe evazion fiskal apo trafikë të paligjshme, nuk qëndron. Këto janë thjesht justifikime, pasi realisht ju po krijoni një biznes të ri qeveritar, duke dëmtuar biznesin dhe duke ngritur koston për qytetarët, siç po dëmtoni vendin me veprimet tuaja për KQZ-në.

Sali Berisha refuzoi mesazhet e parterëve tanë ndërkombëtarë, kërkesat e tyre për të mos cenuar pavarësinë e KQZ-së. Kryeministri në ikje nuk dëgjon zërin dhe shqetësimin e partnerëve strategjikë të Shqipërisë për zgjedhje të lira dhe të ndershme, por në emër të tyre, duke përdorur bizneset që kanë selitë në këto vende partnere, bën biznes për oborrin e pushtetit të tij.

Uzurpimi i KQZ-së dhe plaçkitja e Shqipërisë janë veprime tipike për një sundimtar që është në fundin e tij. Është fundi i një regjimi kundër interesit të Shqipërisë dhe shqiptarëve, kundër vetë partnerëve tanë strategjikë, që po përdor çdo mjet për të qëndruar në pushtet pas 23 qershorit.

Manovrat e paligjshme të Saliut nuk kanë asnjë shans të ndryshojnë fatin e zgjedhjeve.



Asgjë nuk e ndal dot popullin në vendimin e vet sovran. 23 qershori do të jetë një fitore, që do të largojë pushtetin familjar të Kryeministrit në ikje dhe do të krijojë mundësinë për të rishikuar çdo koncesion që ka dëmtuar interesin publik.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Urdhëroni, zoti Braçe, në emër Grupit Parlamentar të PS-së!

**Erion Braçe** - E nderuar, zonja Kryetare!

Natyrisht që edhe ky projektligj që kemi përpara, që ratifikon këtë kontratë koncesionare, është në vazhden e një serie koncesionesh të miratuara gjatë tre muajve të fundit, por ka në thelb filozofinë tashmë të shprehur gjerësisht, aksionin më të madh Sali Berishës, Kryeministrit të vendit, për të ndërtuar apo për të tjetërsuar, në radhë të parë, një atdhe publik dhe për ta kthyer atë në një atdhe privat.

Natyrisht që e nisi me pasuritë kombëtare, njëra pas tjetrës, në seri, duke i dhënë me koncesion dhe ku përfitimet e publikut, të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, të drejtpërdrejta apo në buxhetin e shtetit janë thuajse minimale. Përfitimet e privatëve janë ato që bëjnë diferencën dhe që po pasurojnë në mënyrë dramatike një grusht kompanish private apo edhe drejtues të tyre, patjetër edhe klientë të tyre, duke filluar nga Kryeministri i vendit e me radhë për çdo seksor që negocion këto kontrata koncesionare.

Por ajo që është më e rëndë ka të bëjë me koncesionimin në seri të një sërë shërbimesh publike, të cilat qeveria ka detyrimin t'ua ofrojë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë duke bërë edhe politikë sociale. Kjo gjë nuk po ndodh dhe e shoqëruar në procedurë me një sërë mangësish të tjera, përbën dëmin më të madh që po i bëhet këtij vendi në fund të një mandati 8-vjeçar qeverisjeje.

Po t'i referohemi kontratës vërejmë të gjithë problematikën që ne kemi konstatuar në vijimësi gjatë 8 vjetëve, apo posaçërisht gjatë 4 vjetëve të fundit në të tilla raste të koncesionimit të shërbimeve që duhet të mbeten publike.

Së pari dhe mbi të gjitha, vazhdon procedura e koncesionimit përmes praktikës së propozimit të pakërkuar. Pra nuk është qeveria ajo që ka identifikuar koncesionin, por një kompani private, e cila ia paraqet këtë qeverisë si një biznes të mundshëm e fisibël të saj. Pastaj vijojnë me radhë të gjithë elementet e tjera që e

pasojnë: bonusi, mungesa e konkurrencës në tender, siç është edhe rasti në fjalë, dhe natyrisht dhënia e këtij shërbimi në kushte monopol. Ky nuk është i vetmi. Për më tepër shërbimi është i garantuar, sepse me detyrim çdo tregtar që merret me importin apo eksportin e mallrave, që i drejtohet një dogane të Shqipërisë, do të paguajë 39 euro për çdo kontenier apo kamion që do të fusë apo nxjerrë nga Shqipëria me mallra. Duke qenë me detyrim është një biznes monopol i garantuar për kompaninë që do ta marrë me këtë kontratë që ne po miratojmë sot në Kuvendin e RSH-së. Nuk janë pak. Për 15 vjet koncesion do të shkojnë mbi 250 milionë euro në xhepat e kompanisë, para që do t'i paguajnë drejtpërdrejt tregtarët në doganë dhe pastaj do të mbarten mbi kurrizin e qytetarëve të RSH-së. Ata do të jenë të fundit që do të paguajnë këto shpenzime, që ne po ia japim si biznes të garantuar monopol një kompanie të vetme.

Natyrisht që nuk është rasti i vetëm. Ju fola pak më parë për të gjithë praktikën e koncesionimit që po vjen në Kuvend. Po vijnë në seri, e përsëris, zëre se po vijnë me breshëri automatike, njëra pas tjetrës, në fund të mandatit.

U fillua me koncesionin e shërbimit të kontrollit të automjeteve. Ishte monopol. Ne insistuam këtu në sallën e Kuvendit që të paktën të mos ishte në kushtet e monopolit, por të garantonte konkurrencën me qëllim që të kishim shërbim më cilësor dhe çmime më të mira për qytetarët e RSH-së. Sot, pas 3-4 vjetësh të funksionimit të këtij koncesioni, çmimi është rritur nga 6 mijë lekë në 18 mijë lekë për çdo makinë dhe, natyrisht, të ardhurat për koncesionarin vazhdojnë të shtohet. Llogariteni këtë shumë në 370 mijë makina që i nënshtrohen kontrollit teknik të tyre dhe del një shifër që shkon nga 15 milionë në vit dhe për 10 vjet shkon në 100 milionë euro, pavarësisht se koncesioni ka një afat më gjatë së sa kaq.

Vazhdojmë me koncesionin tjetër, me atë të pajisjes me kasë fiskale dhe të mirëmbajtjes së saj. Pavarësisht se në fillim nisi si monopol, u tentua vetëm tani të liberalizohet. Pyetini tregtarët: Është apo nuk është monopol? Ka përfunduar vetëm në duart e dy kompanive apo jo? Dhe nuk janë pak të ardhura: 340-450 euro kushton kasa, 48 mijë lekë bën kontrolli, 22 mijë lekë bën abonimi i kartës SIM dhe 24 mijë lekë është kostoja e mirëmbajtjes. Urdhëroni se çfarë

shifre dramatike shkon te biznesi nga ky koncesion dhe më së fundi përfundon te qytetari!

E vazhduat me koncesionin tjetër, atë të pullave fiskale. Kemi qenë këtu, në sallën e Kuvendit, kur ju kemi argumentuar se çmimi i pullave fiskale do të rritej nga 5% në 13%. Ashtu ndodhi. Është fakt i kryer, të gjithë e paguajnë në bizneset e tyre, por është konsumatori që e paguan i fundit këtë kosto. Për 10 vjet të ardhurat arrijnë në 140 milionë të tjera.

E njëjta gjë ndodhi me koncesionin e pasaportave. Do ta diskutojmë më pas, se vjen edhe ai si koncesion i ri për 5 vjet të tjerë, pikërisht kur nuk ka përfunduar dhe kur ju duhet t'i ktheni shërbimet që u ka bërë. Do të flasim edhe për të më pas. Për 5 vjet, me një xhiro vjetore prej 50 milionë eurosh, bëhen 250 milionë euro të tjera nga pasaportat.

Është edhe koncesioni tjetër, që keni miratuar në qeveri dhe po prisni ta sillni në parlament, atë të markimit të karburanteve, gjithashtu monopol. Edhe atje do të shkojnë gati 150 milionë euro.

Pra, për 5 vjetët që kaluan, 10-15 vjetët që do të vijnë, që përbëjnë afatin e këtyre koncesioneve, qytetarët e RSH-së do të paguajnë gati 1 miliard euro, thjesht dhe vetëm që të bëjnë biznes disa kompani që, për fat të keq, me përjashtim të këtyre të kasave fiskale, të gjitha janë të huaja dhe vetëm do të marrin para në këtë vend.

Ky është shqetësimi që kemi ne. Natyrisht në vijim të një praktike që na keni sjellë ju, por që është praktika themelore që ka udhëhequr këtë qeveri në koncesionimin qoftë të pasurive kombëtare, qoftë të shërbimeve publike që duhet të ofrohen për qytetarët e RSH-së, monopol i pastër, me tarifa të rregulluara në rritje, të vendosura nga ju dhe të shtrenjta për qytetarët e RSH-së.

Po e përsëris edhe një herë, janë mbi 1 miliard euro që paguajnë qytetarët e RSH-së pa asnjë shkak, pa asnjë përmirësim të shërbimit dhe, natyrisht, pa asnjë përfitim të tyre të drejtpërdrejtë, ata thjesht nxjerrin para nga xhepat e tyre, para që largohen nga ky vend në formën e fitimeve që marrin kompanitë koncesionare.

Do të ishte plotësisht e udhës që këtë koncesion, ashtu si në të gjitha vendet e Evropës, ta mbante qeveria e RSH-së. E përmendën

kolegët e mi edhe në Komisionin e Ekonomisë se nuk ka asnjë përvojë tjetër në vendet e BE-së, ku ne duam të shkojmë, të koncesionimit të këtij shërbimi, ashtu siç ishte edhe për pullat fiskale. Nuk na dëgjuat. Ecët përpara, sepse kjo është filozofia juaj, shndërrimi i atdheut publik të shqiptarëve në një atdhe privat vetëm të disa personave, të cilët po përfitojnë në mënyrë dramatike duke rrjepur qytetarët e RSH-së ditë për ditë, javë për javë, muaj për muaj, vit për vit, për 8 vjet që kaluan dhe për 15 vjet të tjera që do të vijnë, për aq kohë sa ju vazhdoni të pretendoni se këto kontrata nuk mund të revizionohen, nuk mund të përmirësohen apo nuk mund të anulohen.

Kjo praktikë duhet të marrë fund. Atdheun kthejuani shqiptarëve. Në rast se nuk e bëni ju, do ta bëjmë ne. Atdhe të pesë biznesmenëve privatë nuk mund të ketë në këtë vend. Atdheu duhet të jetë publik dhe duhet të jetë i shqiptarëve, të cilët duhet të marrin shërbime me kosto të lirë në këtë vend.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** - Faleminderit!

Në emër të grupit të PD-së, zoti Ministër, urdhëroni, keni fjalën.

**Ridvan Bode** - E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë!

Projektligji që sjellim sot ka të bëjë me miratimin e një kontrate për kontrollin doganor me një nga kompanitë më të mëdha në botë në prodhimin e teknologjisë së imazherisë, siç është "Ratiscan", dhe që ka një rrjet gjithnjë në përhapje në të gjithë botën, edhe për këtë çështje që kemi sjellë sot, që ka të bëjë me kontrollin doganor përmes imazherisë së prodhuar me rreze X.

Atdheu duhet t'u kthehet shqiptarëve dhe t'ua heqim nga duart trafikantëve, kontrabandistëve dhe evazorëve. Kjo ka qenë një strategji e qeverisë aktuale, e filluar shumë vite më parë, për të koncesionuar një sërë pasurish kombëtare, në mënyrë që të përdorëshin ato në interes të kombit, në interes të ekonomisë së vendit dhe, po ashtu për të koncesionuar një sërë shërbimesh publike, të cilat do të shoqëroheshin me ulje të kostove, me ulje të çmimeve që paguajnë qytetarët dhe bizneset dhe me rritje të efikasitetit të këtyre shërbimeve në raport me qytetarët, me ekonominë dhe me interesat kombëtare e perspektive të vendit.

E deklaroj përpara Parlamentit me kënaqësi shumë të madhe faktin që mundësuar në sektorin fiskal të koncesionojmë disa nga pikat më nevralgjike për të luftuar evazionin, kontrabandën dhe korrupsionin e administratës. Xhiron e bizneseve nuk e caktojnë më taksidarët, por kemi një gardian, që është pajisja elektronike fiskale, kasa regjistruese, e cila raporton çdo minutë *online* dhe llogarisin xhiron që bën çdo biznes në aktivitetin e tij.

Sigurisht, e di që ka probleme, por ato nuk vijnë nga administrata, por nga mospërdorimi në mënyrë ligjore të këtyre pajisjeve. Kjo nuk është monopol dhe çmimi nuk është ai që thatë ju, është vetëm 4800 lekë në vit, përfshirë riparimin, transmetimin dhe kartën e telefonisë celulare, vizitën fiskale, pra sa 1/1000-ta e asaj që një taksidar i pandershëm mund t'i kërkonte një biznesi duke i bërë presion për xhiron. Kjo është kostoja.

Vendosëm mbikëqyrjen e mallrave të akcizës me pulla fiskale të sigurisë së lartë përmes një kontrate koncesioni me një nga firmat më të mëdha evropiane. Cili është rezultati? Klientët tuaj, që nuk e pranuan fillimisht, sot deklarojnë një xhiro për mallrat e akcizës të paktën 4 herë më të lartë në harkun e një viti. Kjo do të thotë të fuqizosh konkurrencën, transparencën e tregut, t'i japësh siguri çdo individ që futet në treg. A paguajnë kompanitë më shumë? Jo. Paganin shumë më tepër ryshfete dhe pagesa gjobash të vizitave fiskale. Tani deklarojnë dhe raportojnë *online* përditë se çfarë pullash kanë përdorur, se çfarë shenjuesish kanë vënë dhe janë më konkurrues.

Pyetini tani klientët tuaj, të trembur në momentin e vendosjes së saj, por që ishin të interesuar për një transparencë dhe konkurrencë në treg: A ishin gjë e mirë apo e keqe pullat fiskale? Do ta merrni përgjigjen prej tyre, se unë e kam marrë.

Vendosëm të shënojmë karburantet përmes jonizimit dhe e kemi përfunduar këtë gjë, e kemi lidhur kontratën. Sigurisht ka shqetësime në treg për të gjithë ata që përdorin tregun e karburanteve për të bërë evazion, duke bashkuar të gjitha llojet e karburanteve në karburantin e automjeteve dhe duke mos respektuar standardin e shitjes së tij, në përpjekje për t'u shpëtuar taksave dhe duke shkatërruar pasuritë e mëdha që kanë qytetarët. Qytetarët nuk morën kosto

shtesë për këtë çështje. Pyetini ata kur të kenë karburantin e makinës së tyre të pastër dhe me fuqitë që parashikon standardi i lejuar për trajtimin e karburanteve! Sigurisht klientët tuaj sot janë shumë të shqetësuar për këtë. Ata që përziejnë naftën bruto me naftën që shkon në serbatorin e makinave të qytetarëve janë klientët tuaj. E dini shumë mirë ju që janë klientët tuaj. Megjithatë, unë po ju them se do ishte më mirë që qeveria të koncesiononte sa më shpejt edhe inspektoratin qendror teknik për t'ia kaluar analizën e karburanteve që futen në treg jo më shtetit, që gjithmonë lëshon fatura kundrejt një administrate jo transparente.

Të jeni të bindur se qytetarët do ta paguajnë 10 herë më pak atë karburant që është llum dhe që shkatërron mjetet e tyre. Koncesionimi është zgjidhja.

A e dini sa paguan sot një automjet që bën kontrollin teknik në doganë dhe sa i kushton një kompanie një kontroll doganor? Nuk po them orët që rrinë aty, dhe as sa shpenzojnë për të qarkulluar nga një vend në vendin tjetër të kontrollit fizik, por sa i kushton një kompanie vetëm ngarkim-shkarkimi i një makine? Këtu pagesa do të jetë më e paktë dhe tregu më i garantuar. Pse bërtisni ju?

Para disa ditëve rilindësi juaj Rama deklaroi publikisht, dhe e kanë dëgjuar të gjithë shqiptarët, që nëse ai do të vijë në pushtet, do të japë me koncesion menaxhimin e doganave të Shqipërisë. Kjo është pjesa thelbësore e menaxhimit të doganave të Shqipërisë. Nuk do të ketë më nevojë për taksidarë që deklarojnë apo nuk deklarojnë të vërtetën, por do të jetë një kompani, e cila me të njëjtën saktësi që kontrollohen organet e brendshme të një të sëmuri, do të kontrollojë mallrat që hyjnë e dalin në Shqipëri. Imazhet tani do të jenë *online* edhe në doganë edhe për publikun dhe do të ofrohet mundësia që çdo qytetar të hapë kompjuterin dhe të shohë se ç'ka brenda sipas leximit të imazheve që do të bëjnë ekspertët. Kjo është transparencë dhe luftë kundër korrupsionit e kontrabandës. Kjo është t'i kthesh atdheut pasuritë që i takojnë.

Përse bërtisni kaq? Vetë kryetari juaj deklaroi publikisht dhe ju tha se do t'ia jepte shërbimin doganor një kompanie të huaj. Procesi ka filluar të paktën 5 vjet të shkuara për t'iu dhënë kompanisë më të madhe të imazherisë botërore, të cilës po i japim kontrollin e

doganave shqiptare, që të jetë mundësia për transparencë për të gjithë qytetarët. Ky është atdheu i qytetarëve dhe jo atdheu në dorën e kontrabandistëve dhe të korruptuarve. Me këtë strategji do të vazhdojmë edhe më tej.

Deri më sot kam mundur të bëj deri 5 koncesione. Po të kisha mundësi, do të bëja edhe 15 të tjera, në mënyrë që gjithë shërbimi publik shqiptar, çdo burim që ushqen korrupsionin në administratë, të kalojë në duart e privatit, për të rritur cilësinë dhe për të ulur gjomat që paguajnë qytetarët. Kjo kontratë jep siguri për të gjitha mallrat që hyjnë. A e dini që SHBA 4 vjet të shkuara u kanë kërkuar të gjitha vendeve të botës se, në qoftë se nuk do të jetë ky shërbim, nuk do të pranohen eksportet në SHBA, sepse është shërbimi që garanton saktësi për jetën e qytetarëve, edhe për qëllime fiskale, edhe për mbrojtjen e vendit, edhe për sigurinë e kufijve.

Ju po e bëni si në kohën e “Borgjezit fisnik”, ku të tjerë tregojnë teorinë e dialogut dhe monologut, dhe ju s’e dini se kjo që po bëjmë ne është monologu dhe dialogu juaj. Ato që ju kërkonin sot dhe i fusni në programin e rilindjes, ne i kemi bërë me kohë, por ju nuk dini se çfarë ndodh në Shqipëri.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë te projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, zonja Vokshi, urdhëroni!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjen e datës 16.04.2013 shqyrtoi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”, propozuar nga Këshilli i Ministrave në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

Në mbledhjen e zhvilluar nga komisioni, për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve dhe për të prezantuar këtë projektligj morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave. Projektligji i propozuar vjen në mbështetje të bujqësisë dhe fermerëve shqiptarë dhe synon bashkimin e tokave bujqësore për krijimin e fermave bujqësore përmes lehtësimit

fiskal të uljes së kostos së blerjes së tokës bujqësore me 10% . Qëllimi i këtij projektligji është mbështetja e bujqësisë dhe fermerëve duke propozuar përjashtime nga tatimi për të ardhurat që fermerët përfitojnë nga shitja e tokës bujqësore vetëm në rastet kur blerësi është fermer apo person fizik ose juridik dhe më kusht që të mos ndryshojë destinacionin e tokës bujqësore. Ndryshimin e destinacionit të tokës bujqësore do ta garantojë Këshilli i Ministrave, i cili do të vendosë rregulla dhe kriteret për këtë qëllim.

Mbështetur në argumentet e sipërcituara, duke vlerësuar domosdoshmërinë e këtij projektligji, Komisioni i Ekonomisë e miratoi atë me konsensus.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Zoti Braçe, në emër të PS-së, urdhëroni!

**Erion Braçe** – Zoti Ministër, kam një pyetje për ju. Akti i dhurimit të tokës, truall ose tokë bujqësore, tatóhet sot në Shqipëri, apo jo?

**Ridvan Bode** – Nuk tatóhet.

**Erion Braçe** – Gënjeni, zoti Ministër!

Tani, rri e dëgjo!

Siç e dëgjuat, ministri i Financave sapo tha se akti i dhurimit të tokës, truall ose tokë bujqësore, nuk tatóhet sot në Shqipëri.

Tatóhet? E drodhe, ë? Sapo i the zonjës Kryetare se nuk tatóhet.

Zonja Kryetare, ky akt është në vazhden e akteve që qeveria ka sjellë gjatë dy muajve të fundit dhe që s’bëjnë gjë tjetër, por kthejnë mbrapsht gjithë sa është bërë në këto 8 vjet. Është një praktikë në prag të fushatës elektorale, kur pasi 8 vjet me radhë u morën shqiptarëve qindarkë më qindarkë si taksë dhe si tatim, këto detyrime fiskale nga buka që hanë dhe nga qumështi që pinë, nga shërbimet që marrin dhe nga ilaçet, në fund edhe nga aktet e dhurimit të pronësisë brenda familjes, vijnë tani dhe i tërheqin, duke larë duart si Sali Berisha.

Shprehja e vjetër e lidhte këtë gjest me Ponc Pilatin. Në fakt Ponci është bërë Sali. Kështu konvertohet në Shqipëri. Gjatë këtyre 8 vjetëve u ka marrë shqiptarëve miliarda euro tatime, që tani po i kthen mbrapsht. Ktheu mbrapsht TVSH-në për makineri e pajisje. Ktheu mbrapsht TVSH-në për ipute bujqësore, tatimin mbi pagat minimale, ato prej 100 mijë lekësh të vjetra, që nuk u garantojnë shqiptarëve as të

marrin frymë e jo të ushqehen. Po kthen mbrapsht edhe tatimin mbi transaksionet e tokës bujqësore në fshat. Pse, e pyeta ministrin pak më parë. Sepse në kuadër të fushatës sallë më sallë e shkollë më shkollë, që po bën Sali Berisha, ka marrë angazhime përballë të gjithë banorëve të fshatit, bujqve dhe fermerëve. Natyrisht, angazhime të cilat i ka refuzuar këtu në sallë për vite me radhë, siç refuzoi propozimet tona për heqjen e TVSH-së për makineri e pajisje, siç refuzoi këtu bashkë me ministrin e tij propozimin tonë për heqjen e TVSH-së për të gjitha iputet bujqësore dhe jo pak, tri herë rresht, me tre fjalime të ndryshme, të cilat konsistojnë në një pikë: rrënimin e buxhetit të shtetit.

Këta po i bëjnë të dyja: edhe fshatarët po i gënjejnë, edhe buxhetin e shtetit po e rrënojnë dhe kjo është e evidente, sa kohë që të gjitha këto akte që vijnë në Kuvendin e Shqipërisë kanë faturë financiare dhe s'kanë para për t'i mbuluar, duke krijuar një gropë aq të thellë, që do t'i bëjë dëm jo opozitës që do të vijë në pushtet, por qytetarëve shqiptarë, të cilët do të jenë të detyruar të mbushin këtë gropë financiare, siç e mbushën në vitin 1997.

Akti zgjidh vetëm një pjesë të problemit. Tatimi 10% mbi transaksionet e tokës bujqësore bëhet zero. Në fshat ka edhe një fenomen tjetër. Këta shkojnë në fshat vetëm për fushatë. Ka ndodhur që, kur babai dëshiron t'i dhurojë pjesën e tokës djalit sipas aktit të marrë në pronësi të tokës, sipas reformës në vitin 1991, nuk e bën dot, sepse sipas çmimeve të referencës, të përgatitura nga 2 ministra bashkë, duhet të paguajë 10% tatim mbi vlerën e kësaj toke, të llogaritur mbi bazën të çmimit të referencës.

Ky është udhëzimi nr.9, datë 26.02.2008, ku thuhet qartësisht se akti i dhurimit të tokës bujqësore edhe brenda trungut familjar nga babai tek i biri, kur ai është në moshë madhore, është prind më vete, dhe pastaj nga prindi te fëmija, kur ai ndahet për të krijuar familjen e tij, tatohet me 10 për qind.

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

Jo, këtë akt nuk e ka firmosur ai, por e ke firmosur ti dhe një ministër tjetër.

Kjo ka bërë që edhe brenda familjeve toka të mos shkojë atje ku duhet, pra toka të mos kalojë nga babai tek i biri, kur ndahet nga trugu familjar, tek e bija kur ndahet nga trugu familjar, duke frenuar një proces krejt normal që

një familje e re, e cila krijohet në fshat, të ketë në pronësi ato metra katrorë tokë bujqësore si bazë të familjes së saj.

Ju vini sot dhe thoni se vetëm kur e shet tokën nuk tatohet. Pra, në momentin kur ai e shet, siguron të ardhura nga kjo shitje, nuk do të tatohet, ndërsa në momentin kur ai e dhuron, do të vazhdojë të tatohet. E kuptoni se çfarë logjike është kjo? Keni ndërhyrë në nenin 8/1, ndërkohë që duhet të kishit ndërhyrë në një nen tjetër. Pikërisht për këtë arsye ne kemi bërë propozimin për të ndërhyrë në nenin 11, i cili thotë: "Kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme", ku kërkojmë qartazi që çdo familje në fshat të mos paguajë tatim për aktet e dhurimit të tokës bujqësore brenda trungut familjar, jo jashtë. Ky është një problem thelbësor në fshat, thelbësor brenda familjeve, sepse është kthyer në konflikt social. Kemi parë raste të qarta ku djali ka qëlluar babanë, babai ka qëlluar djalin, duke e kthyer në një zinxhir gjaku pronën brenda familjes. Pra, duke e kthyer pronën nga një mundësi ekonomike për një familje të re, në një hall shumë të madh familjar, duke shkatërruar përfundimisht familje të tëra në fshat.

Përveç kësaj, e kam dëgjuar me vëmendje Sali Berishën në të gjithë turin e tij në fshat, veçanërisht kur ka folur për këtë çështje. Po mirë, që Sali Berisha është kapitalist, këtë e kuptoj, që Sali Berisha në thelb të kapitalizmit të tij ka dhe të djathtën, edhe këtë e kuptoj, por nuk po i kthen përgjigje një pyetjeje: Një fshatar që e shet tokën, çfarë duhet të bëjë me jetën e tij? Vetëm atë ka në fshat. Nuk ka asnjë gjë tjetër. Çfarë do ta bëni këtë fshatar që po e nxisni të shesë tokën përmes mospagimit të tatimit? Interesat e kujt mbrojnë në këtë rast, të atyre që duan të bëhen më të mëdhenj duke blerë tokën për një copë bukë, siç po shitet toka sot në fshat? Çfarë do të bëni me të më pas, do t'i jepni atë ndihmën ekonomike qesharake që në fshat shkon nga 9 mijë lekë të vjetra deri në 30 mijë lekë? Apo do t'i thoni: "Shko puno argat tani, atje matanë!" Kjo është mënyra? Kjo është zgjidhja që po i jepni fshatarit? Apo më keq akoma, do t'i thoni që të vijë të vendoset në rrethinat e qyteteve të mëdha dhe të dalë te "Partizani i panjohur" pastaj, që të kërkojë punë, thjesht dhe vetëm se ju po e nxisni që të shesë tokën bujqësore? Apo do ta çoni emigrant në Greqi, siç keni çuar pjesën më të madhe të banorëve të

zonave rurale, pjesën më të madhe të bujqve, të cilët e kanë punën në Greqi më të paguar sesa punën me tokën e tyre në Shqipëri? Këtë do të bëni? Kjo është perspektiva ekonomike që po i jepni fshatit? Kjo është perspektiva ekonomike që po u jepni familjeve, të cilat sot e kanë të pamundur të punojnë me tokën, sepse nuk u jep fryt, për shkak të të gjithë atyre që ju ua keni refuzuar për tetë vjet?

Zoti Ministër, duhet ta kuptoni se po nguteni, po nguteni për nevoja elektorale dhe nuk po zgjidhni problemet reale që ka fshati sot. Një nga problemet, propozimin e të cilit jua kemi bërë me shkrim, është: votojeni që të largoni gjakun nga marrëdhëniet brenda familjeve në fshat për shkak të pronësisë mbi tokën!

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Zoti Ministër, urdhëroni!

**Ridvan Bode** – Ky ligj mënjanon pikërisht një pjesë të problematikës që ju ngritët, dhe në fakt ju e ngritët problemin në nivelin e fshatarit. Por nuk është çështja aty, po jua sqaroj.

Sigurisht, trashëgimia dhe format e kalimit të pasurisë nga një brez në brezin tjetër, nga një kurorë në një kurorë tjetër, janë çështje të trashëgimisë që i zgjidhim, në këtë rast nuk paguhet. Rastet e dhurimit (jo përtej standardit, sepse standard në botë që dhurimi të mos taksohet nuk ka), por unë po të them një gjë: kjo është mënyra për të pastruar paratë të korruptuarit. Kjo është mënyra për të pastruar paratë e korrupsionit, paratë e krimin të organizuar.

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

Ju thatë për pasurinë të mos taksohet.

Më dëgjo mua tani! Mos u bë tellall i interesave okulte!

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

E pra, duhet ta dish që një nga kryetarët e listave që ke nxjerrë tani nëpër rrethe ka disa dhjetëra milionë dollarë që i ka bërë në këtë formë që thua ti. Të mos taksohet? Ka disa dhjetëra milionë dollarë që i ka marrë toka, troje të dhuruara, i ka shitur dhe rishitur me çmim disa herë më të lartë. Kjo është arsyeja pse ne i kemi vënë taksë korrupsionit, taksë evazionit, 10 për qind. Dhurimi duhet taksuar. Një njeri që merr pasuri në mënyrë të pandershme përmes dhuratave duhet taksuar. Po ta them: merr dhe shiko dosjen e njerit prej kolegëve që e ke vënë

tani në krye të listës! Merre dhe shikoje si e ka vënë pasurinë, transaksione tokash, transaksione trojesh! Prandaj duhet taksuar dhurimi. Çështja e kalimit brenda kurorës së familjes etj., është çështje tjetër që mund të diskutohet.

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

Ti po ngrihesh kundër taksës së dhurimit. Dhurimi duhet taksuar, zotëri, për të dekurajuar ata të korruptuarit që shesin dhe blejnë me paratë e të tjerëve.

**Jozefina Topalli** – Zoti Ilir Bejtja, urdhëroni!

**Ilir Bejtja** – Zoti Ministër, ne nuk jemi duke folur për Damir Fazllicin që dhuron apo merr toka me akte dhurimi. Nuk po flasim për Damir Fazllicin, por po flasim për fshatarë që kanë nga dy-tre dynymë tokë, të cilët nuk janë ata që pastrojnë para. E kupton? Në qoftë se kjo punë ngeli që fermerët shqiptarë qenkan ata që pastrojnë para nëpërmjet tokës, nuk ishte fare me vend kjo ndërhyrje. Në fakt duhet të thonit se keni hallin e njerëzve pranë qeverisë, pranë familjes së Berishës, të cilët merren rregullisht me transaksione tokash, që janë dhe sekserë latifondistësh, që nëpërmjet akteve të dhurimit kanë bërë edhe ato pasuritë e çuditshme, që nuk e dimë se si i deklarojnë.

Sa për fshatin, kur të vini këtu të flisni për fshatin, duhet ta filloni diskutimin gjithmonë me fjalët “Më fal”, më pas të filloni të flisni për fshatin. Ju duhet ta filloni me fjalët “Më fal” sepse është një sektor, i cili presupozohet që jep peshën kryesore dhe të ardhurat e ekonomisë shqiptare dhe është totalisht në rrëmujë, i paregjistruar. Kemi një sektor që i gjithi është në një rrëmujë tokash të paregjistruara dhe të pastuduara, kurse ju po diskutoni sesi do të jepen dhe si do të shiten tokat.

Më falni, mund t’u jepni një përgjigje fshatarëve të zonës së Labinotit në Elbasan, të cilët ende nuk kanë hyrë në hartën kadastrale dhe ende nuk e dinë nëse mund t’i shesin apo t’i japin me qira tokat e tyre? Sot jemi 20 vjet demokraci nga koha që ua keni dhënë në përdorim, dhe ende është zonë e pastuduar. Ky është problemi, ne diskutojmë të shesim apo të blejmë tokën, kur ata ende nuk e dinë nëse e kanë apo nuk e kanë tokën në pronësi.

Shitet toka për të jetuar. Sot në fshat nuk bëhet fjalë të kemi mundësi që të krijohen kushte

për rritjen e latifondistëve, po i quajmë ata që do të merren me tregun e tokave apo të atyre që do të merren me sektorin e bujqësisë në përgjithësi, apo të blegtorisë, nëpërmjet rritjes së sipërfaqeve që ato duhet të kenë në përdorim, por bëhet fjalë për familje, të cilave ligji nr. 7501 u ka dhënë tokë sa për të jetuar dhe nuk u ka krijuar atyre mundësi në mënyrë absolute që të shoqërizohen, sepse parcelat nuk janë as kufitare me njëra-tjetrën, të shpërndara vend e pa vend, atje ku u ka rënë radha, në një rrëmujë, e cila edhe sot nëse duan ta japin ose jo me qira, praktikisht është e pamundur.

Fshati sot vuan gjithë inputet nën një monopol total, duke filluar nga farat dhe duke vazhduar me të gjitha herbicidet dhe inputet e tjera bujqësore. Produktet e tyre sot prodhohen me kostot më të larta të të gjithë rajonit. Më thoni, në cilin prej vendeve ne mund të eksportojmë në sezone të barabarta? I vetmi avantazh që ka Shqipëria sot në eksportimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në vendet fqinje apo jashtë territoreve të saj është ai i stinës. Ende sot ne nuk kemi një fshat që të prodhojë me kosto që konkurrojnë në tregun ndërkombëtar duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe standardin. Nuk ka mbrojtje fiskale për produktet e tyre, përkundrazi, kemi nxjerrë së fundi edhe ligjin e procedurave të akcizës, i cili u vë barrën e akcizës atyre për të gjithë produktet nën akcizë që në momentin që fillon prodhimi, jo më të diskutojmë momentet kur fillon prodhimi i pijeve alkoolike, apo të tjera me radhë.

Atyre u mungon standardizimi. A ka sot një institut standardesh që të garantojë produktet shqiptare, nën certifikimin e këtij instituti, të tregohen jashtë kufijve të Shqipërisë? A mundet sot që produktet bujqësore shqiptare pa një certifikatë standardi të hyjnë në vendet e Bashkimit Europian dhe të tregohen si të lira? Nuk ka. Instituti më i afërt i standardeve që ne kemi është në Kroaci. A ka fshatar sot që ka regjistrim juridik dhe mund të marrë produktin e tij në formë kampioni të certifikuar në institutin e standardeve në Kroaci? Nuk ka. Nëpërmjet kujt mund ta bëjnë këtë standardizim? Nëpërmjet kujt mund ta bëjnë këtë certifikim? Sa është i njohur sot Instituti ynë i Higjienës për të garantuar certifikata të cilat bëjnë të mundur që produktet tona të kalojnë kufirin duke garantuar si zona të mbrojtura, apo jo? Nuk e kemi këtë mundësi.

Certifikatat tona nuk njihen. Përsëri ne duhet të çojmë kampione të produkteve tona jashtë, në mënyrë që ato të kenë mundësi të tregohen jashtë.

A ka sot fshatarë të cilët janë të regjistruar nga pikëpamja juridike që t'i marrin këto produkte dhe t'i çojnë jashtë për t'i marrë këto certifikata? Nuk ka. Të 350 fermat nuk janë të regjistruara juridikisht. Ato i blejnë farat jashtë dhe kanë degraduar të gjitha kulturat origjinale vendase. A ekziston sot mundësia që një fshatar, që prodhon në kushtet e Shqipërisë, të vendosë *brand-in* "Made in Albania"? Është e pamundur. Ky ishte varianti që u soll këtu për ullirin, për të cilin duhet të vendosim *brand-in*, por nuk duhet ta vendosim me emër territori, sepse ne sot nuk garantojmë asnjë varietet, asnjë kulturë që të jetë tejet origjinale shqiptare. Edhe kjo që ofrohet sot është qesharake, që ta promovosh si një mundësi etike për fshatin. Është qesharake ta promovosh si shansin e vetëm që ata kanë për të rritur mundësitë e tyre për mekanizim apo për përdorimin e teknikave që rrisin rendimentet në bujqësi apo në blegtori. Nuk ka qenë ky problemi i derisotëm.

Ligji që ju nxorët para ca kohësh për organizimin e bizneseve në bujqësi nuk i ka penguar fshatarët të shoqërizohen me pronat e tyre, me tokat e tyre, në grupe shumë më të mëdha, me shumë më tepër pasuri tokësore, që të kenë mundësi të aplikojnë mekanikë bujqësore të avancuar. Sot ekzistojnë këto sipërfaqe dhe janë të pafundme, ekzistojnë mjaft firma fermerësh shqiptarë, të cilat janë të regjistruara dhe nuk kanë mundësi t'i punojnë tokat jo thjesht se këto janë në pronësi të ndryshme, por sepse nuk ekziston mundësia e mekanizimit të tyre, nuk ekziston mundësia e përpunimit të tokës në kushte të tilla që të ketë mundësi që të jetë e drenazhuar, të jetë nën ujë, të ketë mundësi të plehërohet në mënyrë moderne dhe të ketë mundësi të japë rendimente që prodhojnë edhe kosto shumë më të ulëta, që të kenë konkurrueshmëri ndërkombëtare.

Ndryshimi i destinacionit si kriter. Më thoni, sa objekte janë privatizuar në Shqipëri nën kushtin e mosndryshimit të destinacionit dhe ku janë sot këto objekte? Sa fabrika agrourbore janë privatizuar sot në Shqipëri nën kushtin e mosndryshimit të destinacionit dhe ku janë, a punojnë sot? Mjafton t'ju përmend zonën

agroindustriale të Elbasanit, ish-Konservimi, i cili është privatizuar nën kushtin që të mos ndryshohet destinacioni dhe ato të mbesin punishte për përpunimin e produkteve ushqimore. E dini se çfarë janë sot? Pallate, ofiçina, sipërfaqe djerrë të rrënuara totalisht. Cili prej këtyre bizneseve, që i privatizoi, u mor nën përgjegjësi për mosrespektimin e garancive që duhet të jepte për ndryshimin e destinacionit?

Sa do të jeni të zotë ta bëni këtë me 340 mijë fermerë në të gjithë Shqipërinë? Cili është ai institut që do të monitorojë të gjithë fshatarët të regjistruar nën pronësi apo nën disponim toke, që nuk do ta ndryshojë destinacionin mbas shitjes apo blerjes së saj? A e keni mundësinë fiskale të shkoni pranë apo pas çdo individit, i cili do ta ndryshojë nesër destinacionin e tokës dhe ta tatoni përsëri me 10%? Kujt mundeni t'ia merrni 10%-shin e taksës? Cili prej tyre ka llogari bankare aktive dhe është i regjistruar si biznes juridik? Si do t'ia merrni paratë? Në cilin vend e marrin pagën këta që ju do t'u merrni lekët nga paga?

Garancitë që ju shprehni në ligj nëse ndryshon destinacioni, janë përsëri qesharake. Absolutisht, janë kritere që nuk mund të zbatohen. Ashtu siç ka ndodhur me tokën, e cila është bastarduar për ndërtime urbane, me rreth 27% të saj, ashtu do të vazhdojë të ndodh edhe në këtë rast. Do të krijohen territore atje ku juve ju shërbejnë, pranë klanëve mafioze të ndërtimit, në mënyrë që ju të ndërtoni qendra urbane apo qendra relaksi, kudo që ju keni mundësi, të pastroni ato para të pista të Fazllicëve, që përmendi këtu edhe ministri. Fshatarët tanë nuk kanë para të pista për të pastruar, por kanë njerëz që janë shumë pranë qeverisë. Kur do të futet, ndonjëherë, në eficientë ligji “Për organizimin e bizneseve bujqësore”, mbasi të hiqet 10%-shi i taksës? Kjo e ka penguar? Asnjëherë nuk na janë dhënë informacione se çfarë ndodhi nga dita e daljes së këtij ligji dhe sa biznese në fashat janë regjistruar nëpërmjet ligjit “Për organizimin e bizneseve bujqësore” në Shqipëri. Sipas deklaratës së ministrit, vazhdojnë të jenë të regjistruara në një libër që ekziston pranë Ministrisë së Bujqësisë. Më falni: sa QKR keni? Një në Ministrinë e Bujqësisë për fshatin dhe një në QKR për të gjithë shqiptarët? Kaq kisha.

**Jozefina Topalli** – Në emër të grupit, fjalën e ka zoti Ahmetaj.

**Arben Ahmetaj** – Në dukje ky mund të jetë një ligj i thjeshtë dhe një ndryshim i thjeshtë, por në fakt në të vërtetë është një ndryshim ligji, i cili duhet të na tërheqë vëmendjen për situatën që po kalon fermeri shqiptar dhe bujqësia shqiptare.

Së pari, dua t'u sqaroj një element tepër të rëndësishëm qytetarëve shqiptarë, por edhe anëtarit të qeverisë që përmendi pastrim parave me tokën bujqësore. Zoti anëtar i qeverisë, që nuk e ke marrë vesh në këto tetë vjet, pastrimin e parave me tokat nuk e bën fermeri, as bujku, por e bëjnë personat si Damir Fazllic që mbështetur nga kjo qeveri. Nëse flet për pastrim parash me shitblerjen e tokës, referoju transaksioneve që janë bërë nën vëzhgimin e qeverisë tënde dhe jo ata transaksione të munguara që do të duhet të bëjnë nesër fermerët. Çfarë presupozon heqja e 10%-shit të tatimit për transaksionet e tokës, cili është qëllimi? Sipas relacionit tuaj, qëllimi është konsolidimi i fermave. Dakord. Pyetja e parë që i vjen natyrshëm çdokujt është: çfarë keni bërë deri tani ju si qeveri për të konsoliduar tregun e tokës? Keni të njëjtën shifër të privatizimit të hektarëve me vitin 2005. Janë 561 mijë hektarë tokë bujqësore që janë privatizuar në Republikën e Shqipërisë. Kjo shifër është e vitit 2005, por kjo është edhe shifra e vitit 2013. Çfarë ka ndodhur këto 8 vjet? Nul, asgjë, zero.

Vazhdojmë me logjikën tjetër, hiqni 10%-shin për shkak të kostove. Kostot në bujqësi janë rritur në mënyrë marramendëse. Doni të flisni për plugimin për hektar? 60% është rritur kostoja e plugimit për hektar. Doni të flisni për çmimin e plehrave kimike? Minimalisht janë rritur me 40%. Doni të flisni për naftën? Çmimi i naftës është rritur dy herë. Doni të flisni për mundësinë që kanë fermerët për të çuar në treg produktet për t'i shitur? Po ju jap një shifër që sot është zyrtare, 65% e prodhimit të fermave shqiptare nuk arrijnë dot të çojnë prodhimet e tyre në treg dhe këto prodhime prishen. E kemi parë me qepën, me patatën, me ullirin, me portokallin dhe me shumë produkte të tjera. Përse më flisni për koston? Ajo që ne themi, që ka të bëjë me bujqësinë, është një shqetësim social. Ajo që kolegu im Braçe iu referua, zoti ministër, ka të bëjë me dhurimin nga babai te fëmija. Pra ka të bëjë me konceptin e trashëgimisë dhe jo me dhurimin jashtë familjes. Logjika jonë është që këtu ka nevojë për një vëzhgim dhe për një



rregullim që ta lehtësojë atë problem që vajti 22 vjet. Janë 1 milionë e 761 mijë parcela. Pra i bie që janë pesë parcela për familje.

Çfarë ndodh? A e dini që këto 5 parcela për familje janë të ndara brenda familjes, sepse ju nuk bëni rregullime në mënyrë informale. Djali nuk e trashëgon dot, sepse ti e taton 10%, dhe vjen këtu e flet për koston. Thelbi i gjithë gjësë ka të bëjë jo thjesht me këtë tatim, por ka të bëjë me bujqësinë. Po ju them që, nëpërmjet heqjes së këtij tatimi, ju në fakt promovoni shitblerjen e tokës, duke mos dhënë asnjë alternativë për atë fermer i cili ngel pa tokë, i cili e shet tokën jo thjesht për të bërë kapitalistin me shitblerjen, për të konsoliduar apo për të hequr qafe një copë tokë, por e shet për hall dhe alternativa e tij është papunësia, emigrimi ose ardhja në dyert e qyteteve të mëdha. Çfarë afroni me këtë? Asgjë nuk afroni. Vini këtu dy muaj para ikjes, na sillni nga këto dhe na bëni politikë për pastrimin e parave.

Zotërinj, 8 vjet ju e keni nëpërkëmbur bujqësinë. Keni ardhur dhe jeni tallur në këtë parlament. Ne si opozitë kemi sjellë në vazhdimësi paketa të mbështetjes së bujqësisë. Ju në vazhdimësi i keni rrëzuar. Ta marrin vesh qytetarët shqiptarë dhe fermerët, që ju pretendoni se do të merrni vota, që ju këtu ia keni rrëzuar opozitës të gjitha paketat që kanë të bëjnë me heqjen e akcizës së naftës, me heqjen e taksës së qarkullimit, me heqjen e TVSH-së për *inputet* bujqësore e gjithë ato formate dhe reforma, që ka propozuar.

Pse e keni bërë këtë, zotërinj, dhe pse mundoheni ta bëni tani? Doni të gënjeni sërish fermerët në fushatë elektorale?

Zotërinj, keni dështuar!

Dje bëtë edhe një maskaradë tjetër në Këshillin e Ministrave: pasi nuk ju ka funksionuar për vite rimbursimi i TVSH-së tek *inputet* bujqësore, vini dhe sillni një instrument të ri, dy muaj përpara se të ikni.

Me çfarë qëllimi? Për të blerë votën? E bletë votën në 2009-ën. Nuk keni më asnjë shans të bleni votën!

Flisni për subvencionim. Për çfarë subvencionimi flisni? Keni 8 vjet dhe akoma nuk keni një shifër të saktë se sa keni subvencionuar, se sa familje fermere ka Republika e Shqipërisë. Njëri thotë 351 mijë, tjetri thotë 323 mijë. Nejshe, ne po marrim 351 mijëshin. Me ato familje që ju

keni subvencionuar, do t'u duhet të rriini edhe 56 vjet të tjera, që të plotësoni minimumin e mbështetjes. E pra, nuk është e rastësishme, që bujqësia sot është në atë gjendje që është. Nuk është e rastësishme, që kontributi bujqësor është minimal në rritjen ekonomike, është fatkeqësi. Nuk është absolutisht e rastësishme, që, duke iu referuar të dhënave të Institutit të Statistikës, vetëm në vitin 2012 në bujqësi janë humbur 12 mijë vende pune. E pra, ky është rezultati i reformave tuaja. Ne nuk ju bëjmë dot më thirrje të pranoni ato që ne kemi propozuar, sepse ju jeni një qeveri në ikje. Të gjitha ato që ne kemi propozuar, do të fillojnë që ditën e parë të qeverisjes së Partisë Socialiste.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** - Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, zoti Ministër, urdhëroni!

**Ridvan Bode** – Projektligji që propozojmë, për një ndryshim në ligjin e tatimit mbi të ardhurat, është pjesë e një pakete të plotë që qeveria ka ndërmarrë, për të mbështetur prodhimin bujqësor dhe fermat bujqësore, sikurse edhe industrinë e lidhura me to. Për këtë paketë, ju jeni të informuar në detaje, pasi është diskutuar dhe është debatuar këtu në parlament. Ajo ka qenë e gjithanshme dhe ka synuar si nxitjen e prodhimit bujqësor, ashtu edhe lehtësimin e tregtimit të tyre, bërjen e prodhimeve bujqësore shqiptare më konkurruese, heqjen e vlerës së shtuar për të gjithë makinerinë, investimet bujqësore dhe investimet e lidhura me industrinë, që përdorin si lëndë të parë prodhimin bujqësor e blegtoral; heqjen e tatimeve ose rimbursimit të tatimit sipas skemës, që ne ndryshuam dhe do të vijë javës që vjen, direkt të fermeri, për të gjithë *inputet* bujqësore, ato që përdoren si: plehra, farëra, materiale biologjike, materiale mbjellëse, fidanë frutorë etj, sikurse edhe industrive të tjera të peshkimit dhe industrive që lidhen me këtë degë kaq të rëndësishme të ekonomisë shqiptare.

Çfarë ka ligji aktual që ne sjellim sot?

Ligji synon të nxisë konsolidimin strukturor të fermës bujqësore. Është e vërtetë që në një periudhë të hershme, në vitet 50, në shumë vende të Bashkimit Europian, që kanë pasur një copëzim ekstrem të fermave bujqësore, ka pasur politika të nxitjes së konsolidimit të fermave bujqësore, për të hapur mundësinë dhe për të hapur shtegun e një reforme strukturorë. Por

është po aq e vërtetë, saqë situata aktuale, gjatë kësaj periudhe tranzicioni në Shqipëri, gjithnjë e më shumë po e bën të domosdoshëm fillimin e një reforme strukturore të fermës bujqësore, çka do të thotë konsolidimin strukturor, elementi i parë i strukturës të së cilës, është toka që prodhohet, si nga pikëpamja e copëzimit, që erdhi për shkak të ndarjes të barabartë, në momentin e ndarjes së tokës bujqësore, ashtu edhe nga dinamika që krijon vetë jeta ekonomike. Por një emigracion i brendshëm ka bërë të mundur, që sipërfaqe të tëra të mund të vihen në dispozicion të tregut të tokës bujqësore, për ta konsoliduar atë.

Pra, ne me këtë ligj hedhim hapin e parë drejt një strategjie që do të synojë konsolidimin e fermave bujqësore nga ana strukturore, heqim pagimin e tatimit të vlerës së shtuar, kur shitja dhe blerja e tokës ndodhin vetëm për qëllime bujqësore, që bëhet, nga një fermë bujqësore e regjistruar, në një fermë tjetër bujqësore e regjistruar. Kjo do të thotë që krijohet një lirshmëri më e madhe për sa u takon aspekteve fiskale, por sigurisht që testimi i saj do të bëhet nga vetë rezultatet që do të japë tregu.

Këtu debati kapërcen dhe unë prandaj thashë që nuk jam dakord me mënyrën e frymës që diskutoni, sepse për të justifikuar dhe për të gjetur një pretekst, që e keni gjetur, i cili qëndron, që ka të bëjë me copëzimin e pasurisë brenda një familjeje, (kjo nuk ndodh vetëm në fshat, por ndodh edhe në qytet, ndarja ose pjesëtimi i pasurisë brenda familjes kërkon një trajtim të veçantë fiskal) të ngrihesh kundër taksimit të dhurimit të pronës, është e papranueshme dhe këtu, absolutisht, ka qëllime okulte. Ne në parlament nuk jemi klientë të interesave okulte të caktuara, por jemi zëdhënës dhe shprehës të interesit të qytetarëve shqiptarë dhe të interesave publike. Ne duhet të mbrojmë interesat publike. Unë jam plotësisht dakord që të laborohet ai koncept, por përpara se të laborohet në ligjin e taksave, i cili për këtë arsye mund të pësojë deformimin më të madh, sepse dhurimi është një nga instrumentet për të pastruar para dhe për t'i shpëtuar evazionit fiskal, duhet të përcaktohet në Kodin Civil dhe në legjislacione që kanë të bëjnë me familjen, ndarjen e familjes dhe copëzimin e pasurisë. Në qoftë se i thua dhurimi nuk të detyron të paguash taksë, kjo është jashtëzakonisht e dëmshme dhe

ka të bëjë me moralin thelbësor të sistemit fiskal dhe të qeverisjeve në Shqipëri.

Në qoftë se keni propozime, si fillim ekspertët të ulen për të përcaktuar në Kodin Civil konceptin e ndarjes dhe të pjesëtimit të pasurisë. Nuk është vetëm toka bujqësore, ke edhe pasurinë në qytet, një familje që ndan biznesin, që ndan banesat. Të gjitha këto kanë sens diskutimi, por kjo nuk mund të përdoret si artificë, meqë po diskutojmë sot për bujqësinë, për të hapur shtegun e qarkullimit të parave jologjore përmes akteve të dhurimit dhe procesit të dhurimit.

Për sa u takon aspekteve të tjera, zotërinj, bujqësia përbën një nga sektorët më dinamik të ekonomisë shqiptare dhe këtë vitalitet dhe dinamizëm e dëshmoi gjatë kësaj periudhe të krizës globale. Është sektori që në tri vjetët e fundit ka dhënë ritmet kryesore të rritjes ekonomike. Është sektori që ka dy herë më shumë rritje ekonomike sesa ekonomia nacionale në tërësi.

Çfarë ka ndodhur në kohën që ju keni qenë në pushtet? Bujqësia ishte me një rritje vjetore sa ¼-ta e rritjes ekonomike. Në qoftë se mesatarisht ekonomia rritej me 5,5% deri në 6%, bujqësia është rritur me 2 deri në 2,2% në periudhën e mandatit të dytë. Duhet ta dini se në 4 vjetët e qeverisjes suaj dhe ajo që e mat aktivitetin bujqësor dhe performancën e bujqësisë është kompetitiviteti i saj me tregtinë ndërkombëtare, nga viti 2001 deri në vitin 2005 i gjithë prodhimi bujqësor ka rritur eksportet vetëm me 0,1 miliardë lekë dhe po të kemi në konsideratë këtu edhe kursin e këmbimit, eksportet bujqësore në 4 vjetët e dytë të qeverisjes suaj kanë pësuar një rënie nga 22 deri në 28% dhe kjo dëshmon dinamizmin e bujqësisë. Raporti i import-eksporteve të prodhimeve bujqësore kaloi nga 1 me 8,5 në 1 me 12 në vitin 2005.

Çfarë ka ndodhur? Eksportet bujqësore janë rritur në mënyrë të përvitshme. Nga 5,1 miliardë që latë në vitin 2005, arritën në 13 miliardë në vitin 2012. Një rritje 2,5 herë. Kurse raporti dhe koeficienti i import-eksporteve, pra bilanci tregtar i vendit me prodhimet bujqësore, nga 1 me 12 ka zbritur në 1 me 7. Ne nuk po themi se jemi vend eksportues neto, por që prodhimet bujqësore shqiptare gjithnjë e më shumë po çajnë tregjet rajonale dhe po furnizojnë në tregun tonë të brendshëm. Në mënyrë masive

tregu i brendshëm furnizohet me prodhime të freskëta të bujqësisë shqiptare dhe jo vetëm në perime ose në mish, por në të gjitha llojet e frutave e të tjera. Kjo ka qenë strategjia dhe politika që ka ndjekur Partia Demokratike, edhe me mbështetje të drejtpërdrejt të buxheteve familjare. Në 4 vjet dhatë vetëm 250 milionë lekë të rinj, 2 milionë e gjysmë dollarë, për naftën që kurrë nuk shkoi në xhepin e fermerit. Kurrë nuk e preku kush tollonin e naftës që shpërndatë ju. 250 milionë lekë të rinj, kur në një vit ne ndajmë 1,5 miliardë lekë të rinj për buxhetet familjare për të mbështetur mbjelljet frutore, ullirin serat bujqësore dhe aktivitete të tjera.

Në një periudhë 8-vjeçare ne kemi investuar më shumë se 25 miliardë në formën e mbështetjes së drejtpërdrejt apo incentivave të tjera të dhëna sektorit të bujqësisë. Bujqësia ka nevojë për infrastrukturë dhe duhet ta dini që në vitin 2005 e keni lënë fshatin të izoluar, pjesë të tëra të territorit të vendit nuk kishin lidhje me tregun, vetë konsumonin dhe hidhnin prodhimet bujqësore. Ne ndërnuam të gjithë infrastrukturën rurale. Rreth 7 mijë km rrugë janë sot në eficiencë, të asfaltuara, të cilat janë arteriet kur rrjedhin prodhimet bujqësore dhe injektohen në treg.

Fshatari doli nga mentaliteti i vetëkonsumit. Në vitin 2005 mbijetesa dhe vetëkonsumi i familjes fermere ishte në dominancë në 90% të fermave. Ndërsa sot rreth 75% e fermave mendojnë për treg, prodhojnë për treg dhe orientohen nga tregu. E nxorëm nga izolimi, nga vetëkzistenca dhe e bëmë pjesë të tregut. Kjo është ajo që bëmë me fermerin, prandaj ata shesin prodhimet bujqësore, por jo vetëm kaq.

Zotërinj, ju e dini, e kot bëni këtu tellallin. Pjesë e madhe e kabinetit ministror në kohën kur keni qenë në pushtet merrej me importin dhe tregtinë e prodhimeve bujqësore, me perime, me mish, me vezë, me fruta e me të gjitha gjërat e tjera. Drejtorët e institucioneve tuaj kanë qenë tregtarët më të mëdhenj të tregtisë së prodhimeve bujqësore. Kjo është harruar. Kjo është diferenca pse sot fermerët shesin dhe nuk hedhin në përrua prodhimet e tyre. Shesin 100% prodhimin, edhe përtej standardeve, me çmime të mira dhe kanë të ardhura gjithnjë e më të mira. Prandaj ne mendojmë dhe duhet të mbështesim

konsolidimin edhe strukturor të fermës, sikurse mbështetëm edhe uljen e kostos së tyre dhe nxitjen e orientuar të prodhimeve bujqësore që kanë hapësira në tregjet rajonale e më gjerë përmes politikës subvencionale që kemi përdorur dhe do të vazhdojmë në këtë rrugë. Tellalli që bëni këtu nuk është i ndershëm dhe i drejtë.

Do të ballafaqohemi në fushatë elektorale dhe do ta merrni përgjigjen.

*(Debat në sallë.)*

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Mbyllet kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë te projektligji partneritetin publik-privat.

Fjalën zoti Arben Ahmetaj.

*(Debat në sallë)*

**Arben Ahmetaj** – Dakord, por tellalli iku, ai duhet të rrinte këtu e të kthente përgjigje.

**Jozefina Topalli** – Të lutem, kur tjetri nuk është, nuk është mirë të flasësh.

**Arben Ahmetaj** – Zonjë, ky është vendi ku duhet të jemi, jo ai nga duhet të ikim.

**Jozefina Topalli** – Urdhëroni!

**Arben Ahmetaj** – Kjo historia e zhvillimit ekonomik për të cilën po flet ministri i Financave, nuk po përdor shprehjen e tij “pallavra”, por po e zbukuroj, po them propagandë, është qesharake, edhe për sa i përket bujqësisë, sepse, ashtu siç ka rënë gjithë ekonomia, ka rënë edhe bujqësia. Në qoftë se keni tetë vjet, si qeveri, që nuk keni bërë asgjë për infrastrukturën bujqësore, rezultatën e keni te sektori i bujqësisë, i cili është i falimentuar. Vini e bëni kozmetikë, si shumëkush këtu, dhe kërkoni të justifikoni dështimin në tetë vjet. Gjithsesi, unë kam përpara një ligj, i cili bën të njëjtën gjë, tregon dështimin e kësaj qeverie me një politikë ekonomike zhvillimi, që është politika e koncesioneve dhe e partneritetit publik privat. Në fakt, unë kam një pyetje shumë të rëndësishme për të gjithë kolegët, por edhe për anëtarët e qeverisë, së cilës dua që qytetarët t'i kushtojnë një sekondë vëmendje, zotërinj të qeverisë, nëse sillni një ligj për koncesionet, i cili në shumë elemente ndryshon formën dhe cilësinë, cila është arsyeja që keni sjellë, vetëm këto ditë, mbi 20 koncesione? Pse nuk prisni edhe një, dy, tre apo katër muaj, pasi ky ligj të ketë hyrë në fuqi, i cili rregullon formatin, sipas jush? Pse jepni koncesione me ligjin e vjetër? Pse jepni koncesione me sistemin e inkriminuar

dhe korruptim të bonuseve, të pikëve të avancuara? Pse jepni koncesione me logjikën e vjetër? Cila është arsyeja që sot, brenda një dite, sillni një ligj, i cili, sipas jush, bën përafrimin e legjislacionit shqiptar të koncesioneve me atë europian, dhe po brenda kësaj dite sillni një koncesion, i cili, në fakt, është korruptiv dhe e sillni me ligjin e vjetër? A mund t'ua tregoni qytetarëve shqiptarë çfarë logjike ka kjo, brenda së njëjtës ditë kjo qeveri kundërshton veten? Unë e di shumë mirë, qytetarët e dinë shumë mirë, por edhe kolegët e mi, të majtë e të djathtë, e dinë shumë mirë që ju po grabisni me shpejtësi pronën publike në duart e pesë vetave të familjes së kryetarit të qeverisë, Sali Berishës. Megjithatë, po kaloj për disa minuta në elementet e këtij ligji. Ligji, në rastin më të mirë të tij, sërish është konfuz, i paqartë dhe ka bërë një dëm të madh, nuk tregon, (do të duhet të ishte edhe ministri i Ekonomisë këtu) se çfarë ndodh me koncesionet në fund të periudhës së tyre: i transferohen shtetit, kthehen në pronë të koncesionarit, apo vazhdojnë edhe 30 vjet të tjera? Ky ligj nuk e qartëson.

Së dyti, që është po kaq e rëndësishme, mos flisni për një politikë koncensionare tetëvjeçare. Kjo politikë është e dështuar në energji. I keni trumbetuar koncesionet në energji sikur do të krijonit një superfuqi energjetike në rajon. Çfarë ka ndodhur? Pas tetë vjetëve në qeverinë tuaj vetëm 5% e prodhimit të energjisë elektrike është nga privatët. Përtej kësaj, megjithëse vetëm 5% e prodhimit të energjisë elektrike është nga privatët, privatët sot vuajnë për shkak se Korporata Elektroenergjetike nuk ka para t'i paguajë, sepse ju e keni shkatërruar edhe sistemin elektroenergjetik. Ndërkohë, qëllimi i parë i koncesioneve është të japë në dorën e një privati apo në duart të përbashkëta publik-privat vepra, punë, të cilat shteti për arsye të ndryshme, duke filluar që nga ato financiare deri tek interesi kombëtar, nuk i bën dot. Ka edhe një element tjetër, ulja e kostove. Kur japim një koncesion kemi si qëllim që në finale kostoja për konsumatorin, për qytetarin dhe për përfituesin të ulet. Çfarë ka ndodhur me koncesionet? Doni koncesionet në energji? Keni dhënë me koncesione 300 hidrocentrale, nga të cilat sot punojnë vetëm 30. Çfarë ka ndodhur me çmimin? Është dyfishuar. Keni dhënë koncesion të barrës siguroese, fatura është më e lartë. Keni

dhënë koncesion të pullave fiskale, fatura është më e lartë. Po jepni koncesion të markimit të naftës, fatura është më e lartë. 15 milionë atje, 15 milionë këtu, 120 milionë euro këtu dhe në finale këto të gjitha dalin nga xhepi i qytetarit shqiptar. Pra keni dështuar në të dyja elementet bazë të koncesionimit, që janë zhvillimi ekonomik dhe ulja e kostos. Përtej kësaj ka edhe një të tretë, përmirësimi i shërbimit publik. Më thoni një shërbim publik që e keni më mirë? Cilin keni më mirë? Kasat fiskale i keni me çmim shumë më të lartë. Barrën siguroese e keni me çmim më të lartë. Po të merresh me pullat fiskale, nuk e merr vesh i pari të dytin, vetëm një gjë është e sigurt, paratë që shkojnë te koncesionari. Vazhdojmë me energjinë elektrike, ditë e zezë! Me shpërndarjen, ditë e zezë! Me privatizimin e Albpetrolit, ditë zezë! Më thoni një sektor që ju, si qeveri, sot keni sukses. Zero! Vazhdojmë me një element tjetër. Pikët. Zotëri, jam dakord që po i hiqni pikët pas tetë vjetëve, por a e mbani mend se çfarë keni bërë në këtë parlament kur sollët bonusin, kur sollët pikët e avancës? Çfarë ju thanë kolegët e mi, e keni në procesverbal. Kolegët e mi ju thanë troç: "Pikët në avancë që ju sillni janë elemente korruptive. Pikët në avancë që ju sillni për propozimet e pakërkura janë elemente që do të favorizojnë kompanitë tuaja". Çfarë ndodhi? Në tetë vjet ju mbështetët pesë kompanitë tuaja, të cilat morën koncesione që janë shumë të thjeshta, sepse ju sjellin benefite vetëm një grupi njerëzish dhe jo qytetarëve shqiptarë. Çfarë ndodh sot? Sot vini dhe e hiqni, pikërisht, se ky mund të jetë një element korruptiv. Kush e ka bërë? Ju e keni bërë. Ne kemi thënë që nuk duhet të jetë dhe ju po e bëni këtë për arsye korruptive. Sot vini dhe deklaroni se po e heqim pikëzimin e avancuar, pra bonusin, sepse është një instrument që mund të avantazhojë korrupsionin.

Gjithsesi, ne, si opozitë, e kemi deklaruar qëndrimin tonë ndaj pseudokoncensionave që ju keni dhënë dhe ndaj dështimit, në fakt. Unë, po t'i shihja të gjitha ditët në 8 vjetët tuaj, nuk do të gjeja dot një sukses në koncesione. Ku do gjeja sukses? Do gjeja te koncesionet e naftës, kur e gjithë nafta bruto ikën jashtë Shqipërisë?! Te cili koncesion do gjeja sukses?! Tek ai i energjisë elektrike, kur 32 hidrocentrale janë të mbytur në borxhe?! Ku do gjeja sukses?! Te markimi i naftës?! Ku është "Virxhinia"? Ku është çështja

e saj?! Ku do gjeja sukses, te pullat fiskale?! Ore, çfarë më thua ti mua se koncesioni të sjellë të ardhura, kur të ka rënë akciza? A mund ta shpjegoj dot ti se si të ka rënë akciza me 15%? Shpjegoja shqiptarëve këtë! Pse ka rënë, cila është arsyeja? Ndërkohë që një anëtar i qeverisë tënde vjen e thotë se subjektet e akcizës janë shtuar. E kuptoni se çfarë kontradiksioni të qëllimtë sillni? Megjithatë, ky është fundi i 8-vjeçarit dhe sigurisht që ne do të votojmë kundër këtij ligji për 1 milion arsye. Një nga arsyet kryesore është se sërish ju sillni një ligj konfuz me qëllim, megjithatë, e vetmja e mirë e kësaj pune është që këto janë vetëm 2 muajt e fundit të qeverisë suaj.

*(Drejtmin e seancës e merr zoti Turku.)*

**Ardian Turku** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Malaj.

**Arben Malaj** – Faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Në fakt, kjo që ndodh me qeverinë në ikje ndoshta është model që gjendet vetë në Shqipëri. Nga njëra anë diskutohet në ligjin organik për koncesionet dhe, nga ana tjetër, po jepni koncesione konkrete. Kjo është një kontradiktë shumë e madhe, e cila ka vetëm një arsye reale: kapjen përfundimtare të shtetit. Një nga mënyrat më konkrete në të gjitha rastet kur studiohet kapja e shtetit është koncensionimi i pasurive natyrore. Që të ketë një partneritet më të mirë të sektorit publik me atë privat, kjo tashmë është e domosdoshme. Ka pasuri natyrore që mund të futen në qarkullim vetëm nga investimi i sektorit privat dhe nuk ka pse buxheti apo taksapaguesit shqiptarë të angazhohen, por ajo që u rëndon më tepër shqiptarëve është fakti që të gjitha koncesionet tuaja, fatkeqësisht, rezultojnë të dështuara.

Kemi diskutuar shpesh këtu për koncesionet tuaja, sepse kërkonin, nga ne, si opozitë, dy elemente thelbësore për të përzgjedhur një fitues. E para, të kishte kredibilitetin teknologjik për koncesionin që kërkonte dhe, e dyta, të kishte kredibilitetin financiar për ta vënë në kohë një pasuri natyrore me qarkullim ekonomik për të krijuar më shumë punë dhe të ardhura. Koncesionet tuaja, në pjesën më të madhe, sidomos ato në sektorin e energjisë, të industrisë së çimentos etj., të cilat i keni dhënë, por nuk kanë filluar, kanë pasur pikërisht mungesën e dy kushteve thelbësore:

kredibilitetin teknologjik dhe atë financiar, aq sa ju na detyronit të firmosnim apo të diskutonim këtu për koncesionet dhe kompani, që kishin si kapital themeltar vetëm 100 mijë lekë dhe, më pas, pasi ta merrnin lejen tuaj dhe ta shisnin diku, mendonin se do të gjenin para. Jo vetëm që nuk gjetën dot para për disa nga koncesionet tuaja, por keni 8 vjet që i shkaktoni dëme ekonomisë shqiptare, prandaj pas 23 qershorit duhet të bëjmë një analizë për këto dëme. Duke mos i dhënë me koncesion këto pasuri kompanive serioze dhe kredibile, ju keni vonuar vënien në përdorim të tyre, prandaj edhe papunësia është kaq e lartë, prandaj edhe dështimi është kaq i madh.

Shenjë tjetër e një dështimi kaq të madh është edhe iniciativa juaj “1 euro”, e cila u përdor në disa raste vetëm për favore individuale, që në thelb kanë korrupsionin e tyre, por si një politikë zhvillimi e Shqipërisë, që do të thithte këtu investime pa fund, rezulton e dështuar përfundimisht.

Partneriteti me sektorin publik dhe privat, përveç futjes në qarkullimin ekonomik të pasurive tona natyrore, duhet të ketë dy përfitime reale, që duhet t'i ndiejë biznesi dhe ekonomia shqiptare: të ulë kostos dhe të rrisë cilësinë e shërbimit. A mund të gjeni ndonjë rast nga koncesionet që keni dhënë deri tani që është ulur kostoja, apo është rritur cilësia e shërbimit? A doni ta dini se çfarë ndodh me koncesionin e fundit, që përsëri është një nga gjërat më të këqijat që mund të bëjë një qeveri në ikje, e cila i jep koncesion për skanim kontenières pasi është shpallur edhe data e zgjedhjeve, apo edhe koncesione të tjera? A nuk ka bërë titeri deri në ulërimë këtu ish-lideri i opozitës, aktualisht, kryetari i qeverisë, i cili thoshte se ai asnjëherë nuk do të pranojë që pasi të jenë shpallur zgjedhjet të japë koncesione për kompani të ndryshme? Çfarë ka ndodhur në këtë ndryshim e madh? Ka ndryshuar filozofia? Jo, por është ajo që opozita po e thotë me të madhe: kapja e shtetit dhe korrupsioni ka arritur në nivelet më të mëdha. A e dini se çfarë ndodhi me kasat? 26 milionë dollarë iu blenë një kompanie private pas disa protestave dhe gjoja u paguan nga buxheti i shtetit. Pasi u zbulua skandali, çfarë do të ndodhë me skanimin e kontenièresve? 180 milionë euro thuhet për periudhën e koncesionit, por cili do t'i paguajë? Biznesi shqiptar. Ç'është ky

absolutizimi i teknologjisë, kur dihet që ajo, në vetvete, është vetëm një teknikë – ajo rezulton e suksesshme vetëm kur implementohet në mënyrë të suksesshme. A mendoni se do të japë ndonjë rezultat? Aq sa dha koncesioni për kontrollin e makinave, kur me të njëjtat probleme me vonesat dhe deri te korrupsioni për të kapur radhën apo për të kaluar jashtë kriterëve teknike, konstatohet sot dështimi i një koncesioni në ekonominë shqiptare. Ne mund të bëjmë ligje, ju mund të absolutizoni teknologjinë, por, në fakt, është ajo që shqiptarët e dinë: marrëveshjet e koncesionit, në thelbin e tyre, kanë pasur politikën tuaj të krijimit të një të ardhure të qëndrueshme edhe kur të mos jeni në pushtet. Dihet shumë mirë se si realizohet: nëpërmjet nënkonsencionarëve tuaj.

Do ta shikoni edhe këtë koncesionin e fundit, se kompania që shet pajisje është e ndryshme nga ajo që implementon një teknologji në një sektor të caktuar, qoftë për të kontrolluar makinat, qoftë për të kontrolluar skanerët.

Pra, në mënyrë të përmbledhur dua të theksoj: nuk mund të ketë sukses në qoftë se miratojmë ligje, por nuk implementohen. Që të implementohen ligjet duhet të përmirësohet administrata publike, ajo që ju e keni përkeqësuar shumë. Ajo që do të rezultojë si dëmtimi më i madh që kjo maxhorancë i ka bërë qeverisjes së vendit është pikërisht kapja e shtetit dhe mënyra se si po silleni me administratën publike. Të jeni të bindur që asnjë koncesion, çfarëdo ligji të bëni, në momentin që vendimi përfundimtar nuk është në bazë të kredibilitetit teknologjik, të kredibilitetit financiar dhe të kompanive që aplikojnë, por është në bazë të nënkontraktorit apo të korrupsionit, ai ka dështuar pa nisur mirë.

Ky është realiteti konkret i koncesioneve tuaja në ekonominë shqiptare. Rastet e dështimit janë jashtëzakonisht të mëdha, kostot e mosfutjes në qarkullim ekonomik të pasurive tona janë shumë të mëdha dhe kostot në rritje, që po i jepni biznesit shqiptar, edhe rasti i koncesionit për pullat, edhe rasti i koncesionit për skanimin e makinave apo kontenerëve në doganë, edhe rastet e koncesioneve të tjera, në thelb filozofia juaj, nuk janë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe për të ulur kostot (ato do të rriten dhe do t'i paguajë biznesi shqiptar). Sigurisht që një pjesë e të ardhurave, në mënyrë direkte dhe indirekte, do të shkojnë te nënkontraktorët tuaj,

të cilët në një rast janë të afërmit tuaj, kurse në një tjetër janë pjesa korruptive e qeverisjes së vendit. Kështu që, në këtë aspekt, çdo diskutim që bëhet tani për një ligj organik nuk ka vëmendjen dhe kredibilitetin e duhur që të krijojë një bazë të mirë, sepse vijnë nga dështime të përsëritura nga koncesionet shqiptare, ndërsa vazhdimi për të dhënë koncesione deri ditën e fundit të mandatit tuaj të fundit është i dëmshëm në aspektin ekonomik, kurse në aspektin politik është deri kriminal. Ju po mendoni për paratë tuaja pas zgjedhjeve dhe jo për të përmirësuar cilësinë, për të ulur kostot e shërbimeve apo të prodhimeve që vijnë nga koncesionimi i pasurive tona natyrore.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr zonja Topalli.)*

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zoti Malaj!

Fjalën e ka Blendi Klosi.

Nuk është i pranishëm.

Fjalën e ka zoti Balla.

**Taulant Balla** – Në fakt, nuk ka një sektor tjetër në sektorët e kësaj ekonomie, sikurse është ai i koncesioneve, i cili tregon më qartë dhe më dukshëm dështimin më të suksesshëm të kësaj qeverie. Keni dhënë 300 koncesione për hidrocentrale, por vetëm 31 prej tyre i keni sot në punë. Ajo që ka ndodhur në këta 8 vjet me koncesionet është një histori zaptimi, e njëjtë me historinë e kioskave të vitit 1992. Kush kishte lidhje me oborrit? Ministrat e oborrit, dhe kush paguante ryshfet, zaptuan lumenj, përrrenj kudo nëpër Shqipëri. Shqipëria fuqi energjetike, na mbeti veçse në letra koncesioni dhe në kontrata koncesioni. Mjafton t'i referohemi shifrës zyrtare, sipas secilës, privatët koncesionarë hidrocentralesh prodhojnë vetëm 4,2% të energjisë së prodhuar sot në vend. Këtu fillon dhe mbaron historia e turpshme e dështimit me koncesionet dhe e dështimit të Shqipërisë si fuqi energjetike, me hidrocentrale të mbetura thjesht dhe vetëm në letër.

Pra, keni dhënë 300 koncesione për hidrocentrale. Vazhdoni të jepni akoma edhe këto ditë. Nga këto 300 koncesione 64 prej tyre, nga verifikimi që kemi bërë deri më sot, rezulton se janë dhënë në konflikt të pastër interesi për familjarë oborri, për familjarë ministrash dhe për funksionarë të lartë të kësaj administrate shtetërore. Pra, çerekun e hidrocentraleve të

dhëna në koncesion i ka marrë oborri për vete, duke i hequr mënjane. Ato që nuk janë të oborrit, janë zhytur që në fillim në borxhe për rryshfetet pafund që kanë dhënë për çdo leje për marrjen përfundimtare të koncesionit. Kur arrinin te vendimi i fundit për dhënien e koncesionit, sipërmarrësit falimentonin pa e filluar ende punën për investimin. Historia e koncesioneve është një ndër historitë më të turpshme në Shqipërinë e këtyre 8 vjetve. Ne do t'i rishikojmë ato. Nuk do të lejojmë që këto pasuri të grabiten, sikurse janë zaptuar deri më sot. Procesi i koncesionimit të pasurive publike nuk do të jetë më një histori grabitjeje pafund. Klientë të pushtetit i marrin këto letra koncesionesh, dalin në treg dhe i shesin.

Ne do të mbështesim shumë fort dhe do të bëjmë një plan paketash lehtësuese për të gjithë ata koncesionarë që i kanë fituar këto koncesione dhe që i meritojnë ato. Nuk mund t'i lëmë si sot, të rrjepur deri në fund dhe në pamundësi për t'u kthyer në punë. I takonte kësaj qeverie në ikje që të ndiqte të gjithë procesin e koncesioneve. Ato janë dhënë në funksion të një tregu të zi dhe aspak në funksion të shëndoshjes së sistemit tonë energjetik. Po si nuk shënuat një histori të vetme suksesi në koncesione apo në privatizime?! U turrët për të shitur gjithçka dhe për të mbushur sadopak arkën e mbetur bosh të këtij shteti. Shitët disa herë nën vlerë katër HEC-et: Bistrica 1, Bistrica 2, Ulza dhe Shkopeti. Për shkak të korrupsionit deri në majë dhe të paaftësisë deri në mediokritet, nga privatizim, se jemi në afatin e fundit ligjor pikërisht sot, ku i keni lekët? A i keni marrë paratë e shitjes së katër hidrocentraleve, apo jo? Sigurisht që nuk i keni marrë, sepse bëtë një kontratë, pra ia dhatë atij mikut të qeverisë dhe miku i saj duhet të garantonte më pas nga një bankë e huaj para, por banka nuk ia dha. Sot, ky privatizim i juaji i suksesshëm dështoi po aq suksesshëm, sikurse e nisët që në fillim. E ripërsëris, ashtu siç e kemi thënë edhe dy muaj më parë, ne nuk e njohim këtë privatizim të këtyre katër hidrocentraleve, sepse keni dështuar që fillim me të. Nuk do të lejojmë që këto pasuri të shqiptarëve të grabiten për shkak të keqqeverisjes, e cila sot ka dështuar suksesshëm në çdo sektor dhe në çdo koncesion.

E njëjta situatë e turpshme po ndodh e ka ndodhur edhe në sektorin e naftës. Ky sektor ka nevojë për një reformim të thellë. Sigurisht që

privatizimet apo koncesionet tuaja kanë dështuar: ARMO-ja, Albpetrol-i dhe të gjitha lejet dhe koncesionet e dhëna në këtë sektor. Ky sektor është jashtë kontrollit të shtetit. Skandali i naftës *vergine* tregoi se struktura të larta shtetërore ishin pikërisht të përfshira në këtë trafik të turpshëm. Nxirrej nafta, shoqërohej me makina policie, dërgohej në Vlorë, ndryshoheshin dokumentet në det, shkarkohej në Shëngjin dhe dilte e papërpunuar. Na u përpunua në det dhe vinte e shkarkohej në Shëngjin si naftë e përpunuar dhe shkatërronte më pas të gjitha makinat e shqiptarëve! Shqiptarët duhet ta dinë se sot në Shqipëri nxirret plot 1 milion ton naftë. Por çfarë marrin shqiptarët nga kjo pasuri? Shumë e papërfillshme. Humbin 160 milionë dollarë në vit. Vidhen dhe janë vjedhur nga kjo qeveri. Ose e thënë ndryshe 640 milionë dollarë në katër vjet i mungojnë buxhetit të shtetit vetëm nga moszbatimi i këtij standardi dhe vjedhjes së turpshme të kësaj pasurie kombëtare.

Privatizimi i Albpetrol-it ishte po ashtu një proces i errët. Nuk ka vend në botë që, me një pasuri kombëtare si nafta, ku ka madje edhe rafineri, nafta bruto ikën për t'u përpunuar jashtë. Kjo bëhet në mënyrë të qëllimshme. Bëhet në mënyrë të qëllimshme për të lënë të papunë ata mijëra naftëtarë në Ballsh, në Patos e të tjerë, të cilët, nëse nafta do të përpunohej në Shqipëri, sot do të ishin në punë.

Privatizimi i Albpetrol-it ishte një proces i errët dhe i turpshëm. U deklarua një shifër e bujshme, por që nuk ishte as e besueshme. Sot Albpetrol-i nuk është as i privatizuar, as i shtetit. Nuk e dimë se ç'bëhet me të.

Një histori tjetër korrupsioni, po aq e turpshme, po ndodh këto ditë në këtë qeveri në ikje. Keni filluar të shisni dhe të jepni ç'keni mundësi, si një ushtri pushtuese, e cila, pasi largohet, lë pas vetes vetëm shkatërrim.

Prej disa ditësh kjo qeveri ka shpallur në fshehtësi një licencë tjetër, prej të paktën 25 milionë eurosh për financimin, projektimin, instalimin, trajnimin dhe transferimin e rrjetit të transmetimeve televizive dixhitale në Republikën e Shqipërisë. Nuk ishte parë dhe dëgjuar askund që në një dorë të vetme të jepet projektimi, financimi, ndërtimi dhe madje përdorimi.

Kjo licencë, sigurisht, vjen era korrupsion, si çdo koncesion tjetër. Historia e gjobëvënies ka

filluar që në fillim edhe me këtë licencë, pikërisht për licencën për transmetimet dixhitale, për të gjitha televizionet në Shqipëri, qofshin ato kombëtare apo lokale.

Një kompani gjermane, e interesuar për këtë tender, iu drejtua institucioneve të shtetit të vet dhe i tha: “Jam vënë nën presion, sepse atje në Shqipëri, ajo qeveria më bën presion dhe më thotë që këtë tender ose do ta bësh me një partner shqiptar të lidhur me oborrin ose nuk e merr dot”. Kompania gjermane është një nga më të mëdhatë në botë dhe për këtë projekt kishte marrë garanci bankare nga banka më e madhe gjermane, Doice Bank. Në fakt, ky tender është shprehja më e qartë se si shkelen parashikimet dhe afatet e parashikuara në ligj.

Kam këtu shpalljen e kontratës “Për financimin, për ngritjen, për projektimin e sistemit të transmetimit dixhital në Republikën e Shqipërisë”. Për dy javë, nga dita e hapjes së ofertave deri në nënshkrimin e kontratës, duhet mbyllur gjithçka. Flasin sot për ligjin “Për koncesionet”. Por lexojeni ligjin “Për koncesionet”. Duhet të paktën tre muaj për të lënë kohë për ankimmimet, për rishikimet dhe për negociimet e kontratës. Për dy javë doni ta mbyllni edhe këtë kontratë. A e shikoni kolegë deputetë të maxhorancës?

Ju në fakt nuk keni faj, se pjesa juaj më e madhe as që i di këto. Detyra juaj është të votoni pislleqet që bëjnë ministrat e kësaj qeverie. Ju i jepni votën, këta marrin paratë. Kjo është historia juaj në këto katër vjet, apo në tetë vjet, nëse doni.

Në 23 qershor, për fat të mirë, do të rilindë Shqipëria. Shpresoj që do të rilindni edhe ju, kolegë deputetë, votues të korrupsionit të kësaj qeverie.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Mimi Kodheli, në emër të grupit të PS-së, urdhëroni!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Kolegë! Unë dua të ndaj me shumë prej jush një shqetësim real. Them me shumë prej jush, pasi nuk mund ta ndaj këtë shqetësim me qeverinë dhe njerëzit rrotull saj, autoren e masakrës që i është bërë në këto tetë vite gjithë pasurisë së popullit shqiptar.

Shqetësimi vjen nga fakti se këto pasuri, në emër të ekonomisë së tregut dhe proceseve integruese, i keni privatizuar ose lëshuar nën

administrim privat, duke përqendruar fitimet në duart e absolutisht shumë pak njerëzve, qofshin këta vendas apo të huaj. Kjo ka sjellë një padrejtësi të madhe, pabarazi ekstreme, varfëri, për shumicën dërrmuese të shqiptarëve. Sot jemi në pikën kur Shqipëria, një ndër vendet më të pasura në Europë me pasuri nën dhe mbi tokësore, është vendi më i varfër i kontinentit të vjetër.

Nën fjalët e bukura koncencion apo partneritet publik privat këta zotërinj kanë zhvatur çdo gjë tonën dhe të përbashkët, çdo gjë nga e cila gjithkush prej nesh do të duhet të përfitonte dhjetëra, madje, qindra herë më shumë, nëse procedurat dhe ligjet, edhe kështu siç kanë qenë të shkruara, do të zbatoheshin me rigorozitet dhe drejtësi.

Ligji i koncencioneve i vitit 2006 përcaktonte kuadrin legjislativ për koncencionet, nga ana tjetër ishin përcaktuar edhe rregulla të hollësishme për zbatimin e tij.

Ky ligj, megjithëse i paharmonizuar me standardet e BE-së, u shit si një ligj shumë i mirë në atë kohë, zbatimi i të cilit do ta kthente Shqipërinë në një superfuqi ekonomike, sidomos në fusha si ajo e energjetikës. Por realiteti flet me një tjetër gjuhë. Shqipëria është e varfër, është pa drita ose e përmbytur, meqenëse jemi te energjia, dhe, padyshim, është më shumë e korrumpuar. Kjo pasi në shumicë procedurat e dhënies së koncencioneve kanë vazhduar të bazohen në propozime të pakërkuara, ato për të cilat dyshohet se korrupsioni është më i lartë.

Më lejoni të ndalem pak te ky moment.

Ju në amendimet e ditëve të fundit sillni një ndryshim që nga pikëpamja procedurale prek trajtimin e propozimeve të pakërkuara, duke kaluar nga bonos me pikë në kompensim financiar për shpenzimet e investitorëve, të cilët kanë kryer këto lloj investimesh më përpara. Por ajo që nuk keni bërë, nuk e di nëse nga padija apo qëllimisht, është se këtë metodë nuk e keni shtrirë edhe për HEC-et, megjithëse HEC-et përbëjnë portofolin më të madh të koncesioneve. Gjithashtu, megjithëse investimet e shumë qytetarëve shqiptarë, pse jo edhe të investitorëve të huaj në këtë fushë, kanë qenë dhe janë shumë të mëdha, edhe me ndryshimet që sillni nuk shikoj se do të mund të kompensohen. Pra, praktikisht janë investime të humbura, pa folur pastaj për riskun që duhet të përballojë çdo



biznes kur bën një propozim të pakërkuar. Pra, ajo çfarë ka ndodhur deri tani është që një mori investitorësh të mundshëm kanë shpenzuar shuma të konsiderueshme të kursimeve të tyre, të cilët më në fund nuk kanë marrë asnjë lloj vlerësimi dhe nuk do ta marrin këtë lloj vlerësimi edhe me ndryshimet që vijnë sot në ligj.

Një çështje tjetër, që trajtohet në këtë projektligj, lidhet me transferimin e koncesionit, një tjetër procedurë e dështuar. Praktikisht, pas fitimit të një gare investitorët mund të hyjnë në ortakëri duke e zgjeruar portofolin e tyre, portofolin e ortakërisë edhe me subjekte të tjera, ose duke e shitur atë. Praktika tregon që marrja e miratimit nga ministria e linjës zgjat më shumë sesa vetë procedurat e prokurimit, duke rritur kështu mundësinë e abuzimit me subjektin. Ky handicap nuk merret parasysh në ndryshimet që vijnë në draft.

Problem tjetër janë garancitë. Një ndër elementet që i ka bërë shpesh kontratat të mos procedojnë në kohën e duhur dhe që disa të mos realizohen fare është pikërisht cilësia e garancive ose e asaj që mund të konsiderohet si kolateral i investitorit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktore. Çfarë risie sjell ky projektligj lidhur me këtë problem që ka çaluar dhe me të cilin është abuzuar rëndë në shumë raste? Realisht, instrumenti që parashikon ligji, në kuptimin e garancive, nuk garanton një seriozitet të investitorëve, sepse, kolegë, serioziteti nuk është vetëm tek emri, por te garancia që çdo investitor sjell në Shqipëri.

Le të flasim pak edhe për monitorimin e kontratave koncesionare. Praktikisht, një pjesë e rëndësishme e koncesioneve të mëdha kanë probleme në procesin e zbatimit të tyre, sepse mekanizmat monitorues kanë lënë shumë për të dëshiruar, por megjithëse ndodh kështu, në projekt nuk është përfshirë ose parashikuar asnjë klauzolë për sa i përket një monitorimi më rigoroz të kontratave në mënyrë që të garantohet, sipas llojit të garancisë dhe në përputhje me kushtet e parashikuara në dokumentet e tenderimit, finalizimi i shërbimeve ose i punimeve të kryera.

Në këto 8 vjet ju keni folur shumë për koncesionet dhe partneritetin publik privat, megjithëse ky i fundit nuk ka qenë një marrëdhënie e rregulluar me ligj, por një slogan, tek i cili keni pasur shpresa se do t'ju ndihmonte

më shumë në mbështetje të gënjeshtreve tuaja. Kjo mbasi ju në 8 vjet keni firmosur 112 kontrata koncesionare, përmes të cilave do të investohej një shumë prej 2,7 miliardë eurosh. Përmes këtyre kontratave do të ndërtoheshin 307 hidrocentrale. Mjerisht, deri tani, janë ndërtuar dhe janë në prodhim vetëm 31 të tilla, pra as 10% e angazhimit. Janë investuar vetëm 210 milionë dollarë, pra as 10% e angazhimit. Kapaciteti i instaluar nuk është as 6% e fuqisë së premtuar dhe as 4% e fuqisë së instaluar në Shqipëri.

Ka qenë kolegu Braçe, i cili jua ka bërë këtë llogari dhe të cilit nuk i jeni përgjigjur dot qoftë edhe me një llogari false, si ato llogaritë që bëni me gishta për kilometrat e rrugëve të reja.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, 4 vjet më parë ju u premtuat shqiptarëve 160 mijë vende të reja pune, madje 136 hidrocentrale që do të ndërtoheshin në këto 4 vjet do të gjeneronin 50 mijë vende të reja pune. Nga 136 hidrocentrale të premtuara, janë ndërtuar vetëm 31. Vendet e punës nuk u bënë kurrë 50 mijë, madje 51 mijë shqiptarë i kanë humbur ato vende pune në 4 vjetët e fundit. Për të mos folur për Bulqizën dhe ACR-në, për kartat e identitetit, për pullat fiskale, për kontrollin e makinave, për CEZ-in, për shërbimin e pajisjes dhe të kontrollit të kasave fiskale, për shërbimin e ngjyrosjes së karburantit dhe për sa e sa dështime të tjera spektakolare ose procese korruptive, të gjitha në kurriz të qytetarëve të thjeshtë, të cilët nuk ishin keq që monopoli nga dora e shtetit, të kalonte po në monopol në duart e individit pranë pushtetit, por janë keq që tregu të hapet dhe të ketë konkurrencë, e cila të sjellë çmime të diversifikuara, pse jo edhe më të ulta, dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ju nuk deshët ose nuk ditët ta bënit. Është mirë të mos vini me këto arnime në ditët e fundit të qeverisjes, por të largoheni me dinjitet. Shpresoj që shumë prej jush do të mund ta bëjnë këtë!

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, fjalën e ka zoti Xhepa.

**Selami Xhepa** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë, projektligji i ri për partneritetin publik privat ose, siç njihet në publik, mbi koncesionet, nevojitet të trajtohet sërish qoftë si një qasje filozofike në

menaxhimin e pasurive publike, qoftë si mekanizëm procedural që e materializon një qasje të tillë. Diskutimi në aspektin filozofik është shfaqur sërish jo vetëm në debatin e zhvilluar herë pas here në këtë sallë, përfshirë edhe sot, por edhe në një plan më të gjerë të një lloj kundërrevolucionit intelektual, që po ndodh prej disa kohësh edhe në shkallë globale, zhvillim që ka marrë nxitje edhe prej krizës globale dhe besimit se çrregullimi dhe liberalizimi i paprecedentë janë shkaktarët themelorë në zhvillime të tilla ekonomike e sociale.

Konvergenca e plotë e liberalëve të majtë dhe e konservatorëve të djathtë që u mishërua në atë që ka hyrë në histori si “konsensusi i Uashingtonit”, i fundviteve ’80, është rivënë sot në diskutim dhe në pikëpyetje. Fakti që shumë shërbime publike, që historikisht ishin kryer nga shteti, iu nënshtruan një forme privatizimi, siç janë edhe koncesionet, sërish është në dilemë. Zgjerimi i dimensioneve të tregut deri në cepat më të thella të jetës ekonomike sociale, duke zaptuar edhe vetë shpirtin njerëzor, ka ngritur çështje të rëndësishme të etikës dhe moralit publik, të cilat duhet, në fakt, të na shqetësojnë edhe ne si shoqëri, duke i adresuar ato me ligje dhe reforma të përshtatshme.

Në kontekstin e një konsensusi të gjithëpranueshëm mbi avantazhet e padiskutueshme të menaxhimit privat në pasuritë publike dhe në ofrimin e shërbimeve publike, ruajtja e këtij konsensusi edhe për dimensionet e tjera jo ekonomike kërkon një balancim më të drejtë të objektivave të eficiencës me objektivat e tjerë socialë. Thënë më thjesht, ruajtja e mbështetjes publike mbi avantazhet e privatizimit dhe koncesioneve në ofrimin e shërbimit publik, duhet shoqëruar me më shumë informacion dhe më shumë transparencë në përfitimet që merr publiku në cilësinë e shërbimeve në këmbim të tarifës më të lartë për pagesat në ofrimin e këtij shërbimi. Ajo që përmendën më përpara kolegët, është fakti se shpesh qytetarët nuk arrijnë ta dallojnë dot përmirësimin e cilësisë së shërbimit, por ato që janë të dukshme si, aeroporti i Rinasi, bëjnë që qytetari ta kuptojë vlerën që merr në këmbim të pagimit të një çmimi më të lartë. Të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe për projektet e tjera me të

cilat qytetari apo konsumatori nuk mund të ketë kontakte të drejtpërdrejta. Analizat e kostove, kartat e vlerësimit publik për cilësinë e shërbimit, garat e hapura publike në procesion e koncesionimit dhe instrumente të tjera që rrisin transparencën e kontratave koncesionare janë elementet thelbësore për të ruajtur nga publiku mbështetjen në vazhdimësi të privatizimit të shërbimeve publike. Në të kundërt, mbështetja për reforma të tilla vaket dhe ky kundërrevolucion intelektual ndaj qasjes liberaliste do të fitonte gjithnjë e më shumë terren.

Projektligji që kemi në diskutim ruan pikërisht këtë lloj qasjeje, duke e shtrirë menaxhimin privat në çdo shërbim publik dhe duke vendosur në parim një avancim të interesave të shoqërisë për shërbime publike më të mira dhe më cilësore. Në aspektin procedural projektligji shënon një ndryshim të rëndësishëm, duke kaluar nga avantazhimi i subjekteve në garën konkurruese me bono në eliminimin e këtij diskriminimi, si dhe adaptimin e kompensimit të plotë të shpenzimeve të studiuara për projektet e kryera nga një investitor nga ana e subjektit fitues së garës. Në eksperiencën ndërkombëtare dhe në ligjin e parë ka dy qasje: njëra është duke avantazhuar subjektin si një kompensim për shpenzimet e kryera me një avantazhim në procesin e garës, dhe e dyta është kjo që po adaptohet sot. Të dyja janë të njohura në eksperiencën ndërkombëtare. Ligji i parë ishte hartuar me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të IFC-së Kjo mënyrë e ndryshuar e bën garën edhe më të ndershme, planet e biznesit i bën më realiste dhe nuk shpërdoron mjetet financiare nga subjektet private që janë iniciatorë të projekteve, por që mund të mos rezultojnë fituese në fund të kësaj gare. Do të ishte e udhës që një qasje e tillë të adaptohej për sektorin elektroenergjetik, që është ndër sektorët më të rëndësishëm në koncesionet e dhëna gjatë viteve të fundit. Fakti që një mori hidrocentralesh të të gjitha dimensioneve janë në ndërtim në të gjithë territorin e vendit e bën këtë ligj shumë të rëndësishëm për investitorët e huaj dhe për biznesin në përgjithësi.

Të nderuar deputetë, zgjedhjet në këtë botë me kufizime imponuese nuk na lënë shumë hapësira zgjedhjeje. Ose t’i lënë burimet natyrore të pashfrytëzuara derisa një ditë shteti të ketë

para për të kryer studime e investime dhe t'i menaxhojë ato si biznese (dhe kjo ditë do të jetë aq afatgjatë, saqë deri atëherë do të kemi vdekur. siç thotë Keinsi), ose t'i japë mundësi sektorit privat për të futur në qarkullim ekonomik burimet e fjetura, në mënyrë që të modernizojmë shërbimet për qytetarin dhe biznesin, sigurisht duke paguar edhe më shumë për një shërbim më të mirë të ofruar në dobi të tyre. Në këtë kurs të reformave, nevoja për transparencë nga firmat koncesionare është esenciale dhe mendoj se reformimi i legjislacionit të kontabilitetit, standardet e raportimit financiar nga ana e këtyre bizneseve duhen revizionuar, në mënyrë që aksesimi i publikut ndaj formimit të tarifave të jetë më i dukshëm. Por alternativa e lënies së pashfrytëzuar të burimeve ekonomike apo e ofrimit të shërbimeve publike me standarde të ulëta nga sektori shtetëror, vetëm e vetëm që këto biznese t'i lihen shtetit, nuk është një alternativë e dobishme e as e preferuar nga publiku.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Me këtë diskutim mbyllet pika e rendit të ditës “Për koncesionet dhe partneritetin publik - privat”

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, zoti Uldedaj.

*(Relatori i komisionit shprehet dakord.)*

Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Eltar Deda. Më pas të përgatitet zoti Malaj.

**Eltar Deda** – Të nderuar kolegë deputetë,

Ndryshimi që keni sjellë në parlament i dy neneve të ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm ndaj kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” është me plot gojë një farsë dhe një dështim i politikave tuaja në sektorin e shëndetësisë. Është një farsë, sepse, e para, bëhet në prag të fushatës elektorale, dhe e dyta, ky ligj është miratuar nga ju para dy viteve dhe duhet të hynte në zbatim në datën 25 mars. Gjatë këtij dyvjeçari ju duhej të kishit përgatitur të gjithë kuadrin ligjor, aktet nënligjore dhe vendimet e qeverisë që lipsen për ta zbatuar këtë ligj. Deri sot nuk keni bërë asgjë. Janë gjithsej 9 nene, të cilat duhej t'i kishit kaluar. Gjithashtu, duhej të

kishit përgatitur nëpërmjet kësaj të gjithë administratën e duhur, qoftë të Institutit të Sigurimeve të Shëndetit ose, siç e quani ju, të fondit, qoftë administratën e institucioneve shëndetësore publike e jo publike. Shkoni e trokisini në këto institucione dhe do të shihni se asnjë nga ato nuk është e gatshme t'i përgjigjet këtij lloj ligji, i cili duhej të ishte zbatuar në datën 25 mars. Pranë Ministrisë së Drejtësisë ndodhet institucioni i akreditimit, që funksionon prej 9 viteve, por deri sot ju nuk keni akredituar asnjë institucion shëndetësor, përveç njërit, që edhe ai është akoma projekt pilot. E kam fjalën për spitalin e Durrësit. Çudirat ndodhin në qeverinë tuaj, sepse keni 15-16 vjet që mbani akoma projekte pilote. Nuk jeni të aftë që këtë projekt pilot ta ktheni në zbatim e ta vendosni në rrugën e zhvillimit të sektorit të shëndetësisë për të rritur cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.

Një pikë tjetër, që vlen shumë për t'u diskutuar, në farsën tuaj në ndryshimin e këtyre dy neneve janë edhe spitalet, të cilat japin shërbimet shëndetësore publike, e theksoj ato publike, janë jashtë çdo lloj standardi dhe ju keni luajtur me investime të cilat kanë qenë të destinuara për këto lloj spitalesh. Ju e dini shumë mirë se sot janë mbi 20 spitale, të cilët marrin vetëm paranë e shtetit shqiptar: paguhen roje, kuzhinierë, magazinierë, por aty nuk jepet asnjë lloj shërbimi, sepse nuk ka mjek dhe ndonjë specialitet tjetër të profilizuar në sektorin e shëndetësisë.

Ajo që është më e rëndësishmja në pjesën e farsës për ndryshimin e këtij ligji, janë se këto dy nene, i keni sjellë vetëm se keni frikë t'u thoni qytetarëve: “Të dashur qytetarë, këtë të mirë publike, e cila është e detyrueshme me Kushtetutë që qeveria t'ua japë juve, ne do t'ju shesim. Ju jeni të detyruar ta paguani atë”. Këto dy nene nuk kanë fare nevojë për të rregulluar infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e këtyre dispozitave dhe as nuk kanë nevojë që t'i kushtohet rëndësi mundësisë për të rritur sa më shumë numrin e njerëzve të futen në skemën e sigurimit. Ne e dimë shumë mirë se dy janë kategoritë, të cilat paguajnë sigurime shëndetësore: ata që janë të punësuar dhe ata të vetëpunësuar. Të punësuarit në Republikën e Shqipërisë janë rreth 90 mijë, pjesa tjetër janë të vetëpunësuar.

Në bazë të Institutit të Statistikave, pjesa më e madhe e popullsisë është në zonat rurale. E gjithë kjo popullsi duhet të merret me bujqësi. Të gjithë dimë se sa punojnë dhe sa janë të siguar sot fermerët dhe bujqit shqiptarë. Sot një i punësuar e ka taksën e sigurimit 1,7% të pagës, ndërsa i vetëpunësuar e ka 155 mijë lekë në vit. Me ndryshimin që është bërë me ligjin e ri është shtuar dhe 70 dollarë të tjera. Ju keni frikë t'u thoni qytetarëve shqiptarë se: "Me ligjin e ri "Për sigurimet", do t'ua rrisim taksën për të paguar dhe për të marrë shërbimin shëndetësor". Keni nxjerrë pjesën tjetër, ku thoni se: "Do ta shtyjme deri më 1 janar". Përse do ta shtyni? Sepse është fushata dhe më datën 23 qershor ju largoheni nga pushteti. Ju keni frikë t'u thoni qytetarëve se nga data 25 mars që ka hyrë në fuqi ky ligj, dhe duhet të zbatojnë institucionet shëndetësore publike dhe jopublike, ai nuk ka gjetur zbatimin e duhur. E thashë edhe pak më përpara se kjo gjë është dështim i politikave tuaja. Ju keni mungesë vullneti të theksuar që t'i kushtoni rëndësi jashtëzakonisht shumë të madhe sektorit të shëndetit publik, pra sektorit të shëndetësisë. Këtë gjë e keni treguar, sepse keni deklaruar në vitin 2009 kur keni ardhur në pushtet se do të rrisni buxhetin e shtetit për shërbimin shëndetësor 60%. Sot që po flasim ju e keni rritur atë 20%. Çfarë keni bërë nga ana tjetër? Keni vendosur taksën TVSH për shërbimet shëndetësore dhe TVSH- në e medikamenteve të ilaçeve. Pra, ju e keni lënë atje ku ka qenë dhe e keni katandisur mos më keq këtë sektor.

Çfarë ka bërë një mungesë e tillë e vëmendjes tuaj dhe rritjes së buxhetit në sektorin e shëndetësisë? Ka sjellë mungesën e dhënies së shërbimit shëndetësor në një pjesë të konsiderueshme të territorit të Shqipërisë. Gjatë kohës që kemi prezantuar programin e Partisë Socialiste për shëndetësinë, nuk kemi thënë se çfarë ndodh në Veri ose në Jug të Shqipërisë, por kemi thënë 15 kilometra larg Tiranës, në një zonë urbane, pas orës 16:00 nuk jepet më shërbim shëndetësor. Këta qytetarë, të cilët kanë nevojë për të marrë këtë shërbim pas kësaj ore, ku do ta marrin atë? Do të paguajnë përsëri? Do të paguajnë sigurimin shëndetësor, do të paguajnë shërbimin privat të transportit, do të vijnë pranë qendrës së dhënies së shërbimit shëndetësor në zonën urbane, ku do të ndeshen

me tarifën e larta që i keni vendosur ju. Përsëri qytetari do të vazhdojë dhe do të jetë gjithmonë nën dhunën e taksave tuaja.

Duke pasur një skemë të tillë të dhënies së shërbimit shëndetësor, ju keni rënë pre e korrupsionit. Është fatkeqësi e madhe që korrupsionin në popullsi ju e keni adresuar drejt personelit shëndetësor. Jo, nuk janë mjekët të korruptuar, as infermierët, por është skema e funksionimit tuaj, të cilën e keni vendosur për t'u zbatuar dhe është ajo skemë e cila pëll korupsionin me tarifën, taksat tuaja dhe me mungesën e vëmendjes dhe të investimeve në këtë sektor tejet të rëndësishëm.

Të nderuar kolegë, ju detyrimisht do ta votoni këtë projekt. Ai do të shtyhet deri në janar të vitit 2014, por e dini shumë mirë që nuk ka për t'u zbatuar dhe nuk ka për t'u vendosur në funksionim, sepse më datën 23 qershor me largimin tuaj nga pushteti, nuk do të jetë më kjo lloj dhënie e shërbimit shëndetësor në Shqipëri. Ne do t'u ofrojmë qytetarëve shqiptarë një shërbim shëndetësor, ku kjo e mirë publike, e cila është e sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë, do t'u jepet atyre falas.

Ju faleminderit!

**Jozefina Topalli** - Zoti Malaj ka fjalën. Nuk është.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Zonja Klodiana Spahiu.

**Klodiana Spahiu** – Për tetë vjet rresht nuk e keni vrarë ndonjëherë mendjen për sistemin shëndetësor në Shqipëri, këtë e keni vërtetuar, por edhe tani në prag të largimit tuaj, keni sjellë një nen të një ligji, i cili ka nëntë vjet që qëndron në sirtar. Prej një muaji, çdo qytetar e di se ka hyrë në fuqi ligji "Për shërbimin shëndetësor të detyrueshëm", të cilin e kanë propaganduar si një arritje më të madhe dhe si një ligj, që si me urdhër të peshkut, do ta shndërrojë sistemin tonë shëndetësor në nivelin e vendeve më të zhvilluara europiane, por ky ligj në thelb është vetëm dështimi i radhës, sepse ai as nuk e zgjidh dhe as nuk e përmirëson situatën dramatike në sektorin e shëndetësisë. Ai u përdor vetëm për propagandë dhe për fushatë elektorale. Ky ligj nuk ndryshon kontradiktën themelore që ka sistemi i sigurimit të kujdesit shëndetësor që funksionon në vendin tonë prej 18 vjetësh dhe prej 18 vjetësh vetëm 16% e popullsisë arrin të kontribuojë. Pra, vetëm 470 mijë shqiptarë

kontribuojnë në këtë skemë sigurimi. Do t'ju rikujtoj pak fjalë, pak premtime të Sali Berishës në muajin nëntor të vitit 2009: “zhvillimi i shëndetit, edukim shëndetësor dhe parandalim i sëmundjeve do të jenë drejtimet themelore të sistemit tonë shëndetësor. Buxheti për shëndetësinë do të rritet 60%; sistemi i menaxhimit dhe financimi i sistemit të shërbimit shëndetësor do të reformohet tërësisht; do të vendosim praktikat më të sigurtat të luftës kundër korrupsionit në sistemin tonë shëndetësor; do të hiqet TVSH-ja për mallrat dhe shërbimet shëndetësore në sektorin privat; në spitalet tona do të instalohen teknologji dhe laboratorët më modern. Blerja e shërbimeve për qytetarët do të shtrihet edhe në sektorin privat; sigurimet shëndetësore do të shtrihen për të gjithë qytetarët”.

Qytetarë shqiptarë, a i dëgjuat këto premtime? Janë të muajit nëntor të vitit 2009. Ku jemi sot? Sot vijmë përsëri me një nen për t'u tallur me ju, me një nen që kanë 8 vjet. Hartimi i këtij projektligji ka filluar që në vitin 2004 dhe qëllimisht e kanë shtyrë pa fund, jo për të realizuar këto premtime, por për të degraduar sistemin shëndetësor deri në këtë ditë që jemi sot, kur, ndërkombëtarët kanë 22 vjet që na rrinë pranë për të hartuar këtë projektligj, janë tërhequr dhe janë të sigurt që nuk mund të arrihet më asnjë ndryshim në këtë projektligj.

Prej shumë vitesh që funksionon ky ligj, ju thashë kontribuojnë vetëm 16% e qytetarëve shqiptarë, dhe ky ligj nuk zgjidh problemin e 1 milion të papunëve që ka sot në Shqipëri, të cilët janë lënë në mëshirë të fatit dhe duhet të paguajnë nga xhepi i tyre për çdo shërbim shëndetësor.

50 mijë vetë kontribuojnë në fshat. Sa banorë jetojnë në fshat? Sa fshatarë ka? Sipas statistikës janë 46% e popullsisë. Pra, afërsisht janë 1 milion e 370 mijë vetë. Shikojeni vetë se në ç'raport qëndron pas 18 vjetësh kjo skemë në fshat. Këta njerëz jo vetëm që janë shumë pak kontribues, por nga pikëpamja e kujdesit shëndetësor ata nuk mund të marrin kujdes shëndetësor. Pra, njerëzit që nuk janë në punë, nuk mbrohen nga shteti dhe nuk mund të kenë mbulim shëndetësor.

Problem tjetër i këtij projektligji është se problemi kronik i keqfinancimit nuk zgjidhet, sepse në fuqi mbetet skema aktuale me 7% të

shpenzimeve për shëndetin. Siç e dimë, në këtë skemë aktuale 33% e mbulon shteti. Pjesa më e madhe del nga xhepat e qytetarëve. Kjo skemë aktualisht ka dështuar dhe nuk mund të funksionojë, por qytetarët shqiptarë presin shumë, presin dhe ëndërrojnë që ky ligj të hynte në fuqi. Ky sistem me bazë kontributive nuk arriti asnjëherë të realizojë qëllimin dhe parimin themelor, atë të solidaritetit që pretendohet; paguajnë të gjithë dhe të përfitojë ai që ka nevojë. Nuk gjen shembull më të mirë për ta konkretizuar këtë, sepse fakti që një i siguruar mund të përfitojë shërbim shëndetësor, sepse derdh kontribute, dhe një i pasiguar nuk përfiton shërbim shëndetësor, tregon se kjo skemë nuk ka në thelb solidaritetin, por individualitetin. Si mund të jetë me parim dhe frymë solidare një ligj kur vetë ligji ka sanksionuar pabarazinë të kategoritë e ndryshme që derdhen kontribute? Pikërisht neni për të cilin jemi mbledhur sot, shtyhet për muajin janar të viti 2014, vetëm për qëllime elektorale dhe pa u menduar mirë se cila do të jetë kostoja që duhet të paguanin të vetëpunësuarit. Në qoftë se një i punësuar paguan 3.4%, një i vetëpunësuar duhet të paguajë tri herë më shumë dhe të mendosh që një i vetëpunësuar është njëkohësisht një taksapagues i dyfishtë, që detyrohet të paguajë edhe taksa kombëtare, edhe taksa lokale.

Nuk mund të gjesh një ligj që brenda një muaji, pasi ka hyrë në fuqi ta amendojmë. Kuptohet se vetëm shkruhej për solidaritet, por praktikisht i gjithë ligji është pabarazi.

Themi dhe flasim në ligjin e ri për sigurimet shëndetësore, kemi ruajtur sistemin kontributiv si më të konsoliduarin dhe më efektivin, por nëse shikojmë burimin e të ardhurave, është krejt e kundërta. Ju thashë pak më parë se vetëm një pjesë prej 33%-ësh e mbulon shteti. Po pjesën tjetër? Kontributet vetëm 20%. E thënë ndryshe, me këtë raport të ardhurash në buxhetin e sigurimeve shëndetësore kemi një formë sistemi, që nuk ka lidhje fare me taksimin e përgjithshëm dhe që nuk mbulon pjesën më të madhe të qytetarëve. Deri më sot nga Këshilli i Ministrave nuk është miratuar asnjë akt nënligjor, i cili do ta bënte ligjin funksional, siç parashikohet në nenin 41 të këtij ligji. Kanë kaluar plot 2 vjet që nga dita e miratimit të ligjit, që nga shkurti i viti 2011, kohë, e cila duhet të shërbente pikërisht për

plotësimin e këtij kuadri ligjor dhe për daljen e akteve nënligjore.

ISKSH-ja, sipas ligjit të ri, do të quhet fond, por deri tani ne nuk dimë se si do të funksionojë, nga kush do të drejtohet, çfarë roli do të ketë dhe çfarë forme menaxhimi dhe burimesh financiare do të ketë? Mungesa e standardeve të miratuara për institucione shëndetësore të të gjitha niveleve në vend është një pengesë tjetër për të bërë të zbatueshme nenet e këtij ligji. E pra, kur në një vend nuk ekzistojnë standarde në institucionet e shërbimi shëndetësor, si mund të flasim për akreditimin e tyre, i cili është kusht detyrues për financimin dhe blerjen e shërbimeve shëndetësore prej fondit nga ato?

Siç e shikoni, si shumë ligje në Shqipëri, edhe me këtë ligj do të mjaftohemi vetëm duke thënë që e kemi, por për qytetarët nuk është. Ligji detyron fondin që financimin dhe blerjen e shërbimeve shëndetësore ta kryejë nëpërmjet paketave të shërbimeve. Deri më sot vetëm për shërbimin shëndetësor parësor kemi një paketë bazë të miratuar me VKM, ndërsa për shërbimin spitalor dhe atë universitar as që bëhet fjalë.

Gjithashtu, mungojnë protokollat e miratuara të mjekimit, të cilat janë baza reale për të realizuar kostot e shërbimeve shëndetësore. Siç parashtrova, është një zinxhir i tërë aktesh vendimesh, procedurash mjekësore dhe administrative, të cilat, sot për sot, janë vetëm në formë thashethemesh, por për të miratuar këto në ligj, aktualisht nuk kemi asgjë.

Së fundi, nuk mund të mos përmendim mashtrimin e madh se skema e sigurimeve shëndetësore do të fillojë me financimin edhe në institucionet private. Të jeni të sigurt se pa të gjitha këto që thashë nuk mund të bëjmë dot, sepse këto, së pari, duhet të vërtetohen ligjërisht. Ndaj e mira është të mos i mashtrojmë qytetarët shqiptarë për përfitimin që do të kenë në sistemin shëndetësor.

Tashmë të gjithë e dimë, tashmë nuk është nevoja që të dalin në mënyrë deklarative drejtues të rinj të institucioneve e të thonë se sot QSUT-ja ka 23 milionë dollarë borxh, apo brenda një nate janë bërë tendera me 1 miliard lekë. Jo, jo, këta njerëz që drejtojnë sot kanë jetuar në Shqipëri, kanë qenë shumë pranë drejtuesve tanë, kanë qenë shumë pranë kësaj qeverie dhe e kanë dëgjuar nga kjo foltore se cili ka qenë realiteti i

sistemit shëndetësor, sa ka qenë borxhi i QSUT-së dhe si ka shkuar historia e tenderëve.

Ndaj sot nuk i takon askujt të justifikohet dhe të godasë sistemin shëndetësor, sepse janë ata të parët që e kanë ditur shumë mirë se cili është borxhi në sistemin shëndetësor. Ndaj, ju lutem, mos vazhdoni me mashtrimin e radhës për shqiptarët. Ne jemi të vendosur në sistemin shëndetësor universal, jemi të vendosur për shërbimin shëndetësor kombëtar, i cili do t'u ofrojë të gjithë shqiptarëve shërbim shëndetësor jo duke i ndarë disa në punë e disa të papunë, disa të nënës e disa të njerëks. Shërbimi shëndetësor është për të gjithë dhe një shtet social duhet t'ia krijojë kushtet qytetarëve të vetë për shërbim shëndetësor.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Zoti Beci, urdhëroni!

**Astrit Beci** – Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot ne po shqyrtojmë projektligjin “Për një ndryshim në ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.” Ligji ka hyrë në fuqi më 24 mars 2013, dhe është hartuar më 24 shkurt 2011. Për dy vjet për zbatimin e tij duhet të dilnin 6 VKM. Çuditërisht qeveria, me papërgjegjshmërinë që e karakterizon, nuk ka nxjerrë asnjë.

Në raportin e sotëm të projektligjit thuhet se qëllimi i projektligjit është shtyrja e afatit të hyrjes në fuqi të neneve 7 dhe 8 të ligjit ekzistues deri në datën 1 janar 2014. 26 muaj nuk i kanë mjaftuar qeverisë që të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e këtyre depozitave; 26 muaj nuk i kanë mjaftuar kësaj qeverie që të nxjerrë 6 vendime të Këshillit të Ministrave; 26 muaj gjumë, papërgjegjshmëri, mungesë guximi për reformat. Unë nuk çuditem se jo 26 muaj, por ka 46 muaj që kjo qeveri nuk paguan dëmshpërblimet e banorëve të zonave të përmbytura në Shkodër, përmbytjes së herës parë dhe jo të asaj të shtatë.

Më 16 shtator 2009 në Kuvendin e Shqipërisë Kryeministri do të deklaronte rritjen e buxhetit për shëndetësinë 60%, kjo rritje e bërë sivjet nuk realizon as efektet e rritjes së çmimit të ilaçeve me 10% për TVSH. Për ta konkretizuar në vitin 2009 buxheti i urgjencës ishte vetëm 300 milionë dollarë, në vitin 2013 ishte 360 milionë dollarë. Vetëm efektet e

TVSH-së dhe nënçmimi i lekut e barasvlerësojnë dhe tregojnë se rritja e 60%-it e deklaruar në buxhetin për shëndetësinë mungon. Në të vërtetë, sipas premtimeve, do të duheshin 450 milionë dollarë për urgjencën. Pra, mungojnë 90 milionë dollarë. Janë 90 milionë dollarë më pak për emergjencën; 90 milionë më pak për cilësinë e emergjencës dhe në trajtimin e të sëmurëve.

Periodha 2009-2013 është dështimi i programit të qeverisë së PD-së. Anketimet e bëra nga Banka Botërore me organizatat botërore shëndetësore USAID-i tregojnë qartë se sistemi shëndetësor është mbërthyer nga një korrupsion galopant i krahasuar vetëm me atë të vendeve afrikane. Rritja e TVSH-së së ilaçeve me 10% rriti artificialisht të gjitha çmimet e tyre. Ligji i ri i sigurimeve shëndetësore lë jashtë mbulimin e një pjesë të konsiderueshme të popullsisë në moshë pune.

Ligji i sotëm rrit 45% më shumë kontributin e detyrueshëm për sigurimet shëndetësore. 26 muaj nuk i dilnin qeverisë që të miratonte vendimet e Këshillit të Ministrave që mund ta bëjnë ligjin të zbatueshëm. Në 4 vjet programi është i dështuar në të gjitha pikat e tij. Po të shikojmë në programin e qeverisë së PD-së, në vitet 2009-2013, thuhej se reforma do të përfshinte një organizëm më të mirë territorial, duke harmonizuar shtrirjen e shërbimit parësor me atë spitalor, si dhe atij publik dhe privat. Kemi parë se nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Thuhej se reduktimi i korrupsionit në sektorin e shëndetësor do të bazohej, në radhë të parë, në masat me natyrë parandaluese dhe që mbështeten në krijimin e iniciativave antikorrupsion. Nuk kemi parë asnjë të tillë dhe nuk pasur asnjë rast dënimi të këtij korrupsioni, por kemi parë një rritje të kulturës së pandëshkueshmërisë.

Në themel të këtyre relacioneve janë vetëqeverisja e qendrës shëndetësore, transparenca, përgjegjshmëria, vlerësimi i performancës institucionale dhe individuale përkundrejt motivimit dhe shërbimit, sipas meritës. Kemi parë që nuk është bërë asgjë për vetëqeverisjen e qendrave shëndetësore; nuk është bërë asgjë për të rritur transparencën; asgjë për të vlerësuar performancën institucionale. Vazhdojmë në të njëjtat kushte dhe me spitale të paakredituara. Qeveria është vendosur të rrisë ndjeshëm masën e financimit në shëndetin publik

me investime kapitale. E pamë se çfarë ka ndodhur me urgjencën me rritje efektive, me një stanacion dhe me të njëjtin buxhet prej sa e sa vitesh.

Në ç'gjendje paraqitet sot situata? Gjysma e shpenzimeve përballohen nga pagesat e drejtpërdrejta të qytetarëve. 65 milionë dollarë mbulohen nga kontributet e sigurimeve shëndetësore; 295 milionë dollarë është nga taksimi i përgjithshëm. Në çdo 100 lekë, 60 paguan qytetari, 33 vijnë nga taksat dhe 7 nga kontributet. Sistemi kontributiv është regresiv, pasi rritja e pagës pakëson normën efektive të kontributeve. Pra, pas 18 vjetësh mund të themi se sistemi kontributiv i sigurimeve shëndetësore rezultoi joefektiv. Në shkurt të vitit 2013 spitalit iu hoq edhe e drejta për kurim të barnave. Sot llojin dhe sasinë e këtyre barnave duhet ta vendosë vetëm ministri i Shëndetësisë. Ne angazhohemi se do të punojmë ndryshe; ne angazhohemi se do t'u ofrojmë kujdes shëndetësor universal për të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Shqipëri. Ne do të ngremë shërbimin shëndetësor kombëtar, që do të jetë blerësi i shërbimit të kujdesit shëndetësor dhe që do ta ofrojë atë pa pagesë për të gjithë qytetarët. Kështu ne do të arrijmë akses universal, të plotë për të gjithë shtetasit, shërbim shëndetësor me cilësi të lartë në përgjigje të nevojave të të sëmurëve dhe të të shëndetshëmëve, kujdes shëndetësor cilësor dhe efektiv për rezultate më të mira dhe përqendrim eficient të burimeve financiare njerëzore. Ky është model që funksionon me sukses të plotë në shumë vende të botës në Britaninë e Madhe, në Kanada, në Spanjë, në Danimarkë, në Itali, në Portugal. Ky model siguron shërbim shëndetësor gjithëpërfshirës cilësor dhe eficient. Pra, me aplikimin e këtij modeli çdo qytetar shqiptarë do të marrë shërbimin shëndetësor bazë e me cilësi të kënaqshme nga sistemi shëndetësor.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Zoti Ruka, urdhëroni!

**Ethem Ruka** - Zonja Kryetare!

Zotërinj deputetë,

Ky është një projektligj tërësisht elektoral. Një mashtrim disamujor për të vetëpunësuarit, me synimin që t'u marrin disa vota të pamerituara për zgjedhjet elektorale të këtij viti.

Mashtrim për të mosarmiqësuar të vetëpunësuarit, të cilët që nga 25 marsi i këtij viti do të duhet të paguanin edhe 45 % më shumë nga ç'paguajnë sot për sigurimin shëndetësor. Kjo, në përputhje me ligjin aktual të miratuar prej 2 vjet, 1 muaj e dy ditë më parë.

Zyrtarisht, sot janë të deklaruar 65 000 individë të vetëpunësuar, të cilët preken nga ligji aktual dhe synohet të mashtrohen deri në janar të vitit 2014 nga ndryshimi i projektligjit që po diskutohet në këtë seancë parlamentare. E thënë më shkoqur, një i vetëpunësuar do të paguajë afërsisht 6000 lekë më shumë për këtë kontribut të përlogarituri mbi bazën e pagesës mesatare prej 54 885 lekësh. Nëse deri tani përlogaritja e këtij kontributi ishte 3,4 % e pagesës, në bazë të neneve 7 dhe 8 të këtij projektligji, ajo do të shkojë në 7% të mesatares, midis pagës mesatare dhe asaj minimale. Kjo shumë duhet të arkëtohet duke filluar nga 25 marsi i këtij viti, ndërkohë që sot jemi më 25 prill, pra një muaj me vonesë.

Në fakt, relacioni i projektligjit të sotëm është shumë i thatë dhe nuk shpjegon asgjë. Është i tillë, sepse kërkon të fshehë të vërtetën. Ai është shembulli më i qartë se çfarë trukesh mund të përdorë kjo qeveri në një fushatë elektorale. Është paradoksale të dëgjosh se kjo është qeveria e taksave më të ulëta.

Nga ana tjetër, projektligji "Për sigurimin shëndetësor" e rrit edhe më shumë barrën e detyrimeve për të vetëpunësuarit. Sigurisht, në kohën kur është miratuar ky ligj, PS-ja e ka kundërshtuar, duke dhënë argumentet e veta.

Sot është momenti të bëjmë transparente politikën e dështuar shëndetësore të kësaj qeverie. Ekspertët e thirrur në Komisionin e Ekonomisë thanë: "Ka munguar infrastruktura dhe për këtë do të duhen edhe disa muaj të tjerë", pra deri në janar të vitit 2014 për të aplikuar këto dy dispozita. Cila infrastrukturë ka munguar? Një përlogaritje e thjeshtë për të nxjerrë pagesën mesatare mbi bazën e asaj maksimale dhe minimale? Të mos e dëgjojë askush, sepse ky nuk është argument. I vetmi argument janë votat. Pastaj, pas disa muajsh të vetëpunësuarit do të paguajnë edhe 6000 lekë të tjera për çdo muaj.

Ekspertët sollën edhe argumentin tjetër, tërësisht pa vlerë, se gjoja duke shtyrë afatin e zbatimit të këtyre dy neneve, do të ketë një rritje të të vetëpunësuarve. Çfarë kuptimi ka kjo dhe ku mbështetet ky argument? Shkurt janë

argumente për të fshehur thelbin e argumentit kryesor, pra të trukut elektorale për një grusht votash të pamerituara. Kjo është në vazhden e objektivave për të mbajtur taksat të ulëta. Për këtë arsye, sipas ekspertët, propozohet një periudhë disamujore, deri në fillim të vitit të ardhshëm për hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave. Nuk ka ku të shkojë më qartë e më troç se kaq: t'i mbajmë edhe disa muaj të ulëta taksat, sepse do të na duhen votat. Pra, në janar të vitit 2014 do të shihemi përsëri me detyrime më të larta në sportelet e shtetit. Nuk besoj se kaq ndonjë të vetëpunësuar që të mos e kuptojë këtë mashtrim trashanik elektorale.

Rritja e kontributit për të vetëpunësuarit përbën në thelb një aspekt të vogël të dështimit të politikave mjekësore për sigurimin shëndetësor të popullatës. Këto politika janë të dështuara. Sot numri i atyre që janë të pasiguruar është shumë herë më i madh se i atyre që janë të siguruar. Shkurt, një shërbim shëndetësor diskriminues, të cilin qytetarët shqiptarë, veçanërisht të papunët, si edhe grupimet sociale të markinalizuara nuk e marrin dot, duke u penalizuar nga politikat e qeverisë së tyre.

Banka Botërore, edhe gjatë ditëve të fundit, e ka këshilluar vazhdimisht qeverinë shqiptare lidhur me ndryshimet e shpeshta të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Skema vjen duke rritur defixhitin dhe kërkon gjithmonë e më tepër para nga taksapaguesit shqiptarë. Nuk ka si të jetë ndryshe! Nëse buxheti i ISKSH-së është rreth 30,8 miliardë lekë, vetëm 24 deri në 25 % të tij vjen falë kontributeve të detyrueshme. Pjesa tjetër, prej gati 75%, mbulohet nga buxheti i shtetit. Vetëkuptohet se ata që paguajnë kontribute, në fakt paguajnë dy herë. Një herë që u mbahet çdo muaj nga pagesa e tyre dhe një herë në mënyrë indirekte për shumën që paguan buxheti i shtetit.

Politikat shëndetësore e kanë lënë vendin në një situatë të mjeruar. Vazhdon e njëjta histori: spitale pa infrastrukturë, pa fuqinë e duhur diagnostikuese, pa medikamente, me pagesë në dorë, pa shërbime ambulatorie në zonat periferike të vendit, pa buxhet të mjaftueshëm, diskriminues për të papunët, për ata që marrin ndihmë sociale, me çmime medikamentesh të rritura, pa vizion, të mbytur nga politikat korruptive për shërbimet dhe pa politika parandaluese. Ne jemi një vend me



tregues shumë të lartë të sëmundjeve kardiovaskulare, tumorale dhe sa e sa mangësi të tjera.

Qeveria rreket për suksese në fushën e mjekësisë, ndërkohë që perceptimi i qytetarëve për shërbimin shëndetësor është skandaloz. Mjafton t'i referohemi vetëm fondit të akorduar për citostatikët, medikamente të dorës së parë, për ata që fatkeqësisht vuajnë nga sëmundje tumorale. Ky fond, në rastin më të mirë, nuk mbulon as 30 % të nevojave të vuajtësve, të cilët arrijnë zyrtarisht deri në 6000 raste të reja në vit. Mjafton të përmendim tregun e medikamenteve. Prej dy vjetësh çdo kokërr aspirinë dhe çdo medikament tjetër kushton 10 % më shtrenjtë. Nga të gjitha medikamentet që blejnë qytetarët shqiptarë, qeveria jonë ka arkëtuar afërsisht 40 milionë euro në buxhetin e shtetit, si taksë për sëmundjen e qytetarëve të vet. Kurse, 40 milionë euro të tjera në vit, si taksa xhepochash në korridorët e spitaleve për personelin shëndetësor, pra një vjedhje tjetër kjo që u bëhet rëndom, pothuajse të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Shoqëria shqiptare është kthyer në një shoqëri konsumi, ku, fatkeqësisht, thuhet çdo gjë shihet si mall që duhet shitur apo blerë. Nga ky rregull nuk bëjnë përjashtim as disa shërbime jetike të domosdoshme për çdo shoqëri, siç janë edukimi, shëndetësia, kultura, komunikimi e të tjera. Do të duhet të ishte ndryshe dhe kështu do të jetë pas 23 qershorit. Elementet e domosdoshme të jetës së një shoqërie demokratike do të trajtohen si një e mirë e përbashkët dhe e arritshme nga të gjithë. Kështu do të konsiderohet edhe kujdesi shëndetësor për qytetarët e këtij vendi. Nisur nga fakti se shëndetësia shqiptare nuk arrin të realizojë asnjë funksion të saj bazë, pra as parandalimin, as diagnostikimin, as kurimin dhe as rehabilitimin, do të na duhet të bëjmë një ndërhyrje të thellë drastike dhe të menjëhershme.

Vizioni ynë për shëndetësinë është tërësisht i ndryshëm nga ai i kësaj qeverie. Falë reformës që kemi trajtuar dhe që do ta vëmë me siguri në jetë pas 23 qershorit, do të bëjmë një ndërhyrje radikale për të ofruar një shërbim shëndetësor, ku asnjë qytetar të mos ngelet i përjashtuar nga sistemi shëndetësor, siç ndodh sot me rreth 1 milion shqiptarë. Sfidë jonë është t'u rikthejmë qytetarëve shqiptarë besimin e humbur të shërbimi shëndetësor.

Nëse sistemi i sotëm i financimit të shëndetësisë nxit korrupsionin, burokracinë e tepruar dhe diskriminimin, paketa jonë reformuese do të jetë krejtësisht e ndryshme. Të gjithëve atyre, që varfëria apo papunësia i ka lënë pa sigurim shëndetësor, ne do t'ua ofrojmë atë falas dhe ata do të sigurohen nga shteti. Ne do ta heqim menjëherë taksën 10% në shërbimin shëndetësor dhe barnat mjekësore. Nuk do të ketë asnjë produkt farmaceutik të regjistruar, që do të shitet në vendin tonë me një çmim më të lartë se në vendin e origjinës. Po ashtu, ne do të ndërtojmë institucionin e shërbimit kombëtar shëndetësor, ku të gjithë do të jenë të siguar dhe do të kenë mundësi të marrin kujdesin e duhur shëndetësor, pavarësisht nga të ardhurat financiare, gjendja shoqërore, vendbanimi, gjinia apo moshë. Duke respektuar përkushtimin e mjekëve e personelit ndihmës, ne do të marrim përsipër të ndërtojmë një partneritet e dialog të frytshëm për çështje madhore të shëndetësisë, siç janë ato që lidhen me formimin e kërkimit shkencor, autonominë profesionale, përfshirjen në qeverinë klinike e të tjera.

Alternativa jonë është e qartë dhe në shërbim të qytetarëve të këtij vendi. Ajo është aq e qartë, sa qeveria aktuale ka filluar ta kopjojë.

Qytetarët shqiptarë do ta votojnë programin për rilindjen shqiptare, sepse ai është programi i interesave të tyre jetike. Përpjekjeve të qeverisë aktuale, në largim e sipër me ose pa KQZ, u ka ardhur fundi. Sovrani mezi pret ta largojë këtë qeveri. Këtë ju e ndiheni, sado që i jepni gurajë vetes. Kjo ditë po afron. 23 qershori do të jetë fillimi i ri dhe do të lërë pas një të kaluar të hidhur.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr zoti Turku.)*

**Ardjan Turku** – Faleminderit, zoti Ruka!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

*(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)*

Faleminderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna’ A dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’ A ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit të Durrësit”.

Në emër të komisionit përkatës, zonja Aliolli keni fjalën.

**Ledina Aliolli** – Faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjen e datës 17 prill 2013 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna’ A dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’ A ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit të Durrësit”, propozuar nga Këshilli i Ministrave në mbështetje të pikave 1 dhe 121 të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Në mbledhjen e zhvilluar nga komisioni, për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve dhe për të prezantuar këtë projektligj morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes Istisna’ A dhe marrëveshje së Agjencisë Istisna’ A ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit të Durrësit përmes një huaje 7,58 milionë dollarë.

Përmes këtij projektligji propozohet ndërtimi i një porti peshkimi, i cili përfshin bonifikimin e sipërfaqes 1,8 hektarë tokë, ndërtimin e një dallgëpritëse kryesore, ndërtimin e tri pengesave dallgëpritëse, ndërtimin e bankinës, ndërtesave për organizatën e menaxhimit të peshkimit dhe infrastrukturën për funksionimin e portit të peshkimit. Gjithashtu, sektorit të peshkimit i sigurohet një port operacional, një mjedis i sigurt për ngarkim-shkarkimin dhe akordimin e anijeve të peshkimit, ndërkohë i lirohet hapësira e zënë nga anijet e peshkimit, portit aktual tregtar.

Ky projekt i propozuar është mjaft i rëndësishëm. Projekti fillestar është hartuar në vitin 2006, i cili parashikonte marrjen e një huaje prej 8,78 milionë dollarë. Gjatë rishikimit të këtij projekti rezultoi e nevojshme rritja e kostos së tij për shkak të spostimit të portit në një vend tjetër. Pas rishikimit, kostoja në total arriti në shumën 16,36 milionë dollarë.

Ky projekt do të zhvillohet në dy faza:

Faza e parë do të financohet nga fonde, të cilat ishin në dispozicion.

Në fazën e dytë do të kemi një financim shtesë prej 7,58 milionë dollarë, e cila do të financohet nga Banka Islamike për Zhvillim, me një periudhë shlyerje prej 15 vjetësh, që fillon

pas një periudhe realizimi deri në 3 vjet. Çmimi i shitjes do të përllorëritet në fund të periudhës së realizimit dhe bazohet në koston e kapitalit plus një shtesë të normës libor 6-mujor në dollarë.

Projekti parashikohet të përfundojë në 31 dhjetor të vitit 2014. Mbështetur në argumentet e sipërcituara, duke vlerësuar domosdoshmërinë e këtij projektligji, Komisioni për Ekonominë dhe Financat e miratoi atë me konsensus.

Faleminderit!

**Ardjan Turku** – Faleminderit!

Kalojmë në shprehjen e komisioneve.

Në emër të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të drejtat e Njeriut?

*(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)*

Faleminderit!

A ka pyetje? Nuk ka.

Kalojmë në diskutime.

Nga opozita kanë regjistruar emrat zotërinjtë: Edison Konomi dhe në emër të grupit, zoti Klosi.

Urdhëroni, zoti Konomi!

**Edison Konomi** – Të nderuar kolegë!

Sot na është paraqitur për miratim marrëveshja me Bankën Islamike për Zhvillim, për marrjen e një kredie shtesë prej 7,58 milionë dollarë për përfundimin e ndërtimit të portit të peshkimit në Durrës.

Duhet theksuar se ky projekt ka pasur një kosto fillestare shumë më të ulët, me një financim prej rreth 8,78 milionë dollarë. Tashmë kërkohet një shtesë financimi gati e dyfishuar me vlerën fillestare të projektit, me një total financimi prej 16,36 milionë dollarë.

Në komision, kjo u argumentua thjesht me një rishikim të projektit. Disa të tjerë mundohen ta lidhin me mosmarrëveshjet që kanë pasur me Bashkinë e Durrësit në lidhje me këtë projekt. Edhe pse ju mundoheni ta shikoni këtë si një mundësi për të goditur Bashkinë e Durrësit, më duhet të sqaroj, në respekt të gjithë qytetarëve durrsakë apo më shumë, në respekt të komunitetit të peshkatarëve, të cilët janë të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ky investim, se ky projekt, që në fillimet e veta, është menduar shkurt dhe pa vizion. Kjo është argumentuar nga shumë specialistë të fushave të ndryshme, qofshin këta mjedisorë, arkitektë apo qytetarë të thjeshtë të Durrësit, të cilët përfitojnë

ose ndikohen në mënyrë negative nga projekte që kanë të bëjnë me këtë qytet.

Gjithashtu, fakti që ju vini këtu për të dyfishuar vlerën e financimit, pasi pranohet edhe nga ju, që janë bërë ndryshime në projekt dhe fakti që vlera është dyfishuar tashmë në 16,36 milionë dollarë, tregon më së qarti se këto nuk janë ndryshime të vogla, apo për shkak të ndryshimit të çmimeve, ku për të qenë të sinqertë, në këtë periudhë nuk shoh ndonjë ndryshim në çmime, që të ndikojë në dyfishimin e kostos së ndërtimit, kjo rritje kostoje tregon se projekti fillestar ishte projektuar keq dhe se bashkia e Durrësit ka pasur të drejtë në kundërshtimin e këtij projekti që në fillimet e tij.

Më duhet të sqaroj se në lidhje me këtë investim janë bërë takime të ndryshme në nivel ekspertësh urbanistë për të marrë mendimet e tyre në lidhje me projektin. Gjithashtu, është vlerësuar shumë edhe opinioni i qytetarëve të Durrësit, të cilët e shohin Durrësin e së ardhmes si një qytet turistik.

Ky projekt është mbështetur fort nga ju, kolegë të maxhorancës, pa vlerësuar në asnjë moment se çfarë efektesh do të kishte porti i ndërtuar në pikën më të afërt me shëtitoren kryesore të qytetit të Durrësit, duke mos studiuar se çfarë do të ndodhte me trafikun e automjeteve, sidomos gjatë periudhës së verës, kur Durrësi tashmë po përballlet me një trafik të rënduar, pa vlerësuar në asnjë moment opinionin e qytetarëve dhe efektet negative mjedisore që do të kishte ndërtimi i këtij porti pranë shëtitores "Taulantia".

Të mos harrojmë se qyteti i Durrësit është një nga destinacionet më të mëdha turistike në vend, i cili pret edhe fluksin më të madh të turistëve dhe si i tillë përballja me këta të fundit duhet të jetë dinjitoze, siç e meriton një qytet i tillë.

Shpesh kam dëgjuar se porte të tilla pranë qendrave apo shëtitoreve të qyteteve ka në shumë vende turistike, qoftë në rajon apo edhe më gjerë. Duhet ta pranojmë se kjo është e vërtetë, por duhet të themi edhe një të vërtetë tjetër që këto porte janë ndërtuar 50 apo më shumë vjet më parë dhe në të vërtetë mbartin edhe vlera historike. Por të ndërtosh një port të tillë në vitin 2013 në qendër të qytetit është mungesë vizioni për të ardhmen. Ne duhet të fokusohemi në projekte afatgjata, në

përmirësimin e infrastrukturës duke krijuar mundësi që vizitorët e huaj të mund të eksplorojnë çdo alternativë që jep ky qytet, duke u bazuar në eksperiencat pozitive të vendeve të rajonit apo edhe më gjerë.

Në asnjë moment ne nuk kemi qenë kundër ndërtimit të portit të peshkimit. Në fakt, duhet të themi se ka qenë pikërisht PS-ja iniciatorja e këtij projekti, pasi ne mendojmë se flota e peshkimit dhe ngritja e industrisë së përpunimit të peshkut, përpos mundësive të tjera ekonomike që ofron qyteti i Durrësit, është një mundësi e mirë punësimi dhe një trashëgimi me vlera e cila duhet çuar përpara.

Ne duhet të impenjohemi më shumë për këtë industri. Në mënyrë imediate ne duhet të vendosim rishikimin e taksave, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në koston e peshkimit, duke e bërë kështu produktin tonë të pakonkurrueshëm në rajon. Ne duhet të impenjohemi për t'u dhënë mundësi peshkatarëve të rinovojnë mjetet e tyre të lundrimit nëpërmjet politikave lehtësuese fiskale apo financime të ndryshme, të cilat do të përmirësonin flotën tonë të peshkimit.

Për këtë arsye, në mënyrë që të harmonizojmë vlerat turistike të qytetit me industrinë e peshkimit, ne mendojmë se vija bregdetare apo edhe territori aktual brenda portit të Durrësit mund të ofronte vende që t'i përshtateshin më së miri portit të peshkimit. Them që të harmonizojmë vlerat turistike për faktin se tashmë aty ku po ndërtohet porti i peshkimit mund të ndërtohej një port turistik për jahte, për të pritur vizitorë të huaj, duke shfrytëzuar edhe afërsinë e këtij porti me shëtitoren "Taulantia", duke ngritur ambiente argëtuese që të jenë sa më atraktive për turistët, elemente të cilat sot mungojnë jo vetëm në qytetin e Durrësit, por në shumë qytete turistike në vend.

Edhe kjo e sotmja është në vazhden e trillimeve elektorale, dhunimeve të institucioneve të pavarura, duke politizuar çdo strukturë shtetërore, duke goditur profesionistët e vërtetë dhe duke ngritur kultin e militantëve. Këtë keni bërë deri më tani.

Por të jeni të sigurt se asnjë manovër nuk do t'ju lehtësojë humbjen. Përgjigjen kjo maxhorancë do ta marrë në datën 23 qershor kur çdo shqiptar do të votojë për të ardhmen e tij, do

të votojë për një shtet në shërbim të qytetarëve, do të votojë për projektet evropiane, do të votojë për rilindjen.

Faleminderit!

**Ardjan Turku** - Faleminderit!

Diskutantët e krahut të djathtë janë tërhequr.

Fjalën e ka zoti ministër.

**Fatmir Mediu** - Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të them që në fillim që industria e peshkimit duhet patjetër të zërë vendin e duhur në ekonominë shqiptare si një industri jashtëzakonisht e rëndësishme, që lidhet drejtpërdrejt me punën e vështirë të shumë peshkatarëve, por që mund të sjellë mundësi punësimi dhe të ardhura në dobi të ekonomisë dhe qytetarëve shqiptarë.

Prandaj, me kërkesën e Kryeministrit, është ngritur një grup pune për të përgatitur një plan kombëtar për peshkimin, i cili do të konsiderojë në mënyrë të plotë të gjithë elementet përbërëse për ndërtimin e një industrie peshkimi të standardeve që duhet të përputhen plotësisht me kërkesat që ka ky treg në BE, në radhë të parë për të pasur një flotë peshkimi të rinovuar që të ushtrojë aktivitetin e vet në të gjithë sipërfaqen ujore detare që kemi, të garantojë peshkimin e të gjitha llojeve të ndryshme të specieve detare që janë pjesë e çmuar e kësaj ekonomie, të ketë patjetër një infrastrukturë bashkëkohore që ka të bëjë me portet e peshkimit dhe për të vazhduar më tej me tregjet e peshkut, industrinë e përpunimit të peshkut dhe sidomos ofrimin e këtyre produkteve jo vetëm për tregun shqiptar por edhe atë ndërkombëtar. Dua të them se një pjesë e këtyre industrive tashmë janë në tregun evropian dhe janë pionierët e parë të eksportit të produkteve që trajtohen në Shqipëri

Në qoftë se vijmë konkretisht te porti i peshkimit, që do të ndërtohet në Durrës, ka një histori dhe debat të vazhdueshëm për këtë çështje dhe, për hir të transparencës, nisur edhe nga shqetësimet e ngritura nga kolegu, çështjen nëse ka pasur vizion apo jo në ndërtimin e këtij porti peshkimi, të gjithë mund ta diskutojmë, por, i nderuar koleg, ky port peshkimi historinë e tij e ka nisur në vitin 1998, ku qeveria e zotit Nano ngriti një komision dhe në bashkëpunim me BB-në përcaktoi vendin se ku do të bëhej ky port. Pra kemi një vendim qeverie që ka përcaktuar vendin

e këtij porti peshkimi, gjë që hedh poshtë të gjitha pretendimet për një gjykim të njëanshëm politik për sa i përket vendit të ndërtimit të portit.

Në vitin 2004, përsëri në kohën e qeverisjes socialiste, u bënë studimet batimetrike dhe fizibiliteti në bashkëpunim me BB-në për të përcaktuar për afërsisht vlerën e investimit, që u finalizua me një leje për shesh ndërtimi nga bashkia e Durrësit, e drejtuar po nga socialistët (zoti Koka ka qenë në atë kohë).

Në vitin 2005, ka filluar procedura për financimin, që u finalizua në janar të vitit 2007 me një kredi të Bankës Islamike për Zhvillim në vlerën 8,37 milionë dollarë, e cila kontrakti me një tender ndërkombëtar një kompani të njohur, "SID", e cila bëri edhe projektin final të portit. Në bazë të këtij projekti final u përcaktua edhe vlera reale e investimit, që është vlera që po diskutojmë sot.

Në vitin 2007-2008 Ministria e Financave i kërkoi Bankës Islamike për Zhvillim një financim shtesë për të realizuar investimin në port dhe në atë kohë në bashkëpunim me kompaninë "SID" dhe me Bankën Islamike është rënë dakord që pasi të bëhej edhe konkurrimi ndërkombëtar për kompaninë investuese të merrej vlera e financimit të plotë në bazë të këtij konkurrimi. Për këtë u zgjodh një nga kompanitë më të njohura në tregun e ndërtimeve të porteve si "Strabak", përzgjedhje e bërë me tender ndërkombëtar dhe e vlerësuar nga Banka Islamike, jo nga autoritetet shqiptare.

Në përfundim ne kemi arritur jo vetëm një përzgjedhje të drejtë, por edhe një investim të drejtë, i cili përputhet tërësisht me investimet e rëndësishme në të gjithë infrastrukturën e Portit e Durrësit, është në ndihmë të të gjithë peshkatarëve të Durrësit dhe sidomos është i një standardi, që tejkalon shqetësimet që kemi ngritur ju. Pengesat e krijuara, për mendimin tim, lidhen me interesa politike për të penguar investimin, duke krijuar një kosto mbi peshkatarët por edhe në zhvillimin e të gjithë infrastrukturës së Portit të Durrësit dhe të terminaleve të tjera.

Dua të them se për ne është i rëndësishëm ndërtimi i kësaj infrastrukture, e cila ka filluar dhe punimet janë tashmë të dukshme, edhe pse janë ngritur herë pas here pretendime të paqena. Prandaj do të ishte mirë të shkonit vetë atje të shikonim.

Nëse duhet të ishte port jahtesh apo ka pasur ndonjë dëshirë për të bërë port jahtesh atje, kjo është një çështje tjetër. Unë si ministër dhe qeveria kemi zbatuar një vazhdimësi të marrëdhënieve, pavarësisht nga ngjyrimet politike, nga viti 1998 deri në momentin e sotëm. Dua të theksoj se është një investim jashtëzakonisht i rëndësishëm ku qeveria shqiptarë është angazhuar seriozisht. Ne mendojmë se ky port është një nyje e rëndësishme portale e cila lidh të gjithë infrastrukturën portale që kemi në Durrës.

Zonja e zotërinj,  
Kolegë deputetë,

Ne paraqesim sot këtë projekt-marrëveshje për akordimin e lotit të dytë të kredisë. Kostoja totale e projektit është rreth 12,1 milionë euro dhe pjesë e kësaj kredie ishte dhe hartimi i projektit të zbatimit të dokumenteve të tenderit për përzgjedhjen e kompanisë etj. Dua t'ju them se vonesa 3-vjeçare e qëllimshme nga bashkia e Durrësit ka krijuar kosto shtesë në këtë projekt. Kjo është një përgjegjësi jo e vogël dhe prandaj ne, duke pasur parasysh nevojën për ndërtimin e kësaj infrastrukture, përjashtuam edhe disa probleme dhe kalimin e të gjithë infrastrukturës rrugore brenda portit. Për shqetësimin e ngritur se është afër sheshit "Taulantia" dua t'ju them se ky shesh është rreth 800 metra larg këtij porti.

Për më tepër, në qoftë se u referohemi vendeve fqinjë, përfshirë Malin e Zi, Kroacinë, edhe Italinë, do të shihni se portet e peshkimit janë pikërisht brenda infrastrukturës portuale afër qendrave të qyteteve, sepse janë të lidhura portet, tregjet e peshkut dhe industrinë e trajtimit të peshkut.

Për më tepër, në këtë investim është parashikuar edhe ndërtimi i një skolierie që mund të shërbejë edhe si shtesë për "Taulantian" për sa i përket shëtitjeve të qytetarëve, një mundësi shtesë që u jepet qytetarëve të Durrësit për të gëzuar diçka më tepër nga ajo që kanë sot.

Ky është një investim i rëndësishëm dhe do të ishte mirë që, të paktën, të merrnit përgjegjësi qytetare përballë atyre peshkatarëve, siç e kemi marrë ne si përfaqësues të së djathtës, sepse ata qytetarë dhe banorë të Durrësit punojnë me përkushtimin maksimal, me djersën e tyre dhe ne duhet t'u japim ndihmën maksimale si klasë politike, si qeveri, siç ua kemi dhënë, në mënyrë që ata të realizojnë detyrimet e tyre, të bëjnë

aktivitetin e tyre ekonomik, të shtojnë mundësitë e tyre ekonomike në shërbim të familjeve të tyre; pa dyshim, të kontribuojmë në ngritjen e një industrie peshkimi ashtu siç i takon këtij vendi, sepse sipërfaqja tokësore jona është e barabartë me sipërfaqen detare.

Në ndihmë të këtyre peshkatarëve ne kemi bërë edhe investime që kanë ardhur nga BE-ja në sistemin e monitorimit dhe të kontrollit, pikërisht për t'i asistuar për një peshkim të ligjshëm, por njëkohësisht edhe asistencë në momente të rrezikshme që kanë të bëjnë me jetën dhe sigurinë e tyre.

Pra, qëllimet e kësaj qeverie nuk janë as më pak e as më shumë, por vetëm t'i japin mundësi zhvillimit ekonomik, mirëqenies, jo vetëm peshkatarëve, por qytetit të Durrësit dhe mbarë Shqipërisë.

Faleminderit!

**Ardjan Turku** - Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Për grupin parlamentar të PS-së, zoti Klosi, keni fjalën.

**Blendi Klosi** - E mirëkuptova realisht dhe sinqerisht tërheqjen e kolegëve të djathtë për të folur për këtë projektligj, pasi edhe unë, po të isha në vend të tyre, do ta kisha shumë të vështirë ta mbroja.

Ky projektligj vjen sot për një projekt qeveritar, për një investim, i cili është tenderuar në vlerën 8 milionë euro dhe sot kërkohet që të bëhet 16 milionë euro.

Në qoftë se duam ta sqarojmë më hollësisht qytetarët shqiptarë, ky projekt dhe ky investim ka filluar vetëm përpara 2 vjetësh. Në vitin 2011, me hile qeveritare, me hile berishiane, i hiqet e drejta bashkisë së Durrësit për të dhënë leje për një port, që i takon krejtësisht këtij qyteti dhe është krejtësisht në kundërshtim me interesat e zhvillimit të qytetit dhe të qytetarëve durrsakë, duke e kaluar nëpërmjet këshillit të qarkut, i drejtuar kryekëput nga PD-ja.

Vetëm brenda 2 vjetësh investimi shkon nga 8 milionë në 16 milionë euro. Është një arsye e paarsyeshme, është një grabitje e madhe, është një megakorrupsion, i cili nuk ka asnjë shpjegim.

Kam këtu, të nderuar qytetarë shqiptarë dhe të nderuar kolegë, mënyrën e shpjegimit të përfaqësuesve të qeverisë në Komisionin e

Ekonomisë. Në asnjë fjalë të tyre nuk shpjegojnë se si ka ardhur ky riinvestim, përse duhet që taksapaguesit shqiptarë, edhe pse është kredi, në 15 vjet të shlyejnë dyfish investimin e parë. Thuhet se e ka penguar bashkia për 4 vjet, por ju, zotërinj, në 2011-n keni marrë leje dhe atëherë filluat investimin. Pse nuk e bëtë projektin tamam? Pse s'e analizuat tamam dhe nuk i dëgjuat qytetarët e Durrësit? Pse jeni kaq arrogantë sa të mos i dëgjoni qytetarët, të cilët s'mund të pranojnë atë që bëni ju në shëtitoren kryesore, sot, në 2013-n, kur gjithë bota e qytetëruar nuk e bën peshkimin në mes të qytetit, aty ku njerëzit lëvizin dhe ecin? Aty ku është pika kulmore, dhe aty ku është kulmi i bregdetit të Durrësit, ku ne mund të bënim investime në lidhje me turizmin, ju shkoni e bëni portin e peshkimit. Edhe tani që e ngrini dyfish koston e këtij investimi, është po e njëjta situatë, sepse ju duhet të mbroheni dhe deti s'të lejon të bësh investim në dalje të portit, por në kalatën tjetër, ashtu siç thoshte bashkia.

Sot vini këtu për të rikuperuar gabimin nga mosdëgjimi dhe mosrespektimi i qytetarëve dhe mendimit të ekspertëve, por që ka ardhur kryekëput nga interesat korruptive dhe aspak qytetare. Ky vendim dëmton drejtpërdrejt qytetin dhe s'i ndihmon as peshkatarët dhe as industrinë e peshkimit, e cila nuk mund të zhvillohet në atë zonë, sepse është e pamundur të ngrihet një port peshkimi, i cili nëse behët për industri peshkimi është i pamundur të pranohet për qytetin.

Ajo që ka për ne më shumë rëndësi është mënyra si e trajtoni qytetin, turizmin, mënyra si e kuptoni zhvillimin turistik të një qyteti si qyteti i Durrësit, i dyti më i madhi në vend dhe pritësi i 500 mijë turistëve të ardhur nga gjithë bota dhe kryesisht nga Maqedonia, Kosova apo kudo ku janë shqiptarët.

Çfarë keni bërë ju për këtë qytet? Para pak ditësh Sali Berisha ndodhej në Durrës. Sipas axhendës së asaj dite dhe shtypit të ditës behet fjalë se ka thënë se me inaugurimin e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza, Durrësi do të hyjë në hartën e qyteteve me ujërat më të pastra në rajon dhe Europë dhe se Durrësi me këtë impiant do të rrisë në mënyrë të ndjeshme kapacitetet e tij turistike.

Të nderuar kolegë deputetë, ja cila është sot gjendja e ujërave të zeza në Durrës. Kjo foto që po paraqes është fotoja që tregon edhe Portin e

Peshkimit. Pyetja ime është e drejtpërdrejtë për deputetët e qytetit të Durrësit dhe për qytetarët që janë të mirënjohur me turizmin atje: në cilin vend të botës dhe në cilin qytet të Adriatikut, mund të gjendet kjo pamje, ku edhe sot që flasim ujërat e zeza derdhen në det?

E dini se ç'ka ndodhur me impiantin? Bëhet fjalë për një histori gati proverb. Ishin dy njerëz që po punonin në park. Njëri hapte gropën, tjetri e mbyllte. Vajti dikush dhe i pyeti: "Çfarë po bëni?" - "Po mbjellim pemë", u përgjigjën. "Po pemë s'ka këtu!" - "Epo ai i pemëve sot mungon."

Edhe ju këtë punë bëni. Bëni impiantin, shtroni tubin dhe nuk bëni lidhjet e ujërave të zeza të qytetit me këtë impiant. Sot në qytetin dhe plazhin e Durrësit ky impiant është projekt i qeverisë para jush, që në vitin 2004, me investim 22 milionë euro. Sot që po flasim dhe në sezonin e ardhshëm turistik nuk do ta ndihmojë as qytetin dhe as plazhin për pastrimin e ujërave të zeza. A e dini pse? Sepse shrohet tubi dhe nuk bëhen lidhjet e hoteleve dhe impianteve të tjera me të.

Sot plazhi i Durrësit është i gjithi me gropa septike dhe qyteti i derdh akoma ujërat e zeza në det, sepse nuk bëhet investimi i plotë dhe Saliu pret shirita e thotë se ka zhvillim, se ka çuar Durrësin në ujëra të kristalta, ndërkohë që kjo situatë është e patolerueshme, dhe është krejtësisht kundër qytetarëve të këtij qyteti.

Kolegët që do të flasin do thonë se i pengoi Bashkia e Durrësit, por nëse porti do të bëhej atje ku realisht ka qenë porti i peshkimit në Durrës, do të ishte një situatë krejt tjetër. Qyteti nuk do të ishte përballur me një gangrenë si kjo që po ju paraqes, zhvillimi turistik i qytetit do të kishte perspektivë tjetër dhe investimi do të ishte bërë në bazë të normave të parashikuara. Asgjë s'po bëhet nga të gjitha këto, sepse s'ka më rëndësi për qeverinë tuaj. Mbase është normale, pasi ju kanë ngelur edhe 58 ditë deri kur qytetarët shqiptarë të kuptojnë se ç'do të thotë të rilindësh, të kuptojnë se ç'do të thotë të bësh turizëm, dhe që turizmi të shihet jo si një lopë për t'u majmur dhe jo të presësh se çfarë të ardhurash vijnë, por të investosh për turizmin dhe ta kthesh qytetin e Durrësit në një qytet turistik, me lidhje ndërmjet ambientit dhe turizmit, ndërmjet detit dhe rërës; ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe investimeve, portit

me jashtë, portit të peshkimit dhe çdo gjë të bëhet në harmoni.

Të dyja këto projekte që përmenda janë projekte të qeverive socialiste dhe asnjë nuk është projekti juaj. Fondet janë siguruar 10 vjet para dhe shikoni se ç'po bëni! Një projekt që e nisët me 8 milionë e çuat në 16, dhe atë që e nisët me 22 milionë nuk e vini në shfrytëzim të qytetarëve të Durrësit dhe turizmit që pritet.

Do ta kuptoni pas 58 ditësh se çfarë do të thotë të zhvillosh turizmin dhe çfarë do të thotë ta kthesh qytetin në qytet mikpritës për të gjithë ata që duan të vijnë të shijojnë dhe të mos infektohen. Kjo është shumë e rëndësishme.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr zonja Topalli.)*

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Zoti Ministër, urdhëroni!

**Fatmir Mediu** – E nderuar zonja Kryetare,

Këtu po vazhdojnë barsolëta pa fund. Tani mora vesh se po lidhin edhe detin me rërën. Dua të them se të paktën respekt për kolegët dhe aleatët tuaj duhet të keni. Zoti Duka, zoti Nano, zoti Koka, kur kanë hedhur projekt-idenë e këtij porti kanë pasur vizion. Nëse keni ndonjë gjykim kundër, mund ta thoni hapur, sepse kanë qenë ata që e kanë iniciuar që në vitet 1998, 2004 e në vazhdim. Të paktën të jemi të ndershëm e të mos gënjejmë. S'ka pasur asnjë fond të siguruar nga ju për investimin e portit. Ai u siguroa në janar 2007. Tenderi është prokuruar i plotë me 16,7 milionë dollarë, procedurë kjo me konkurrin ndërkombëtar, e proceduar nga Banka Islamike me kompaninë ndërkombëtare, që ka asistuar dhe ka përcaktuar një kompani të rëndësishme si Stadkraftin, që ka bërë investimin. Ne kemi ndjekur vetëm procedurën ligjore për të realizuar një port konform standardeve.

Ti vjen këtu me mendimin e kryetarit të bashkisë, por ai e pengoi këtë projekt për tre vjet. Duhet të rrinin paratë e shqiptarëve deri sa t'i mbushet mendja kryetarit të bashkisë për të bërë një investim të nisur që në kohën e PS-së. Sa herë që të vijë një kryetar bashkie mund të ndryshojë projektin dhe të bëjë atë që atij i intereson?

Ne kemi bërë diçka edhe në shërbim të peshkatarëve të Durrësit. Kjo nuk është thjesht një praktikë shqiptare, por ju mund të na sillni një praktikë tjetër se ku bëhen portet e peshkimit, përveçse aty ku krijohet zinxhiri i mjaftueshëm

dhe i nevojshëm: port-merkato-industri-treg peshkimi. Kjo ka vlerë në një qytet bregdetar nga pikëpamja e interesit të kësaj industrie dhe të turizmit. Ju dhe unë vijmë nga një zonë që turizmin malor e njohim më mirë se turizmin bregdetar. Të paktën thoni se është bërë një investim i qenësishëm për Durrësin, se jeni deputet i Durrësit.

Po ta shihni se cila është pasoja për këtë qytet, janë pikërisht ndërtimet pa fund e pa lejë që janë dhënë në të gjithë gjirin e Durrësit, me një infrastrukturë gjigante të betonizuar, pa asnjë perspektivë dhe lejë mjedisore. Nëse thoni se duhet t'i shkatërrojmë nga e para ato ndërtime, këtë politikë duhet të vini e ta përcillni këtu. Janë dhënë lejet në kohën e kryetarëve tuaj të bashkisë që e kanë kthyer këtë në një zonë banimi dhe jo turistike, me ndërtime pa fund, që krijojnë problem shumë të madh për mjedisin dhe duan investime kolosale për t'iu kthyer pastërtisë që po bën kjo qeveri.

Nëse keni ndonjë mendim si specialist komunaleje, më të mirë se ato që janë dhënë deri tani, jeni të gatshëm ta jepni dhe ta vlerësojmë se ç'do të bëjmë më tej.

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë te projektligji tjetër.

Në emër të grupit të PS-së, zonja Kodheli!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, po ju them se ne kemi votuar pro në Komisionin e Ekonomisë dhe do të votojmë pro edhe në këtë seancë në lidhje me këtë projektligj. Mu më vjen keq se duhet të ndaj me ju atë abuzim pa fund në gjithë këto vjet, sa herë thoni se këto rrugë i ndërtoni ju.

Dihet se një gjë është e sigurt: rrugët ndërtohen ose me paratë e taksapaguesve shqiptarë, ose me para të huazuara. Ju duhet të paktën një herë të thoni se çdo investim publik në këtë vend nuk behët nga para personale, por nga para që paguan gjithsecili. Keni abuzuar pa fund, sa herë që thoni se opozita s'do të bëhen rrugët. E konsideroj infantile dhe banale këtë gjë. Duhet të kishit kërkuar falje, por s'jeni në gjendje ta bëni. Për ne është e rëndësishme që qytetarët shqiptarë të kuptojnë se e kundërta është e vërtetë, sepse, sa herë ju keni sjellë buxhetet ku bëjnë pjesë investimet dhe borxhi publik, kundërshtitë tona kanë qenë të lidhura jo me rrugët, por me abuzimet që në këto 8 vjet ju

keni bërë me parandë publike dhe me abuzimet që ju kanë çuar në investime të copëzuara, me abuzimet që ju keni bërë me proceset e tenderimit, me abuzimet që ju bëni me mospagesat e kompanive që kanë përfunduar të presin një situacion punimesh sepse në rastin më të mirë nuk do t'i marrin këto para, me abuzimet me kostot e larta që keni në projektim dhe zbatim, me abuzimet dhe mungesën e monitorimit dhe supervizionimit të punimeve, me abuzimet me ambientin dhe sigurinë e njerëzve që punojnë në këto projekte. Të gjitha këto na kanë bërë të vetëdijshëm se lufta jonë në respekt të të abuzuarve dhe në respekt të ligjeve që duhet të zbatohen në këtë vend është në shërbim të mbarëvajtjes së punëve të këtij vendi. Ndaj qëndrimi ynë ka qenë parimor dhe i prerë. Në të gjitha rastet që janë verifikuar abuzimet vota jonë ka qenë kundër, por jo kundër rrugës.

Së fundi, dy fjalë për projektin. Është shumë i nevojshëm ndërtimi i këtij projekti, siç është i nevojshëm ndërtimi i dhjetëra segmenteve që sot janë plotësisht të shkatërruara apo të pamirëmbajtura. Keni premtuar gjatë këtyre 8 vjetëve se do të ndërtoni Unazën e Pogradecit dhe nuk e keni bërë këtë, për të mos folur pastaj për të gjitha segmentet apo *bypass*-et, që nuk i keni bërë, sidomos në shumë qytete dhe zona të Jugut të Shqipërisë. Ne ju premtojmë, gjithsesi, se me ardhjen tonë në pushtet do t'i shfrytëzojmë më së miri të gjitha mundësitë që do të na japë kjo kontratë huadhënieje apo dhe ligji, si dhe çdo harxhim tjetër publik, i cili do të mundësojë mbylljen e punimeve të Qafë Plloçës në kohë dhe me cilësinë që meriton realisht një rrugë në Shqipëri, si një vend në mes të Europës.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Zoti Papa, në emër të grupit parlamentar të PD-së, urdhëroni!

**Gjergji Papa** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Kolegë deputetë,

Sot Kuvendit i paraqitet për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna ndërmyet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për ndërtimin e segmentit Qukës – Qafë Plloçë të korridorit rrugor Tiranë-Korçë”.

Megjithëse jemi në prag të fushatës elektorale, qeveria e Kryeministrit Berisha nuk rresht asnjë çast së menduari dhe së vepruari për

mbajtjen e fjalës së dhënë për realizimin e projektit madhor të Partisë Demokratike, për ndërtimin e infrastrukturës rrugore moderne dhe me parametra europianë. Kam nderin dhe kënaqësinë, njëkohësisht si deputet i qarkut të Korçës, të flas sot në Kuvend në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike për një vepër madhore, për një investim prej 153 milionë dollarësh, për ndërtimin e rrugës Qukës – Qafë Plloçë me gjatësi 43.4 kilometra, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë – Korçë, Korridorit i Tetë. Kjo rrugë kalon në qarqet e Elbasanit dhe të Korçës dhe së bashku me ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan siguron një lidhje më të shpejtë dhe më komode midis Portit të Durrësit dhe vendeve të tjera të Ballkanit, si Maqedonia, Greqia, Bullgaria, Turqia etj., duke e bërë Shqipërinë vendin më të përshtatshëm për të kryer transitin nga vendet e Ballkanit drejt Europës dhe anasjelltas.

Për qarkun e Korçës, lajmi se Banka Islamike për Zhvillim do të financojë 125 milionë dollarë për investimin e rrugës Qukës – Qafë Plloçë, është një sihariq i shumëpritur. Kjo sepse, pas përfundimit të rrugës Tiranë-Elbasan, me tunelin impresionant të Kërrabës, gjë e cila afron trevën e Korçës me kryeqytetin rreth një orë, realizohet plotësisht aksi i Juglindjes duke e shndërruar kështu zonën e Korçës pothuajse në një periferi të Tiranës. Pa dyshim kjo është një ëndërr që po bëhet realitet, një premtim i mbajtur nga Partia Demokratike, që do të kontribuojë në shtimin e fluksit të mallrave dhe njerëzve drejt Korçës, në zhvillimin e turizmit liqenor, malor, kulturor dhe agroturizmit, dhe për pasojë, në zhvillimin ekonomik të kësaj zone; është një përgjigje pozitive për pyetjet e shumë qytetarëve korçarë se kur ky premtim i Partisë Demokratike do të bëhet realitet. Kjo rrugë do të shërbejë gjithashtu si një *bypass* për qytetin e Pogradecit, si një nga qendrat turistike më të rëndësishme të Shqipërisë Juglindore, duke shmangur ndotjen e liqenit dhe të qytetit si pasojë e transimit të mjeteve të rënda, duke përmirësuar kështu ndjeshëm komoditetin turistik, që do të sjellë rritje të numrit të turistëve.

Kjo rrugë do të ketë impakt pozitiv edhe në zhvillimin e zonës së thellë malore të Mokrës nëpërmjet së cilës ajo kalon. Kështu ajo u krijon më shumë akses banorëve të kësaj zone drejt tregjeve të Korçës, Pogradecit, Librazhdit,



Elbasanit dhe më gjerë, duke shtuar investimet në bujqësi, duke rritur prodhimin vendas dhe duke ulur në mënyrë të konsiderueshme papunësinë në këtë zonë.

Duke qenë se rruga kalon nëpërmjet një zone malore janë parashikuar të ndërtohen një numër i madh veprash arti, si shumë ura mbajtëse dhe pritëse, më shumë se njëzet ura, si dhe një tunel 375 metra i gjatë. Rruga do të ketë një gjerësi prej 12 metrash. Kostoja totale e projektit do të jetë 152.75 milionë dollarë, nga të cilat 125 milionë dollarë do të financohen nga Banka Islamike për Zhvillim, 25 milionë dollarë do të financohen nga Fondi Saudit për Zhvillim dhe 2.75 milionë dollarë do të jenë kontribut i qeverisë shqiptare.

Ndërkaq, opozita dhe kryetari i saj, Edi Rama, jo vetëm që nuk dinë të japin një vlerësim objektiv për të gjitha këto arritje të mëdha në infrastrukturën rrugore, të cilat nuk janë vetëm për maxhorancën qeverisëse, nuk janë vetëm për Partinë Demokratike, por për të gjithë popullin shqiptar, por vazhdojnë avazin e tyre të vjetër të demagogut dhe të nihilistit, ashtu sikundër bëri dhe në qytetin e Peshkopisë para disa ditësh, ku, duke luajtur rolin e karagjozit, u mundua të mohojë kontributin e padiskutueshëm dhe investimet e mëdha të qeverisë “Berisha” në ndërtimin e rreth 10 mijë kilometrave rrugë kombëtare, rajonale dhe lokale të parametrave europiane.

Ishte pikërisht Edi Rama ai që urdhëroi deputetët e tij që të votojnë kundër ndërtimit të rrugës Tiranë – Elbasan, kundër ndërtimit të tunelit të Kërrabës, dhe tani, në rolin e një hipnotizuesi mashtrues vazhdon të kujtojë se mund të gënjejë njerëzit që ai i konsideron si turma pa tru, pa sy dhe pa veshë. Mirëpo populli i ka sytë në ballë. Ai i sheh dhe i gëzon edhe rrugët, edhe shkollat, edhe spitalet. Edi Rama nuk është aq i zoti sa të fusë xhaminë në thes. Ai mund të autosugjestionohet dhe të programojë fitoren e tij imagjinare në zgjedhjet e 23 qershorit, por ajo që njerëzit e kuptojnë dhe vlerësojnë janë veprat dhe jo fjalët. Ndaj unë jam i sigurt se Partia Demokratike duhet të fitojë dhe do të fitojë edhe këtë herë për të bërë të mundur realizimin e projektit të vet madhor: bërjen e Shqipërisë pjesë integrale të Europës së bashkuar.

Ndërkaq, bëmat e fundit të inspiruara prej Ramës dhe njerëzve të tij më të afërt, më kujtojnë praktikën dhe bëmat e diktatorëve të Luftës së Dytë Botërore. Konceptin e Rajhut të ri ai e ka zëvendësuar me sloganin “Rilindje”, dhe në emër të një ideje të sëmure dhe imagjinare kërkon të mbulojë dëshirën e tij të hershme për pushtet me çdo kusht. Pikërisht për këtë benjaminët e tij krijojnë skena të dhunshme në Parlament, pikërisht për këtë dhe të inspiruara prej tij, skuadrat e tij të sulmit me pankarta në duar, të cilat koha ka treguar që dinë t’i shndërrojnë dhe në hunj, kërcënojnë armiqët e tij politikë te pragu i shtëpisë duke i quajtur “tradhëtarë të zinj”, dhe të tjera epitete të ngjashme.

Këto praktika ngjajnë aq shumë me pogromet e dikurshme të diktaturave dhe shteteve totalitare ku liria e të menduarit ndryshe ishte e ndaluar dhe konsiderohej si sakrilegj. Mënyra e tij e të bërit opozitë ka rezultuar jo vetëm e paefektshme, por dhe e dëmshme për vendin. Sot edhe avokatët e tij më të zellshëm e pranojnë se arsyeja e vetme që vendi nuk mori statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Europian ishte mosaprovimi i tre ligjeve dhe ndjekja e politikave bllokuese të Edi Ramës vetëm e vetëm për hir të synimeve të tij për pushtet. Për ironi të fatit ai e pagëzoi koalicionin e tij me emrin “Aleanca për Shqipërinë europiane”.

Unë jam i bindur se vota e popullit shqiptar, sidomos e pjesës më pak të indoktrinuar të tij, e vetëdijshme për rrezikun që paraqet një politikan i papërgjegjshëm si Rama, do t’i tregojë vendin një herë e mirë aventurës së tij më 23 qershor, duke votuar për “Aleancën për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim”.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike shpreh votën pro për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje dhe fton të gjithë kolegët deputetë, veçanërisht ata të opozitës, ta votojnë atë.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e ka marrë zoti Ardjan Turku.)*

**Ardjan Turku** – Faleminderit!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në projektligjin “Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike,

ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të MORPHO dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”.

Në emër të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut?

*(Relatori i Komisionit të Ligjeve shprehet dakord.)*

Ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Braçe!

**Erion Braçe** – Unë kam dy pyetje që burojnë drejtpërdrejt nga relacioni që ka sjellë qeveria me kërkesën për të miratuar këtë kontratë. Në faqen 4, pika 2, shkronja “a” thuhet: “Përmirësimin e sistemit të dokumenteve të identitetit”, dhe pastaj është origjina e prodhimit të pasaportës biometrike me gjeneralitetet e gjithsecilit shtetas.

Pika e parë, thotë: “Futja e elementit të dytë biometrik, njohja biometrike e fytyrës në fillim të vitit 2015, për të rritur sigurinë dhe eliminuar mundësinë e falsifikimit”.

Pas kësaj që thuhet këtu dhe pas edhe hetimeve të prokurorisë, më lind pyetja: Sa mundësi falsifikimi ka sistemi sot?

Është shumë e rëndësishme kjo gjë, sepse janë evidentuar disa raste, të paktën nga organet e policisë, dhe disa raste të tjera nga organet e prokurorisë.

Pika e dytë: “Rritja e sigurisë gjatë procesit të aplikimit, shpërndarjes së dokumenteve të identitetit”. Edhe këtu kërkojmë një shpjegim. Çfarë do të thotë dhe në ç’gjendje sigurie është sot sistemi në pjesën e procesit të aplikimit dhe të shpërndarjes së dokumenteve të identitetit? Çfarë ka ndodhur që kontrata përmirësohet edhe në këtë pikë? Edhe këtu ka raste të evidentuara nga Policia e Shtetit, ashtu edhe nga prokuroria, që për hir të së vërtetës i kemi dokumentuar edhe ne.

E treta, kontrata rrit çmimin e pasaportave dhe të kartave të identitetit. Të dyja bashkë shkojnë gati 90 mijë lekë për çdo qytetar, pa bërë ndonjë dallim apo diferencim në politikë sociale. Unë dua të di, për sa kohë që çmimi ishte mbi koston e pasaportës dhe të kartës së identitetit që në momentin kur u bë kontrata e parë, sa është sot kostoja e prodhimit të këtyre dy dokumenteve të identifikimit, pra e kartës së identitetit dhe e pasaportës, për të ditur më tej pastaj se sa fiton kompania nga ky shërbim publik që do të ofrojë?

E fundit që kam, zoti Turku, ka të bëjë me vetë qëllimin, e lidhur kjo edhe me afatet e kontratës. Kontrata e parë përfundonte diku në fund të korrikut. Sot jemi në muajin prill. Çfarë e ka detyruar qeverinë që të vijë në muajin prill për të sjellë, thuhet zgjatjen e kontratës, por në fakt ky është një koncesion i ri nga e para?

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, për ta përfunduar pyetjen, duke thënë se ç’lidhje ka kjo me zgjedhjet?

**Ardjan Turku** – Faleminderit, zoti Braçe!

*(Drejtimin e seancës e ka marrë Zonja Topalli.)*

**Jozefina Topalli** - Thërrisni ekspertët për t’iu përgjigjur pyetjeve!

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

Atëherë, sa të vijnë ekspertët, kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, te projektligji “Për gjendjen civile”.

Zonja Vasilika Hysi, urdhëroni!

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

Urdhëroni, zonjë!

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

Jo, more zotërinj, nuk e ndërpres unë seancën! Nëse nuk dëshironi të flisni, e kaloj edhe zonjën. Zotëri, e shtymë këtë pikë të rendit të ditës derisa të vijnë ata. Zonjë, dëshironi të flisni për gjendjen civile?

*(U drejtohet deputetëve të PS-së, të cilët flasin nga vendi.)* Sot do ta diskutojmë.

Në emër të Komisionit të Çështjeve Ligjore, zonja Trashani?

*(Zonja Trashani shprehet dakord.)*

Faleminderit!

Zonja Hysi, urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Kolege dhe kolegë deputetë,

Siç e shikoni nuk ka as rend dite dhe ekspertët ngatërrohen. Në fakt, ne sot po diskutojmë një ligj shumë të rëndësishëm “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile””. Këto ndryshime bëhen të diktuar nga fakti se me liberalizimin e vizave për në vendet e BE-së, një nga shqetësimet që është ngritur, është se ka shqiptarë, të cilët mund të kenë qenë të deportuar, ose që janë në ndjekje penale dhe kanë tentuar t’i fshihen hetimit, ose drejtësisë dhe dëshirojnë të rifuten në vendet e BE-së, apo të qarkullojnë lirshëm në vendet e tjera, duke ndryshuar ermin dhe mbiemrin e tyre.

Pa dyshim që nevoja për shtrëngimin e rregullave të ndryshimit të emrave dhe të mbiemrave bëhet në kuadër të nevojës së sigurisë dhe të respektimit të direktivave të BE-së. Kjo është një nismë e mirë, por procedura e përzgjedhur për ta frenuar këtë fenomen është burokratike, e gjatë dhe e kushtueshme në kohë për personat që kërkojnë të ndryshojnë emrin ose mbiemrin për arsye të ndryshme; për shembull, nëse emri është i papërshtatshëm, ndryshimi i mbiemrit pas martesë apo divorci. Pra, me fjalë të tjera, nëse ne duam të rregullojmë një problem, harrojmë që dëmtojmë dhe fusim në procedurat e burokracisë të gjithë qytetarët, pavarësisht nga motivi ose interesi i mirë me të cilën bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

E ndërsa procedura për të bërë ndryshimet e emrave dhe të mbiemrave të qytetarëve shqiptarë është bërë e pamundur nëpërmjet praktikës që rifutet me ndryshimet në ligj, madje miratimi i ndryshimeve të një emri ose mbiemri bëhet nga një komision kombëtar, që do të ngrihet pranë Ministrisë së Brendshme, ku përfshihen 3 hallka: Zyra e Gjendjes Civile, Prefekti dhe komisioni kombëtar i emrave për të ndryshuar emrat e anëtarëve të KQZ-së, për të ndryshuar emrat e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, procedura është aq e thjeshtë, aq e lehtë dhe koha është aq e shkurtër, sa nuk pritet të mbushet as 24-orëshi që nga momenti kur Presidenti i Republikës dekreton një emër, Komisioni i Ligjeve e shqyrton dhe parlamenti me votat e maxhorancës i voton.

Kështu që mund t'ju sjell përvojën e ditës së djeshme dhe të një jave më parë, ku brenda 24 orëve në parlament u paraqit kërkesa e kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së për të shkarkuar anëtarin e KQZ-së. Më pas, brenda 24- orëshit, për ta diskutuar në komision këtë kërkesë, për ta debatuar në kuvend dhe në po të njëjtën ditë për të shkarkuar njërin anëtar të KQZ-së të zgjedhur në bazë të Kodit Zgjedhor dhe për të emëruar një anëtar të komisionit në kundërshti me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

E gjithë kjo procedurë për ndryshim emri dhe mbiemri u bë në shkëlqje të plotë të ligjit dhe procedurës parlamentare, pa pasur nevojë të verifikohet legjitimiteti i procedurës së zbatuar. Dhe kur vjen fjala për të ndryshuar një emër ose mbiemër në rast të një martesë apo divorci, procedura për ndryshimin e mbiemrit do të

kalojë në një hallkë shumë të gjatë dhe askush nuk e ka të qartë sa ditë do të vazhdojë kjo procedurë.

Procedura ose standardet dyfishë në ndryshimin e këtyre pozicioneve ka pasur edhe për sa u përket mbarimit të mandatit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese dhe procedurave të shqyrtimit të tyre në Komisionin e Ligjeve dhe të votimit në Kuvend. Besoj se sot ne do të jemi dëshmitarë që në parlament do të votohen disa dekrete të Presidentit, të cilat në këto momente që po flas nuk kanë mbushur ende 24 orë. Pra, boja e stilografit të Presidentit nuk është tharë ende. Megjithatë, kur Presidenti ende nuk kishte nxjerrë dekretin e tij, ne u njoftuam në Komisionin e Ligjeve se duhet të ishim në gatishmëri, të mos largoheshim nga mjediset e Kuvendit, sepse mund të vinte ndonjë dekret dhe mund të kishte një mbledhje komisioni. Dhe me të vërtetë, çudia ishte se në orën 12:00 mbaroi mbledhja dhe në 14:30 u rikthye mbledhja e komisionit për të kaluar dy dekretet e reja të Presidentit të Republikës.

Pra, shikoni sa lehtë i ndryshojmë ne emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të asaj Kushtetuese, duke injoruar Kushtetutën, procedurën e Kuvendit, rregullat për organizimin e mbledhjeve në Komisionin e Ligjeve.

**Jozefina Topalli** – Zonjë, jeni jashtë rendit të ditës. Ju lutem, flisni për projektligjin!

**Vasilika Hysi** – Pse ky nxitim? Brenda rendit të ditës jam.

**Jozefina Topalli** – Respekto Rregulloren, zonjë!

**Vasilika Hysi** – Pse ky nxitim për ndryshimin e emrave të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, ndërkohë që ky Kuvend ka zbatuar dhe sot po miraton procedurat e gjata e të stërgjata.

**Jozefina Topalli** – Zonjë, jeni duke shkelur Rregulloren! Respektoni Rregulloren!

**Vasilika Hysi** – Zonja Kryetare, po flas për procedurat e zgjatura të ndryshimit të emrave dhe të mbiemrave.

**Jozefina Topalli** – Mos e shkelni Rregulloren! Edhe një herë, zonjë, ju tërheq vëmendjen!

**Vasilika Hysi** – Pra, kur ne sot miratojmë procedurat e zgjatura dhe të stërzgjatura për ndryshimin e emrave të qytetarëve, gjoja në emër të mbrojtjes së njerëzve që kërkojnë azil, ose

njerëzve të deportuar, që kërkojnë të rifuten në vendet e BE-së. Kështu që, si ndryshimi i emrit ose mbiemrit do të zgjasë pa fund, deri kur perfekti ose komisioni politik i çdo maxhorance dhe i maxhorancës së radhës, do të vlerësojë edhe dekretet e zonjës Gaba dhe zotit Artan Hoxha të paraqitura në Kuvend, sipas procedurës dhe në respekt të ligjit, u pluhurosën në sirtarët e këtij Kuvendi dhe nuk morëm përgjigje.

A e kuptoni si i zgjasim procedurat dhe i stërzgjatim kur ne duam ta bëjmë një gjë të tillë dhe nuk kemi vullnetin për të zbatuar Kushtetutën, ligjin dhe Rregulloren?

Kolegë deputetë dhe deputete, integrimi evropian mundëson lëvizjen e lirë të njerëzve dhe kërkon garanci për vendet e “Shengenit”, për sigurinë e qytetarëve në këto vend. Kufizimi i mundësisë së lëvizjes së njerëzve me probleme për rendin dhe sigurinë përmes heqjes së mundësisë së ndryshimit lehtësisht të emrit dhe të mbiemrit është i nevojshëm. Askush nuk mund të thotë se ky propozim nuk është i domosdoshëm, por po aq i nevojshëm për funksionimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe për bashkëpunimin në rajon dhe me vendet e BE-së, është edhe pavarësia, depolitizimi i procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve kushtetuese.

Funksionimi i parlamentarizmit, heqja dorë nga zgjedhja politike e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, pavarësia e KQZ-së, rikthimi i legjitimitetit të saj janë bazat e funksionimit të demokracisë dhe stabilitetit politik të institucioneve në vend.

**Jozefina Topalli** – Zonjë, jeni në shkelje të Rregullores!

**Vasilika Hysi** – Emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të institucioneve të pavarura dhe atyre kushtetuese nuk mund të ndryshojnë. Ndaj, edhe një herë e theksoj se miratimi i ligjeve në Kuvend, që mundësojnë funksionimin e sigurisë dhe rendit në vend, duhen bërë në respekt të Kushtetutës dhe ligjeve, duke zbatuar barazinë e shtetasve para ligjit dhe mundësuar procedura transparente për të gjithë.

**Jozefina Topalli** – Jeni në shkelje të Rregullores! Respektoni Rregulloren!

**Vasilika Hysi** - Besoj se kjo që po them, zonja Kryetare, është në përputhje me rendin e ditës. Përvoja e qeverisjes së kësaj maxhorance

tregoi se Kushtetuta, ligjet dhe njerëzit me integritet nuk kanë vlerë për këtë maxhorancë.

**Jozefina Topalli** – Jeni në shkelje të Rregullores, po ju them për të 15-ën herë, zonja juriste! Respektoni ligjet e parlamentit!

**Vasilika Hysi** – Ndaj, ka nevojë për një qeverisje dhe qasje tjetër, që të mundësojnë funksionimin e demokracisë së shtetit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Keni shkelur Rregulloren për 10 minuta, ligjin tuaj, ligjin e parë që ju takon juve ta respektoni, juriste! Nëse nuk keni problem për ligjet, dakord. Jini të sigurt!

*(I drejtohet zotit Xhafaj, i cili flet nga vendi.)* Lexojini mirë nenet e Rregullores, zoti ish-ministër i Drejtësisë!

Zoti Subashi, urdhëroni!

**Armando Subashi** – Me këtë projektligj që po sillni sot kërkon të disiplinoni dhe të kufizoni ndryshim të drejtën e çdo individit për të ndryshuar emrin dhe mbiemrin e vet. Po na thoni se ky është një detyrim i shtetit shqiptar ndaj BE-së në kuadër të liberalizimit të vizave dhe si një mjet efikas në luftën kundër krimit, për të rritur sigurinë e dokumenteve të Gjendjes Civile. Pas 4 vjetësh që ligji ka hyrë në fuqi dhe po vepron pas mijëra e mijëra rasteve, ku janë ndryshuar emrat apo mbiemrat; pas mijëra e mijëra rasteve ku personat, që kanë ndryshuar emrat apo mbiemrat, janë pajisur me karta identiteti apo dokumente të tjera identifikimi, sot po sillni këto ndryshime në ligj, me demokracinë, për ta rregulluar këtë fenomen.

Mbi këtë bazë ne kemi gjithë të drejtën të mendojmë se në këto vite numri i personave, që kanë ndryshuar emrin ose mbiemrin apo edhe të dyja mund të jetë me mijëra; ne kemi gjithë të drejtën të mendojmë se këta persona sot mund të jenë me dy karta apo me dy pasaporta biometrike në xhep, që jo vetëm fshehin identitetin e tyre të vërtetë, sipas rastit që u paraqitet, por, nga ana tjetër, janë një kontingjent që mund të përdoret nga ju për të votuar më shumë se një herë. Në disa qendra votimi, pavarësisht sa mund të jetë numri i atyre që kanë ndryshuar drejtpërdrejtë identitetin, ka edhe një moment tjetër që sjell pasojë në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse nuk duhet të harrojmë që ndryshimi i emrit apo i mbiemrit të një kryefamiljari sjell ndryshimin e elementeve të identifikimit edhe për familjarët e

tjerë të tij, sidomos për fëmijët, çka sjellë të drejtën e tyre për t'u pajisur me karta të reja identiteti dhe në këtë mënyrë numri i personave me dy karta në xhep potencialisht mund të jetë dy apo trefish më i lartë nga ç'mund të mendohet.

Sigurisht, ne jemi dakord me kufizimin e së drejtës për të ndryshuar emrin apo mbiemrin, por nuk mund të jemi dakord me procedurën tejet burokratike dhe shumë politike që krijoni për këtë proces. Sipas këtij projekti kërkesa paraqitet në Zyrën e Gjendjes Civile, prej andej shkon te Prefekti dhe nga ky i fundit shkon te komisioni i ministrit të Brendshëm. Mënyra se si krijohet ky komision është shumë qesharake. Në përbërje të tij janë zëvendësministri i Brendshëm, mendoni Poni, ose Ristani, një punonjës policie dhe një person tjetër i emëruar po nga ministri i Brendshëm dhe ky komision do të ketë të drejtën që të pranojë ose jo kërkesën për ndryshim emri ose mbiemri, apo të dyja bashkë.

Vazhdoni me të njëjtën logjikë. Në çdo gjë duhet të fusni hundët, çdo gjë duhet të kalojë nga duart tuaja. Ky është mentalitet dhe psikologji tipike diktatoriale. Të kontrollosh çdo gjë, të marrësh vesh çdo gjë, madje edhe kush ndryshon emrin ose mbiemrin, pse e ndryshon, çfarë arsye ka etj., si këto. Është e njëjta logjikë si me KQZ-në. Shkarkuat një anëtar të atij institucioni dhe praktikisht e ekzekutuat atë institucion, vetëm e vetëm, sepse Saliu nuk ishte i sigurt; vetëm e vetëm, sepse Saliu nuk e kontrollonte dot, sepse ai institucion edhe mund të mos u bindej urdhrave të tij.

Sot KQZ-ja po bën sikur po funksionon. Po hiqet zvarrë dhe ju nuk keni vesh të dëgjoni atë që po ju thonë çdo ditë partnerët tanë ndërkombëtarë. Po emëroni në gjykatat e larta ushtarët tuaj të bindur, shpejt e shpejt, në ikje e sipër, jashtë çdo rregulli parlamentar, në kundërshtim flagrant me Kushtetutën, ligjin dhe Rregulloren e parlamentit, vetëm e vetëm, për t'i kontrolluar ato; vetëm e vetëm për të shpëtuar nesër nga ndëshkimi i ligjit për zullumet që keni bërë gjatë gjithë këtyre viteve. Kjo është logjika juaj edhe në këtë ligj. Në fakt, nuk mund të ishte ndryshe. Si mund të mos e dinte Saliu nëpërmjet Flamurit të tij se kush do të ndryshojë emrin...

**Jozefina Topalli** – Po thyen Rregulloren, zoti deputet!

**Armando Subashi** -... mbiemrin apo edhe të dyja bashkë? Si mund të ndodh që një shqiptar të kërkojë diçka të tillë dhe Saliu të mos e marrë vesh?

Ky është një turp, njësoj si në atë kohë, kur Ministria e Brendshme duhet të dinte dhe të merrte vesh çdo gjë që ndodhte me çdo shqiptar.

Ajo që më ka bërë më shumë përshtypje në këtë ligj është lista e emrave dhe mbiemrave, që nuk mund të përdoren nga askush për shkak të personalitetit, të kontributit apo për shkak të vendit që zë emri dhe mbiemri përkatës në histori.

Nuk dua ta besoj se ky është vetëm një propozim i Kryeministrit. Me sa duket, tani në ikje po mendon edhe për këtë.

Unë kam një pyetje: pse i kufizoni shqiptarët apo ndonjërin prej tyre, që, për respekt dhe në nderim të figurave historike, nesër të ndryshojë emrin dhe mbiemrin dhe të quhet Sali Berisha? Pse i kufizoni shqiptarët që në respekt të figurave historike nesër të ndryshojnë emrin dhe mbiemrin? Dikush mund të kërkojë të quhet Esat Toptani. Pse i kufizoni shqiptarët që nesër, në respekt të figurave historike, të ndryshojnë emrin dhe mbiemrin dhe të quhen Ahmet Zogu apo edhe Jozefina Topalli? Pse ia hiqni këtë kënaqësi një pjese të shqiptarëve? Besoj se dy janë mundësitë. Ose po ëndërron Saliu i shkretë se në botë, motë e jetë, vetëm një Sali Berisha duhet të ekzistojë ose thellë brenda vetes ai e di se historia do ta mbulojë me turp dhe po kërkon që sot të shtojë ndonjë shqiptar që jo vetëm është gati të japë jetën për të, por edhe është i gatshëm të kopjojë emrin dhe mbiemrin e vet. Po të jetë kjo e dyta, gjysma e së keqes, se, më në fund po bën një gjë të mirë për shqiptarët, po bën një gjë të mirë tani në ditët e fundit të ikjes së tij.

Si përfundim, më lejoni që ashtu si të gjithë kolegët e mi, t'jua them troç dhe shqip: do të lejohet apo do të kufizohet ndryshimi i emrit apo mbiemrit? Do ta japë lejen për këtë ndryshim ministri i Brendshëm, apo jo? Do të lejojë Saliu t'i kopjojnë emrin dhe mbiemrin, apo jo? Do të keni KQZ-në, apo nuk do ta keni? Do të emërohet Toma apo jo? Një gjë duhet ta keni shumë të qartë: jeni të ikur dhe jeni në ditët tuaja të fundit. As ky ligj dhe as ato që po përpiqeni të bëni me ngut këto ditë të fundit të parlamentit, nuk ju shpëtojnë dot nga 23 qershori.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Bukur fole!

Po, zoti Ministër.

**Flamur Noka** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Zoti Subashi, para se të flasësh për ligjin, më vjen keq që po ta them, por më së paku duhet ta kishe lexuar.

Ne kemi bërë edhe një relacion që është shpjegues i qartë. Ju ngrini pretendime në lidhje me procedurat dhe i konsideroni procedurat e ndërrimit të emrit dhe mbiemrit, procedura politike. E konceptoni komisionin, komision politik.

Unë po ju them: është e zeza në të bardhë, rekomandim i shkruar në ligjëratë të drejtë i Komisionit European, është rekomandim i qartë. Kështu që po ta kishe lexuar mirë relacionin, nuk do ta ngrije këtë pretendim.

E dyta, flisni që ka me mijëra persona kontigjent krimi, që kanë ndërruar emër dhe mbiemër. Sigurisht që ka kontingjent. Ky projektligj vjen kryesisht për këtë, sepse Shqipëria është i vetmi vend që aspiron për të hyrë në BE, që ka një tolerancë kaq të madhe për ndërrimin e emrit dhe mbiemrit të bazuar në ligj.

Po marr një shembull: Gjermania, i dashur Armando, e ka të sanksionuar që vetëm në rast se emri apo mbiemri është fyes, është tallës, poshtërues, atëherë mund të aplikosh për ta ndërruar emrin apo mbiemrin. Rrethanë tjetër nuk pranohet. Në Shqipëri ka qenë një procedurë shumë liberale, që ka sjellë që një pjesë e shtetasve tanë, të cilët kanë probleme dhe kanë krijuar problematikë me ligjin në nja nga vendet e BE-së, vijnë me një procedurë shumë të lehtë: ndërrojnë emrin dhe mbiemrin, kurse të dhënat ruhen, por vetëm për territorin e Shqipërisë, çka do të thotë se çdo njeri që ndërrohet 5 apo 15 herë emrin apo mbiemrin në gjendjen civile dhe në sistemin Tims, brenda hapësirës së vendit tonë, ka një numër identifikimi personal të pandryshueshëm. Ai sa herë që ta ndryshojë emrin apo mbiemrin, në Shqipëri ka të dhëna që dihet se për kë person bëhet fjalë. Problemi është se ai shkon me dokument të ri identifikimi në një vend të BE-së dhe humbet identitetin e vjetër dhe mund të vazhdojë aktivitetin kriminal.

Ne kemi marrë një detyrim edhe para partnerëve tanë europianë, që Shqipëria nuk do të jetë vatër që do të prodhojë kriminalitet as për vendin, por as për BE-në. Kjo edhe për dinjitetin

e shqiptarëve. Ky ligj vlen shumë edhe për marrëdhëniet me partnerët tanë dhe me BE-në.

Ju, zoti Subashi, përmendët faktin se ka persona që kanë dy karta.

Ligji i mëparshëm e saktëson qartë: në momentin që aplikon për një dokument identifikimi, kartë identiteti apo pasaportë biometrike, automatikisht, sepse është sistemi më modern ndër pesë sistemet më moderne që ka bota sot, del i pavlefshëm dokumenti i identifikimit që ke pasur më përpara. Pra, është zero shansi që një qytetar të ketë dy dokumente identifikimi. Ju mund t'i prodhoni dhe t'i nxirrni, siç keni bërë para zgjedhjeve të vitit 2009. Unë e di që është situatë para zgjedhore dhe po hamendësoni. Ju i përmendët para zgjedhjeve të vitit 2009 dhe pas një jave i harruat. Kështu që është zero shansi.

Për sa i përket shqetësimit që ngritet për kufizimin që bën ligji për emrat dhe mbiemrat historikë, ne jemi amxhorancë që kemi respekt dhe do të kemi respekt për të gjitha figurat historike që ka nxjerr ky vend. Ky është detyrim jo vetëm yni, por edhe i atyre që do të vijnë, pra të respektojnë historinë dhe figurat historike të vendit tonë. Ne nuk mund të pranojmë dhe nuk do të pranojmë kurrë që një figurë historike e vendit të bëhet qesharake në raport me opinionin dhe me qytetarët.

Unë e di pse e keni këtë shqetësimi. Keni hallin tuaj. Edi Rama ju konsideron rilindës dhe ju ka bërë gati nga një emër të rilindësve të vërtetë për t'ju vendosur. Tani, me miratimin e ligjit, ju ngeleni pa emrat e rilindësve, sepse ligji nuk e lejon kryetarin tuaj t'ju vendosë. Kjo nuk është fatkeqësia jonë, por juaja.

Ky është një ligj jashtëzakonisht i vlefshëm dhe që e ndihmon Shqipërinë të përafroj legjislacionin me BE-në, por edhe e çon në rrugën drejt BE-së.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Felaj, në emër të grupit të PS-së!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Zoti Ministër, përpara se të na flisni për ndryshimin e emrave, mbiemrave dhe procedurën e bërjes së ndryshimeve të tilla apo për marrjen e identiteteve të reja, do të ishte mirë që më parë të informoheshit se sa çështje ka hetuar dhe gjykuar, qoftë prokuroria, qoftë

gjykata për dhjetëra kosovarë që kanë marrë identitetet e emigrantëve shqiptarë dhe janë pajisur me karta identiteti shqiptare.

Edhe ligji “Për gjendjen civile” i miratuar 4 vjet më parë, si shumë ligje të tjera, nuk ka mundur t’i rezistojë kohës dhe sot neve na duhet të diskutojmë ndryshime edhe për këtë ligj. E bëra këtë vërejtje jo thjesht për ndryshimet që bëhen në ligj, sepse mund të ndodh që praktika e zbatimit të ligjit ta imponojë në mënyrë të pashmangshme ndryshimin. Kemi pothuajse 6000 shtetas shqiptarë që kanë ndryshuar emrin dhe mbiemrin. Kjo është një situatë që e ka shqetësuar BE-në. Në këtë kuadër, vijnë edhe këto ndryshime. Problemi është se ka që në korrikun e vitit të shkuar që janë sugjeruar të bëhen ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile” dhe këto ndryshime vijnë kaq vonë.

Gjithsesi, ne konstatojmë qartësisht se stafet që qeveria vë në dispozicion të përgatitjes së kuadrit ligjor, janë të paafta dhe tejet jo profesionale.

Në fakt, shprehja: “Bëmë baba të të ngjaj”, vlen pikë për pikë për qeverisjen tuaj. Një qeverisje e paaftë, e dështuar, që rreshton në krah të vetes stafe po kaq të paafte.

Kur u njohëm me këtë projekt në Komisionin e Ligjeve, na u tha se nuk po propozoheshin thjesht ndryshime, por një reformë e vërtetë me tri aspekte:

Reforma e dispozitave që kanë të bëjnë me emrin dhe mbiemrin. Është vetëm një nen në ligjin “Për gjendjen civile”, neni 57, i cili është ndryshuar dhe është bërë me 10 pika. Kjo është reforma e parë.

Përshtatja e ligjit aktual të gjendjes civile me evolucionin e legjislationit për bazën e të dhënave me ligjin “Për të dhënat personale”. Edhe këtu është vetëm një dispozitë, madje një paragraf i një dispozite që është riformuluar. Ky është edhe revolucioni në përshtatje me ligjin “Për të dhënat personale”.

Së treti, rregullimet e nevojshme që kanë lindur për shkak të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2012. Edhe këtu përsëri ka një reformë të madhe. Është hequr fjala “kombësi”, si një fjalë, të cilën një vendim i Gjykatës Kushtetuese e ka konstatuar si antikushtetuese nga e gjithë përmbajtja e ligjit.

Sigurisht, që të gjithë ata që nuk e kanë parë projektin e propozuar nga ju, pra nga

qeveria, teksa dëgjojnë gjithë këtë ligjërime për reformimin e ligjit “Për gjendjen civile”, me siguri mendojnë se qeveria do të ketë bërë ndonjë gjë të padëgjuar me këtë ligj. Megjithatë, çështja rreth së cilës qeveria e ka sjell në këtë rast dhe na ka propozuar këto ndryshime, nuk është aq e ndërlikuar sa diskutimi: pula vezën apo veza pulën. Është shumë e thjeshtë dhe meritonte një zgjidhje po kaq të thjeshtë, të qartë dhe përfundimtare.

Me ligjin aktual të gjendjes civile, procedura e ndryshimit të emrit apo mbiemrit nuk ka kufizime nga ato që mund të konsiderohen të rrepta. Një gjë e tillë ka krijuar probleme për sa i takon nivelit të sigurisë së dokumenteve shqiptare të identifikimit.

Shumë persona të dënuar ose të dëbuar nga vendet fqinje, për të fshehur të kaluarën e tyre, me qëllim aktivizimin në aktivitete kriminale ose për t’u rikthyer në vende nga ku janë përjashtuar ose nuk janë lejuar të qëndrojnë, e ndryshojnë identitetin e tyre, pra emrin apo mbiemrin ose të dyja bashkë, duke përfutur në rastin e fundit edhe dokumente të reja identifikimi, pra pasaportën e re biometrike.

Ngjarje të tilla cenojnë si sigurinë publike të vendeve fqinje, të vendeve të BE-së, ku këta persona kanë akses të hyjnë që pas liberalizimit të vizave, ashtu edhe sigurinë e dokumenteve të identifikimit me të cilat shteti shqiptar pajis shtetasit e vet. Në këto rrethana del e nevojshme që shteti ynë të marrë masa të tilla që të sigurojë mbikëqyrjen e hollësishme të procesit të ndryshimit të emrit dhe mbiemrit, që nga ana tjetër ngelen edhe një e drejtë e çdo individit. Këtë është munduar të bëjë edhe qeveria në këtë projekt, ndonëse me të vetmen mënyrë që njeh kur vjen fjalë te ligjësia, me kopjim.

Emri dhe mbiemri, sipas projektit që na propozohet, mund të ndryshohet vetëm në rastet e parashikuara në Kodin e Familjes, pra martesat, divorci, birësimi, si dhe me kërkesë të personit të interesuar, kur emrat dhe mbiemrat janë të papërshtatshëm, pra janë qesharakë, fyes e të tjera raste. Deri këtu, që ta dini të gjithë, nuk ka asgjë të re në raport me ligjin aktual që kemi. E reja që është sjellë është se janë rritur rastet kur emri apo mbiemri do të konsiderohen si të papërshtatshëm, ndërkohë që është ndryshuar procedura që duhet të ndjekë qytetari për të tilla ndryshime, si dhe është kufizuar e drejta për të

ndryshuar emrin dhe mbiemrin në vetëm një herë.

Qeveria është munduar ta reformojë procedurën në mënyrën e vet, por në fakt, rezultati është zhgënjyes. Në qoftë se qytetari, sipas ligjit aktual, për të ndryshuar emrin dhe mbiemrin i drejtohet nëpunësit të zyrës së Gjendjes Civile të vendit ku ai banon, ky i fundit, së bashku me përgjegjësën e zyrës, në qoftë se kërkesa e qytetarit është konform ligjit, bën ndryshimin e kërkuar. Tani kërkesa e qytetarit nuk do të kalojë më në një dorë, por në disa duar, në disa pagesa, në një afat shumë të gjatë që shkon drejt një viti ose më shumë. Po ta shihni, ligji e lë të hapur edhe këtë afat. Pra, kjo qeveri që ecjen përpara e bën me nga një ndalesë, në rastin e këtij ligji nuk dihet pse i është shmangur këtij kursi. Me sa duket, kështu ia kërkon Europa, siç na thanë propozuesit e ligjit. Pra, duke marrë për *casus* atë të një kolegu në Komisionin e Ligjeve, kërkesa e asaj që do të bëhet Hysen, do të shkojë nga nëpunës i gjendjes civile, së bashku me një set të tërë dokumentesh, te prefekti. Ky i fundit, pasi të ketë bërë disa detyra tipike prej gjyqtari si p.sh., të përcaktojë juridiksionin dhe kompetencën, të hetojë, të mbledhë prova, të verifikojë, të legjitimojë kërkuesin, të çmojë, të urdhërojë ndreqjen e të metave në kërkesë, të urdhërojë afishimin e kërkesës për ndryshim të emrit në Fletoren Zyrtare, të vlerësojë kundërshtimin e të tretit, në fund do të marrë mendim themeli, e padëgjuar, dhe këtë do t'ia nisë një komisioni kombëtar që do ta ngrejë hirësia e tij ministri i Brendshëm ose i gjendjes civile, ose i punëve të brendshme, ose i punëve botore, kjo ka mbetur pa u thënë në ligj, se më të gjithë këta tituj e gjen ministrin e Brendshëm në Shqipëri

Mendoni pak se çfarë reforme i është dashur të sjellë ministrit i Brendshëm, mjaft që të fuste duart në Kodin e Procedurës Civile, ose në Kodin e Procedurës Administrative dhe t'ia zhvatte pa të keq kompetencat gjyqtarit duke ia dhënë prefektit. Nuk mjaftohet me kaq, Hasanit që do të bëhet Hysen, i duhet të presë 60 ditë që kërkesa të shkojë nga zyra e gjendjes civile te prefekti, 30 ditë që të plotësojë kërkesën nëse prefekti kap ndonjë gabim, 15 ditë të afishimit të Fletoren Zyrtare, 45 ditë në qoftë se ndonjë person i interesuar e kundërshton kërkesën e tij. Pra deri këtu kemi 150 ditë, ose 5 muaj.

Në qoftë se kërkuesi do të marrë emrin apo mbiemrin e dikujt, një personi të njohur e të shquar, do t'i duhet të presë maksimalisht 8 muaj, që prefekti të nxjerrë mendimin e tij të themelit.

Pra, si kanë kaluar në rastin më fatlum, ose 8 muaj në rastin më fatkeq, vendimi i themelit të prefektit do të merret në shqyrtim po në themel nga një komision kombëtar me pesë vetë, të gjithë nëpunës të Ministrisë së Brendshme, të cilët mund ta pranojnë kërkesën e Hasanit dhe këtë mund ta bëjnë kur të duan pasi në ligj nuk ka asnjë afat për këtë gjë.

E shihni edhe vetë se sa premtuese është kjo procedurë. Për qytetarin e thjeshtë, të që është në të drejtën e vet, qeveria ka rezervuar një rraskapitje të vërtetë. Ndërkohë që për pelivanët e ligjit kjo nuk do të përbëjë asnjë problem, tek e fundit vendimi që do t'u japë atyre mundësinë të ndryshojë emrin apo mbiemrin do të jetë një vendim kolegjal, njëngjyrësh dhe askush nuk do të mbajë përgjegjësi nëse ndryshimi i emrit apo mbiemrit nuk bëhet konform ligjit. Pra, është një vendim i lehtë për t'u nxjerrë, pasi nuk ka asnjë pasojë për zyrtarët fanatikë të Ministrisë së Brendshme, që, me sa duket, e vetmja punë që do të bëjnë nuk do të ketë të bëjë me mbrojtjen e interesave të qytetarëve, por me çështjen e ndryshimit të emrit dhe mbiemrit nga ana e qytetarëve.

Zotërinj, këtë mund ta bënit shumë thjesht, me një vendim gjyqësor dhe me ato kufizime që propozonit, pa qenë nevoja që rrogën e respektuar të gjyqtarit ta vidhnit dhe t'ia vishnit prefektit apo stafit të Ministrisë së Brendshme. Me sa duket kjo është qasja juaj me pushtetin. Për ju nuk ka tri pushtete, ka vetëm një, që e mban dikush në dorë dhe e rrotullon si të dojë. Kështu është për ju KQZ-ja, i varur, njëngjyrësh, i sprovuar në beteja të vjedhjeve të votave, kështu duhet të jenë edhe gjykatat e Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Keni një tufë njerëzish të besimit tuaj, që i çoni sa nga Kuvendi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, mundësisht njëri bashkëshort në KLD tjetri në KQZ, nga Gjykata e Lartë në atë Kushtetuese dhe anasjelltas. Pra, jeni në një qerthull interesash mesquine, që ulin dhe ngrënë të njëjtët njerëz. Kjo është ajo që thamë për Shqipërinë...

*(Diskutime pa mikrofon në sallë.)*



**Flamur Noka** - Kisha një pyetje. Ti zonjë nuk mund të flasësh për çështje të konfliktit të interesit, sepse i gjithë Berati e di qartë, ta kanë shkruar edhe në gazetë. E ke lexuar gazetën, apo jo?! Ke punuar vetë prokurore dhe burri yt ka qenë oficer i policisë gjyqësore. Ta kanë marrë peng ata të bashkisë. Sqaroji pak qytetarët se te cili lokal bëje pazarin dhe a është pronari i lokali një kriminel që e ke liruuar ti, dhe sqaro përse të është marrë burri peng!

Ky është morali i vajit, dhe kur të dalësh e të flasësh këtu, duhet të kesh moral që qytetarët të të pranojnë. Kur qytetarët ty të nxjerrin në gazeta dhe të bëjnë batuta, nëse do të kishit pak moral, nuk do të flisnit këtu.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli - Çfarë s'po dëgjojmë!**

**Çfarë pune tjetër ka ministri i Brendshëm? Që të mos ju zënë burrat peng, moj Shegë!**

**Nuk e dija që ia kanë marrë burrin peng.**

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të RSH-së dhe grupimit "Morfo" dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve".

Specialistët le të fillojnë me përgjigjet e pyetjeve të bëra nga deputetët.

*(Zoti Balla flet pa mikrofon.)*

I tërheq vëmendjen deputetit Balla!

Urdhëroni zonjë!

**Miranda Harizaj** - Jam përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme.

Lidhur me pyetjet e ngritura kam këto përgjigje:

Lidhur me pyetjen e parë, në faqen 4, germa "a", përmirësimi i dokumenteve të identitetit... *(nuk dëgjohet)*

*(Vazhdojnë ndërhyrjet pa mikrofon nga salla.)*

**Jozefina Topalli** - Zonjë, faleminderit për përgjigjet!

Zonja Dade, urdhëroni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Të tërheq vëmendjen për fjalorin që po përdor!

Kam 5 minuta që ju kërkoj të dëgjoni zonjën. Ju lutem, zonjë, përsëriteni edhe një herë fjalën tuaj!

**Miranda Hazizaj** - Lidhur me pyetjen e parë që është në faqen 4, pika 2, germa "a", përmirësimi i dokumenteve të identitetit, thuhet se në vitin 2015 do të ulet mundësia e falsifikimit të dokumenteve dhe se sa mundësi falsifikimi ka sot sistemi.

Atëherë lidhur me këtë pyetje mund të them që përmirësimet e dokumenteve të identitetit janë në dy drejtime. Sigurisht që sistemi ekzistues i dokumenteve të identitetit i plotëson të gjitha standardet, të cilat janë vlerësuar dhe sistemi është i certifikuar me sistemet e kërkuara në fushë, që pak sisteme të tilla e plotësojnë, siç është standardi ISO 7001, të cilin qendra e personalizimit dhe sistemi i lëshimit e ka plotësuar brenda 3-mujorit të fundit të vitit 2011 dhe përmirësimi i dokumenteve të identitetit shkon në dy drejtime të përgjithshme, ku drejtimi i dytë është futja e një sistemi të ri biometrik, pasi ekzistuesi është ai shenjave të gishtave. Me ecjen përpara të teknologjisë ne mundohemi të sjellim më të mirën, duke ndjekur edhe zhvillimet e fundit të teknologjisë, siç është futja e verifikimit përmes fotos tredimensionale. Ky element i dytë, pa diskutim, që përmirëson dhe rrit sigurinë e sistemit, duke futur dy elemente në të njëjtën kohë.

Së dyti, lidhur me dokumentet e identitetit, ai dokument në vitin 2015 do të ketë një çip më të madh, pra kapacitet më të madh, sigurisht edhe algoritmet dhe metodat e kontrollit, pra teknologjia e inkrimitit do të avancojë dhe ne do të fusim teknologjinë e fundit, që është pikërisht "extended advanced control", e kërkuar kjo nga standardet në fushë, sigurisht nga standardet IKAO dhe ato përkatëse të BE-së.

Sistemi ynë i sotëm i plotëson të gjitha standardet dhe minimizon në zero mundësinë teknike të pajisjes me dokumente të falsifikuara. Pra, çdo tentativë ndalohet nga sistemi, raportohet dhe ndiqet sipas procedurave përkatëse.

Si tentativë konsiderohet çdo përpjekje nga çdo qytetar që tenton të aplikojë, ndërkohë që sistemi ka edhe filtra të tjerë, pasi është pjesa administrative. Unë mund t'ju shpjegoj nëse e kërkon. Çdo qytetar shqiptar që pajiset me dokument identifikimi, që është pasaporta, plotëson një formular, i cili mund verifikohet nga personat përgjegjës, që, në radhë të parë është komisarati përgjegjës me strukturat e veta dhe,

në radhë të dytë, është nëpunësi i gjendjes civile, ku merren dokumentet e nevojshme për dokumentet.

Në momentin e prodhimit të dokumentit të parë, në rastin e tentativës, sistemi filtron duke bërë verifikimet e nevojshme, pra dallohet nëse tentativa bëhet nga personi i regjistruar në të dhënat e gjendjes civile që tashmë ekzistojnë për të, një më një, apo nëse tentohet nga dikush tjetër të marrë një dokument të dytë identifikimi me të dhënat e personit në fjalë, pra një dokument të dytë. Kontrolli bëhet një më një mbi bazën e shenjave biometrike. Kjo është një nga garancitë më kryesore.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Ky verifikim bëhet që në momentin e parë, bazuar në të gjitha kërkesat.

Po kaloj te pyetja e dytë: Në ç'gjendje sigurie është sot sistemi dhe çfarë ka ndodhur që po ndryshon?

Mendoj se ato çfarë thashë te pyetja e parë janë në funksion të pyetjes së dytë. Sistemi është i bazuar në teknologjinë e kërkuar dhe që ka plotësuar të gjitha standardet, është certifikuar, dhe ne po përmirësojmë sistemin, po fusim më shumë elemente sigurie, duke përmirësuar dokumentet në vetvete përmes çipit dhe përmes procedurave ndërmjetëse që nisin nga stacioni i aplikimit përmes pajisjeve të standardeve për të larta, si kalimi nga aparati dydimensional në atë tredimensional në fotografim etj.

Për grupin e tretë të pyetjeve: A rrit kontrata çmimin e kartave të identitetit dhe pasaportave? Sa është kostoja e prodhimit të këtyre dokumenteve që të nxjerrim se sa fiton kompania?

Lidhur me këto pyetje, duke iu referuar edhe relacionit, çmimi i dokumenteve do të ndryshojë në janar të vitit 2015, në të njëjtën kohë kur dokumentet që do t'u shpërndahen qytetarëve shqiptarë do të kenë cilësi dhe teknologji më të lartë, gjë e cila do të reflektohet edhe te pajisjet që do të përdoren dhe të gjitha investimet që do të bëhen në qendrën e personalizimit, duke përfshirë makinat e prodhimit, metodat e teknologjisë, pajisjet lexuese për cilësinë e dokumentit, deri te lëshimi i pasaportës për qytetarët.

**Jozefina Topalli** - Faleminderit zonjë!

Keni pyetje tjetër?

**Specialistja** – Pyetja e katërt: kontrata po përfundonte në korrik, sot jemi në prill, çfarë e detyroi qeverinë që ta sjellë këtë projektligj dhe çlidhje ka kjo me zgjedhjet?

Lidhur me këtë pyetje, në bazë të ligjit aktual, gjashtë muaj para se të përfundojë kontrata, e cila mbaron më 28 korrik 2013, është përcaktuar se, nëse kompania nuk vazhdon negociatat, kjo që sapo kemi propozuar, duhet të fillojnë kthimin e të gjitha asetëve shtetit, Ministrisë së Brendshme. Për këto arsye negociatat pikërisht kanë filluar para kësaj kohe dhe nuk ka asnjë lidhje me zgjedhjet.

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zonjë, për shpjegimet!

Zonja Dade, urdhëroni!

**Arta Dade** – Të nderuar kolegë,

Së pari, dua të shpreh keqardhjen e thellë për spostimin në axhendën e Parlamentit për arsye shumë vulgare, sepse nuk janë të pranishëm përfaqësues të qeverisë, dhe aq më keq, nuk janë të pranishëm specialistët. Kjo që ndodh këtu, me shkeljen e Rregullores në mënyrë flagrante, tregon edhe një herë që kjo maxhorancë, e sajuar tashmë, sepse nuk është as maxhorancë, ka marrë fund dhe është në grahmat e saj të fundit.

Në ikje e sipër, e ashtuquajtura “maxhorancë”, që nuk ekziston më dhe që rrënoi vendin këta tetë vjet, e ka ndarë mendjen që deri në grahmat e fundit të dëmtojë buxhetin e shtetit, për rrjedhojë, të varfërojë më tej shqiptarët, të cilët ndër dhjetëra vjet do të paguajnë brez pas brezi borxhet dhe koncesionet e Sali Berishës.

Projektligji “Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen e përmirësimit të kontratës së koncesionit për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike” kërkon të përligjë favoret që qeveria i bën një kompanie të diskutueshme për disa elemente të rëndësishme, të cilat kanë përbërë shqetësim në këtë Kuvend edhe pesë vjet më parë, kur e njëjta qeveri vendosi t’ia besonte të njëjtës kompani prodhimin e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Si çdo akt tjetër që i imponohet Parlamentit për ta bërë bashkëfajtor në vendime me prapavijë korrupsioni, nga relacioni del se do të forcohen elementet e sigurisë. A mos nënkupton kjo se kartat dhe pasaportat e prodhuara deri më sot nuk i kanë këto elemente në atë shkallë që të jenë

dokumente të besueshme dhe të pafalsifikueshme? E dimë që në zgjedhjet e 2009-s u kapën karta false të prodhuara për të pajisur personat që votuan disa herë, madje persona që nuk figuronin fare në listën e zgjedhësve, akt ky që është denoncuar edhe nga kjo foltore, me të cilën prokuroria është duke u marrë, madje është pranuar edhe nga ish-ministri i Rendit, aktualisht President i Republikës.

Sipas standardeve, pasaportat shqiptare kanë krijuar problemin e pa zgjidhur ende për toponimet e vendlindjeve të fëmijëve në një vend fqinj. Prodhimi i kartave të identitetit është i lidhur ngushtësisht me mbajtjen e zgjedhjeve të lira demokratike dhe të ndershme për arsye se dokumentet e identifikimit duhet të jenë të besueshme dhe të paprodhueshme nga subjekte në mënyrë të paligjshme, por edhe me vlerë monetare të përbalueshme nga shtetasit e varfër të këtij vendi, të sflitur prej grabitjes sistematike dhe nëpërkëmbjes së dinjitetit.

Ky projektligj nuk është diskutuar as në Komisionin e Ekonomisë dhe as në Komisionin e Politikës së Jashtme. Kostoja e kartës rritet, dhe kjo rritje bie te qytetarët, por këtu nuk po flas për humbjen që i krijohet buxhetit të shtetit, e cila kap shifrën 139 milionë euro dhe fitimet që vjel kjo kompani, që kësaj radhe na paraqitet me emër të ndryshuar, dhe që, sipas deklarimit të vetë kompanisë, kapin shifrën prej 14 milionë eurosh në vit.

Normalisht, në seancat e fundit të kësaj legjislature janë shënuar evente, të cilat do të mbeten gjatë në kujtesën tonë kolektive parlamentare si akte të papranueshme shkeljesh kushtetuese, të cilat, Parlamenti që do të dalë nga zgjedhjet e 23 qershorit duhet t'i rishqyrtojë. Druaj nëse ia vlen të marrim pjesë në diskutime rreth akteve që kalon ky parlament dhe që më së shumti janë akte në dëm të interesave të publikut, por edhe që mbrojnë interesa okulte korruptive të qeverisë së Berishës, sikurse favoret që po i krijohen përsëri të njëjtës kompani.

Arbitrarizmi dhe autoritarizmi i Berishës së fundi shtriu kthetrat haptazi dhe pa droje edhe në KQZ. Ai e bëri këtë i mbërthyer nga frika e humbjes së thellë të pushtetit dhe drejtësisë, që do të veprojë mbi të, për çdo ligj që shkeli dhe për çdo krim dhe vrasje që urdhëroi, për çdo akt korruptimi, duke e hedhur në aventurë këtë Parlament, sikurse rasti i grabitjes nga Kuvendi i

kompetencave që ligji ia jep KQZ-së në rastin e ndarjes së mandateve, shkarkimi i një prej anëtarëve të KQZ-së, pasuar nga dorëheqjet e tre prej anëtarëve të këtij institucioni, i cili ka mbetur instrument i verbër i Sali Berishës, njësoj si në kohën e Ristanit që u ofroi shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve skena të vjedhjes flagrante të zgjedhjeve nga maxhoranca në KQZ.

Partnerët tanë ndërkombëtarë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës te Bashkimi Europian, por edhe përfaqësues të vendeve të Bashkimit Europian, po ndjekin me shqetësim zhvillimet e fundit në KQZ dhe po kërkojnë zgjidhjen emergjente të problemit të krijuar nga Sali Berisha. Mesazhet e ambasadorit Arvizu, Komisionerit për Zgjerimin, Fyle, të drejtorit në Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Moore, ambasadores së Gjermanisë, ambasadores së Çekisë, Presidentit Fisher të Austrisë, përpos mesazheve të mëparshme të baroneshës Eshton, janë të drejtpërdrejta, të unifikuara dhe paralajmërojnë se kësaj here ata nuk do t'ia falin Saliut po të cenojë vullnetin e shqiptarëve për zgjedhje demokratike. Ne, gjithashtu, kërkojmë që Sali Berisha t'i kthejë ligjshmërinë KQZ-së, të zgjidhë problemin që krijoi ai vetë, të qëndrojë larg manipulimit të zgjedhjeve duke i hapur rrugë organizimit të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike, duke çliruar axhendën evropiane të shqiptarëve. Jam e bindur se edhe nëse kjo nuk ndodh, shqiptarët do të dinë t'i japin atë që meriton Sali Berishës, përmes pjesëmarrjes në votime dhe përmes barrikadës së votuesve në mbrojtjen dhe administrimin e vullnetit të tyre të lirë në komisionet zgjedhore të niveleve të tjera.

Sali Berisha ka falimentuar. Ai e di që do të dështojë në manipulimin e zgjedhjeve, sepse kartat që ka ende në dorë, të tipit Pone-Ristani, si dhe marionetat në KQZ, do të mendojnë për vete kësaj radhe. Ai po blinda Gjykatën e Lartë me shërbëtorë të tipit Ndreca, që vulosi vjedhjen e zgjedhjeve në 2009-n dhe 2011-n. Ai e di që nuk i vjedh dot zgjedhjet tani, por kërkon të sigurohet që Ndreca dhe të tjerët si Ndreca, t'i dalin zot kur të shkojë përpara drejtësisë. Por kjo nuk ndodh sepse sundimi i ligjit është e para gjë që kërkojnë dhe presin shqiptarët.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr zoti Turku.)*

**Ardjan Turku** – Faleminderit, zonja Dade!  
Zoti Lutaj, urdhëroni!...

**Piro Lutaj** – Të nderuar kolegë,

Edhe ky projekt që na keni venë sot përpara dhe që lidhet më ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit “Për prodhimin, dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike”, nuk është gjë tjetër, veçse ndonjë qokë e mbetur dhe e pabërë nga ana e qeverisë për klientët e saj.

Personalisht e kam shumë të qartë se këto lloje iniciativash që ndërmerri me nxitim, nuk kanë për qëllim të rregullojnë problematikën e pajisjes me dokumente të qytetarëve shqiptarë, pasi, nëse do të ishte kështu, nuk do të ndodhte që apartçikët tuaj mediokër, me të cilët keni mbushur konsullatat kudo në botë, do t’u krijonin emigrantëve shqiptarë njëmijë e një pengesa me qëllim që ata të mos pajisen me dokumente. Për të qenë më konkretë, po u them se nëpër zyrat konsullore në Itali, emigrantëve shqiptarë, të cilët kanë aplikuar për dokumentet e identifikimit (kartë identiteti dhe pasaportë), po u jepen vetëm pasaportat dhe jo kartat e identitetit. Apartçikët e konsullatave në Itali deri sot kanë bllokuar mbi 40 000 karta identiteti të emigrantëve, me synimin për t’u vjedhur votën atyre me 23 qershor. Kjo është një nga mënyrat e turpshme që po përgatiteni të aplikoni me synimin e dalëboje për të vjedhur votat e shqiptarëve.

Por edhe këtë mënyrë ne do ta shmangim së bashku me aleatët tanë, përfshirë edhe emigrantët që mezi presin të votojnë largimin tuaj nga pushteti, me qëllim që, kur të kthehen në vendin e tyre, të mos gjejnë në krye të tij një uzurpator si Saliu. Përpëlitet tuaja me lloj- lloj makinacionesh për të manipuluar zgjedhjet në Shqipëri i përkasin të shkuarës dhe nuk do të mundeni të manipuloni as me marrëzi si ajo e disa ditëve më parë, kur u ndryshua anëtari i KQZ-së, duke e zëvendësuar atë me një përfaqësues të partisë së Gërdecit.

Zotërinj të maxhorancës, ju nuk ndaheni dot nga Gërdeci dhe ky nuk është faji i shqiptarëve. Sikur të mos mjaftonte përzierja e KQZ-së me Topallin, e përziet atë para dy ditësh edhe me barutin e Gërdecit.

Shfaqjet qesharake të atyre 4 dordolecëve që ju kanë mbetur në KQZ dhe që e mbajnë

fishën të lidhur me Saliun dhe Jozefinën, nuk do të mund të cenonin rezultatin e zgjedhjeve, por ato që po bëjnë do të rëndojnë në ndërgjegjen e tyre si një veprimtari barbare, që nuk cenon vetëm dinjitetin e tyre, por të të gjithë shqiptarëve.

Ne nuk kuptojmë me kë konsultoheni ju. I gjithë opinioni kombëtar e ndërkombëtar është çuar në këmbë dhe ju thotë troç, madje më troç se kurrë të mos e vazhdoni këtë marrëzi.

**Ardjan Turku** – Zoti Lutaj, jeni pa lidhje fare, ju lutem!

**Piro Lutaj** - Drejtori i Zyrës për Europën Jugore dhe Qendrore në DASH, në mënyrë të qartë theksoi se pa plotësuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me shtatë anëtarë nuk mund të zhvillohen zgjedhjet. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri deklaroi hapur dje se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të rikonfigurohet nga e para. Opinioni qytetar pret reagimin tuaj, ndërsa ju merreni nga mëngjesi në darkë me opozitën dhe kryetarin e opozitës Edi Rama.

Zotërinj të maxhorancës, Edi Rama është kryetari që bashkoi vlerat e të gjithë shqiptarëve dhe ju la ju në prehër disa forca politike të kriminalizuara e disa të tjera pa identitet, madje kanë gjetur belanë gazetarët se nuk po u gjejnë dot as emrat e kryetarëve të tyre. Ky është koalicioni juaj.

**Ardjan Turku** – Zoti Lutaj, jeni në shkelje të Rregullores!

**Piro Lutaj** - Shqiptaret ju njohin mirë. Këto kohët e fundit e keni humbur toruan fare. Po i kërcënoni njerëzit tuaj nëpër institucione dhe ata nga e keqja po mundohen t’ju ngjajnë juve. Këtë e shohim edhe këtu në Parlament. Pamë sjelljen e ministrit të Brendshëm dhe sjelljen e Kryetares së Kuvendit. Meqë këtu nuk ka ministra të pranishëm, është një ministër i votuar me votat e socialistëve dhe nuk ia vlen të flas për të, por po i drejtohem ministrit të Brendshëm se paraqitjen tende kanë marrë të gjitha institucionet e sigurisë së këtij vendi, posaçërisht Ministria e Brendshme është larg interesit të qytetarëve dhe në shërbim të klientëve tuaj. Bëni vetëm një verifikim se cilët ishin personat që u angazhuan pardje në bastisjen e 14 familjeve të varfra në mes të Tiranës! Kush ishte personi që pretendonte pronën? Kush ishte personi që kishte dhënë vendimin e gjykatës?

Kush ishte përmbaruesi që do të ekzekutonte vendimin? Cila ishte policia private që do të mbështeste ekzekutimin e vendimit? Dhe se fundi kush ishte personi që drejtonte forcat e Policisë së Shtetit?

Ju, fatkeqësisht, deri më 23 qershor jeni në qeveri, por jeni në qeveri jo vetëm për pronarët, por edhe për ata që e kanë marrë pronën pa qenë pronarë, edhe për qytetarët e thjeshtë që banonin në ato shtëpi prej 70 vjetësh, e që prej 3 ditësh qëndrojnë nën qiell të hapur. Unë nuk dua përgjigje nga ju, atë jepuni qytetarëve që i masakruat në mes të Tiranës. Kështu po i lini institucionet e shtetit shqiptar dhe në mënyrë të veçantë ato të sigurisë në një gjendje të mjeruar dhe për këtë po ju ndihmojnë drejtuesit e lartë të policisë, të cilët le të bëjnë si të bëjnë deri më 23 qershor, por pas kësaj date do të përgjigjen deri më një për pasojat e rënda që u kanë shkaktuar institucioneve të sigurisë kombëtare.

Zotërinj, ju ka hyrë vetja në qejf dhe ju duket nga sjellja e Kryetares së parlamentit dhe e ministrit të Brendshëm. Për ta konfirmuar këtë me një dokument, po i them opinionit qytetar shqiptar se kam këtu një revistë që boton Kuvendi i Shqipërisë. Ka 47 fletë dhe në 38 prej tyre është fotografia e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë. Kjo tregon se Kryetares së Kuvendit dhe maxhorancës i ka hyrë vetja në qejf. Meqë Kryetaren e kemi shkodrane ajo e di mirë se ç' do të thotë të të hyjë vetja në qejf.

*(Drejtimin e seancës e merr zonja Topalli.)*

**Jozefina Topalli** – Do t'i tërheq vëmendjen stafit të revistës të të nxjerrin ty një herë në kopertinë, në numrin e ardhshëm, se ke për të shndritur.

Zoti Bello, urdhëroni!

**Marko Bello** - Zonja Kryetare, kolegu parafolës përmendi atë revistën, interesante është ajo revista, por këtu po na ikën edhe stafi i Kuvendit, po ikën edhe një në KLD, ky këshilltari juaj, Lul Lelçaj. Po ikin të gjithë këta!

*(Flitet nga salla pa mikrofon.)*

A, do vijë përsëri? Është përkohësisht? E po mirë!

**Jozefina Topalli** - Këtu me ty ka për të ndenjtur. Inshalla je në opozitë!

**Marko Bello** – Disa i ke shpërndarë nëpër Itali, disa nëpër Romë, disa në Bari dhe gjithandej.

Ligji “Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimin e kontratës koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike midis Ministrisë së Brendshme nga njëra anë, dhe Grupimit MORPHO dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve” për mendimin e opozitës zbulon ngutjen e qeverisë shqiptare për të mbyllur llogarinë dhe garantuar miqtë dhe klientët e oborrit para se kjo qeveri të largohet nga pushteti më 23 qershor të këtij viti.

Sipas përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, të cilët i dëgjua edhe sot në këtë Kuvend, kontratës koncesionare po i skadonte afati, dhe ne, tha përfaqësuesja e Ministrisë së Brendshme, duhej që të nxirnim mësim nga gabimet e së kaluarës, dhe nga pesë vjet do ta shtrinim këtë kontratë në një afat 10-vjeçar. Për këtë përmendi faktin se, përgjithësisht, koncesionet jepen për periudha afatgjata.

Shumë mirë që Ministria e Brendshme shqetësohet për koncesionarin, jashtëzakonisht mirë që përfaqësuesit e qeverisë shqiptare i ha merakun sesi do të mbushen xhepat e pushtetarëve, po për qytetarin shqiptar a merakoset njeri nga kjo qeveri? Këtu kam parasysh faktin se çmimet e pasaportave do të rriten jo 20 për qind, as 30, por gati 50 për qind, pasi duke filluar nga viti 2015 një pasaportë elektronike do të kushtojë 75 mijë lekë të vjetra ose 7500 lekë, po kështu dhe kartat e identitetit nga 1200 lekë, do të rriten gati në 2 mijë lekë.

Koncesionet që kjo qeveri i ka kaq për zemër, që nisën me sloganin e famshëm të Sali Berishës: “Shqipëria një euro”, për të maskuar grabitjen e trojeve, pronave dhe moskthimin e tyre pronarëve të ligjshëm dhe të ndershëm, tregon edhe një herë se kjo qeveri nën maskën e ekonomisë liberale, nën maskën e liberalizmit, ka shpërthyer duke e katandisur ekonominë shqiptare sot si kokoshi një thellë, për arsye se qindra objekte, ndërmarrje, që ishin ndërtuar me gjakun dhe djersën e të parëve dhe prindërve tanë, ashtu si edhe sot me koncesionet dhe shërbimet e ndryshme, kjo qeveri po i hipotekon dhe po garanton oborrtarët e vet dhe ata që fshihen pas koncesioneve, duke vënë në rrezik të ardhmen e fëmijëve tanë, të cilët, siç është theksuar edhe herë të tjera në këtë Kuvend, do të paguajnë një borxh shumë të madh për të ardhmen e tyre.

Sigurisht, ne nuk jemi kundër koncesioneve, kur është nevoja që këto koncesione të zgjaten patjetër, por rritja e pajustificuar dhe pa asnjë lloj transparence e kostos ndaj qytetarëve tregon edhe një herë se kjo qeveri është fare pa shpirt dhe ka hall vetëm të mbushë xhepat e vet nëpërmjet rishpërndarjes së këtyre të ardhurave që bën me të ashtuquajturat fonde publike apo tendera, që fillojnë dhe nuk mbarojnë asnjëherë, pasi paratë përfundojnë në xhepat e atyre që organizojnë këto tendera për rrugë apo për vepra të tjera publike.

Si ka mundësi, të nderuar kolegë të maxhorancës, që vetëm në Shqipëri një biletë avioni kushton tri herë më shtrenjtë sesa në vendet e Bashkimit Europian? Si ka mundësi që edhe kur në bursën ndërkombëtare çmimet e karburantit ulen, në Shqipëri vazhdojnë dhe rriten? Sigurisht, qeverisë i intereson që çmimi i karburantit të jetë sa më i lartë, me qëllim që, duke pasur edhe akcizën të tillë, të inkasojë më shumë para, paçka se dora e qeverisë zgjatet dhe shtyhet në xhepin e grisur të qytetarit duke kërkuar t'i marrë edhe shpirtin; TVSH për çdo produkt në Shqipëri, përfshirë edhe ato të shportës, përfshirë edhe ushqimet. Vetëm në Shqipëri ka një TVSH kaq të lartë e cila rrënon qytetarin shqiptar.

Kjo është arsyeja që një sondazh, i cili u publikua dje nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, tregoi qartë, përkundër propagandës bajate të qeverisë, se 66 për qind e qytetarëve të këtij vendi janë të mendimit se Shqipëria është në një krizë të plotë, mbi 60 për qind e tyre dëshiron të largohet urgjentisht nga Shqipëria, 33 për qind e të pyeturve shprehen se kriza ekonomike është problemi i tyre kryesor, dhe mbi 25 për qind të tjerë mendojnë se papunësia është problemi i tyre personal. Ky është një tregues i qartë i asaj që ka deklaruar Partia Socialiste, se numri i të papunëve në këtë vend ka kapur shifrën një milion. Sondazhi zbulon se vetëm 5 për qind e të anketuarve jetojnë mirë ose shumë mirë. Pra edhe këtu Partia Socialiste ka shumë të drejtë kur në programin e saj thekson se i drejtohet 95 për qind shqiptarëve të varfëruar, dhe kjo nuk ka të bëjë fare me 5 për qind të superpasuruarit nga pushteti i Sali Berishës.

Të nderuar kolegë,

Partia Socialiste është e vendosur ta ndalojë avancimin e vendit drejt humnerës, ku po e çon kjo qeveri, dhe sigurisht, pas 23 qershorit do të veprojmë urgjentisht me bisturi për të rregulluar funksionimin e shtetit ligjor dhe zbatimin e ligjit, duke luftuar varfërinë, nxitjen e punësimit, sidomos për të rinjtë që janë krejt të pezmatuar dhe të deziluzionuar nga politika. Çështjet e pronës dhe të pushtetit gjyqësor do të adresohen sipas standardeve perëndimore duke i dhënë një shans Shqipërisë dhe duke e ribashkuar përfundimisht atë me Europën.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zoti Bello!

Zoti Balla, urdhëroni!

**Taulant Balla** – Zonjë,

Sigurisht që kjo kontratë, që medoemos duhet ta ratifikoni në Kuvend para 23 qershorit, pavarësisht se kontrata ekzistuese mbaron diku në muajin korrik, ka dhe fsheh në vetvete disa probleme të cilat, për fat të keq, ju, me dashje apo pa dashje, i keni anashkuar. Gjëja e parë që bie në sy kur skadon një kontratë koncesionare, siç është kjo për dokumentet e identitetit, është fakti që ju keni harruar se çfarë keni parashkuar në kontratën fillestare.

Në kontratën fillestare ishte parashkuar që pas pesë vjetëve të koncesionimit të këtij shërbimi, që në pjesën më të madhe të vendeve është shërbim publik, t'i kalonte shtetit, ti kalonte pse jo, Policisë së Shtetit. Por sot gjendemi në situatën kur qeveria vjen me një propozim që nuk e shtyn më pesë vjet, por merr masat për dhjetë vjet. Pra, e shtyni kontratën nga viti 2013 në vitin 2023, kur kontrata fillestare e këtij koncesioni ka qenë vetëm pesë vjet, pra ju e shtyni edhe dhjetë vjet të tjera.

Problemi i dytë: ka një dimension ekonomik çdo lloj koncesioni. Është supozuar se kur është lidhur kjo kontratë, kompania që ka fituar këtë koncesion sigurisht e ka garantuar fitimin e vet, që do të thotë se pas ezaurimit të afatit të koncesionimit të këtij shërbimi, ju ose duhet të lidhni një kontratë të re për përfitimet e këtij shërbimi, që është në kurriz të shqiptarëve, dhe në kontratë nuk thuhet fare sa është fitimi i shtetit shqiptar nga ky koncesionim i këtij shërbimi. Nuk ka vend në botë që zgjat një koncesionim, që në kontratën fillestare ka qenë parashkuar për pesë vjet, edhe për dhjetë vjet

të tjera. Të paktën në këtë aspekt duhet të ishit seriozë, duhet të kishit respektuar afatin e parashikuar në kontratën fillestare, të paktën edhe pesë vjet të tjera.

Sigurisht, ju keni marrë masat se do të humbni më 23 qershor të 2013-s, do të humbni dhe në 2017-n, por paskeni parashikuar se do të humbni edhe në 2021-in, dhe po jepni kontratë që të mbarojë në 2023-shin. Kjo është çështja juaj!

Kur po lexoja këtë kontratë dje, zbuluam edhe një mashtrim publik patriotik të Sali Berishës, përsa i përket pasaportave për vëllezërit tanë kosovarë. Me këtë kontratë Saliun e nxorët bosh me premtimin e bërë për të dhënë pasaporta për vëllezërit kosovarë, sepse keni vënë kushte, keni vënë limite, të cilat nuk mund të mundësojnë më pajisjen me pasaporta të qytetarëve shqiptarë me origjinë nga Kosova, apo vëllezërit tanë kosovarë në tërësi. Palët presin që gjatë periudhës së zgjatur të koncesionit nga 25 korrik 2013 deri në 31 korrik 2023, volumi i dokumenteve të identifikimit do jetë 3.4 milionë për kartat e identitetit dhe 3.4 milionë për pasaporta, ndërkohë që ne sot jemi pranë këtij limiti që ju parashikoni në kontratë. Zoti Ministër, sigurisht ti nuk e ke lexuar kontratën, por kjo është shkruar këtu në kontratë, pavarësisht se e ke firmosur.

Shkojmë te problemi tjetër, te çmimet. Pse na gënjeni kur sillni relacionin? Thoni se çmimet e kartave do të rriten jo më shumë se 25 për qind, ndërkohë që ti, more zotëri, në kontratë ke parashikuar rritjen e çmimeve 25 për qind. Më 1 janar 2015 karta e identitetit nuk do të jetë më 12 mijë lekë, por do të jetë 15 mijë lekë. E ke në kontratë, 25 për qind është rritur! Mos gënje në relacion duke thënë “jo më shumë se...”, por thuaj se do të rritet 25 për qind! Pasaporta është 60 mijë lekë, do të bëhet 75 mijë lekë. Edhe kjo rritet me 15 mijë lekë.

Zotëri, për çfarë arsye u rritka çmimi i pasaportës dhe i kartës me 25 për qind? Unë nuk gjej arsye për ta votuar këtë kontratë për shkakun se ju, zotëri, nuk interesoheni për qytetarin shqiptar, juve ju intereson pazari, juve ju intereson fitimi i kompanisë. Çfarë duhet të ishte parashikuar në këtë kontratë? Në shtojcën 11 duhet të kishte një seksion 7, i cili të parashikonte rastet e të gjithë atyre qytetarëve shqiptarë që sot kthehen në kufijtë e Greqisë për

shkak të një gabimi te kryer po nga kompania në fjalë.

E dini ju cila është arsyeja që qytetarët shqiptarë, fëmijët e të cilëve kanë lindur në Greqi dhe toponimi i emrave në këto pasaporta është i papranuar nga pala greke, është krijuar po nga pala shqiptare? Po nga kompania pse? Sepse për një pasaportë që lëshohet në Shqipëri dhe qytetari i pajisur me këtë pasaportë ka vendlindjen “Selanik”, në Shqipëri kur lëshohet pasaporta shkruhet “Selanik”, ndërsa kur e lëshon konsullata jonë në Selanik e shkruan “Thessaloniki”. Problemin e ka shkaktuar pala shqiptare, e cila për të njëjtin toponim ka lëshuar dy identifikime: njëën “Selanik” dhe tjetrën “Thessaloniki”. Kjo mua nuk më intereson. Është faji juaj dhe e mbani ju përgjegjësinë. Ajo që më intereson mua është që ne në momentin që ratifikojmë këtë kontratë t’i gjendemi pranë familjeve shqiptare që jetojnë sot në Greqi dhe të shtojmë një pikë 7 në shtojcën 11, ku të themi: “Kompania merr përsipër që për të gjithë shqiptarët, qytetarët shqiptarë, për të cilët toponimi në pasaportë është jo i përafuar me konventat ndërkombëtare të emërimit të vendeve të caktuara, kompania të marrë përsipër ridhënien e një pasaporte të re me emërtim të pranuar edhe nga pala tjetër”.

Sot e kemi këtë problem me Greqinë, ku i dihet, mbas disa vitesh na del një problem me një vend tjetër. Atëherë, në një kontratë koncesionare që ju synoni me vendim Parlamenti ta jepni për dhjetë vjet, të paktën ne t’i gjendemi pranë familjeve shqiptare që vuajnë sot problemet në kufi t’i themi: Po, pasaporta që ju është lëshuar me atë toponim, shkoni në pikën e pajisjes me pasaporta, dorëzoni pasaportën e vjetër! Gjithë atë fitim që ka garantuar kjo kompani në kaq vjet, i ka mundësitë që për këta qytetarë shqiptarë t’ua bëjë falas zëvendësimin e pasaportës. Mendoni njëherë të vetme, dreqi e marrtë, për qytetarët shqiptarë! Ju mendoni vetëm për vete dhe vetëm për kompanitë. Mjaft më, ia keni bërë nderin kësaj kompanie saqë nga kjo kontratë koncesionare ka fituar të paktën 100 milionë euro! Nuk i prish punë nëse harxhohen 50 mijë apo 100 mijë euro për ato pasaporta të atyre qytetarëve shqiptarë që jetojnë sot në Greqi apo jetojnë sot në Shqipëri, të cilët në toponimin për vendlindjen në pasaportën e tyre kanë një problem të shkaktuar nga qeveria greke, nga

qeveria jonë, nga kompania, nuk ka rëndësi kush e ka bërë problemin, e rëndësishme është që të zgjidhim problemin, dhe sot përmes kësaj kontrate ne mund ta zgjidhim këtë problem. T'i vëmë kusht kompanisë që të dëmshpërblejë falas rinovimin e pasaportës për çdo qytetar shqiptar që ka këtë problem në pasaportën e vet, që ai të lëvizë lirshëm, të përfitojë nga procesi i liberalizimit të vizave.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Zoti Ministër, urdhëroni!

**Flamur Noka** - Faleminderit, zonja Kryetare!

Zoti Balla, preke tri pika që i konsideron se janë problematike dhe nuk ishe i qartë.

Për sa i përket çështjes së zgjatjes së koncesionit, ju e dini, si të gjithë deputetët e tjerë, që ai jepet me një afat shumë më të gjatë, 20-25-30 vjet. Ky ka qenë për 5 vjet. Fillimisht, ky është dhënë për 5 vjet, pasi për Shqipërinë futja e një teknologjie dhe standardi të tillë ishte një risi për të. Para 5 vjetësh nuk ishim në gjendje. Tashmë, fatmirësisht, ky koncesion ka rezultuar si një nga koncesionet më të suksesshme në vendin tonë. E thashë edhe pak më parë, fatmirësisht sot, po të lexojmë edhe në mediat ndërkombëtare, bëjmë pjesë në 5 vendet me dokumente identifikimi më të sigurta në botë, vijmë pas SHBA-ve. Duke qenë se jemi shumë të kënaqur nga ky bashkëpunim me kompaninë e kemi riparë dhe kemi marrë në konsideratë mundësinë e shtyrjes së këtij koncesioni.

Pse them që është i suksesshëm? Përveç sigurisë, mund t'ju them se nga dita që është themeluar shteti shqiptar deri në ditën që kjo kompani ka marrë këtë koncesion, në Shqipëri kanë qenë prodhuar gjithsej 2.6 milionë dokumente identifikimi. Në këta 5 vjet, kjo kompani ka mundësuar 2.7 milionë dokumente identifikimi të sigurisë më të lartë me standarde mjaft të mira.

Së dyti, për sa i përket problemit të çmimit dua të them se deri në vitin 2015 nuk ndryshon. Pra, do të ketë këtë teknologji dhe standard deri në vitin 2015. Në vitin 2015 do të ketë ndryshim të çmimit. Pse? Sepse në vitin 2015 ne do të mundësojmë që çipi të zmadhohet nga 72 kb, që është sot, do të bëhet 100 kb; do të pranojë të dhënat për bankën, për sigurimet shoqërore, për kujdesin shëndetësor dhe shqiptarët nuk do të

kenë më nevojë të mbajnë dosje letrash. Pra, kjo është një arritje e madhe e teknologjisë.

Së treti, brenda çipit do të jetë edhe njohja e fytyrës. Pra, të gjitha këto kanë një kosto. Pra, në vitin 2015 kur të futen këto elemente do të ketë rritje të kostos dhe të çmimit.

Për sa u përket dokumenteve të identitetit të shqiptarëve që lindin në Greqi. Kjo pikë nuk ka nevojë të futet në kontratë, pasi prej disa muajsh, bashkë me Ministrin e Jashtme, jemi në negociatë me qeverinë greke për të gjetur një formulim. Dhe ne i kemi ofruar variantin tonë dhe po presim përgjigje. Në pasaportat shqiptare nuk mund të shkruhen të dhënat në shqip, sepse ka emra të gjatë dhe çipi mban vetëm 24 karaktere.

*(I drejtohet zotit Balla, i cili flet nga vendi.)*

Taulant, maksimumi janë 500 qytetarë që kanë këtë problem. Ato pasaporta do të ndryshojnë. Kjo është një çështje që zgjidhet.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, zoti Braçe, urdhëroni!

**Erion Braçe** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Zoti Ministër, kolegët e mi i paraqitën një pjesë të problematikave, që na shqetësojnë lidhur me këtë kontratë koncesioni. Fillimisht, dua t'ju them, apo t'ju vija në dukje faktin se brenda këtyre dy muajve të fundit, ky është koncesioni i pestë apo i gjashtë që vjen në parlamentin e Shqipërisë. E thashë edhe pak më parë gjatë diskutimit për koncesionin tjetër, atë të skanimit të kontenerëve dhe kamionëve në pikat kufitare të Shqipërisë dhe po e them edhe tani, se kjo nuk është mënyra më e mirë për ta shndërruar atdheun publik në një atdhe privat; kjo nuk është mënyra më e mirë për t'u ofruar shërbime qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për disa arsye, por mbi të gjitha, kjo nuk është mënyra më e mirë për t'u përballur me elemente shumë të rëndësishme të sigurisë kombëtare, siç është identifikimi i shtetasve apo kontrolli në pikat kufitare, veçanërisht për qarkullimin e mallrave që mund të bëhen shumë lehtë objekt i trafikimit ndërkombëtar të paligjshëm.

Zoti Ministër, për hir të së vërtetës, kjo kontratë nuk ka mbaruar ende. Ajo duhet të mbarojë në korrik. Ju vërtet folët këtu dhe dhatë një arsye për afatin e shkurtër ekzistues të kontratës në fjalë, por pikërisht në kontratën që



është ende në fuqi, në kapitullin 3/2, periudha e koncesionit, janë të parashikuara qartë rastet dhe praktikat se kur kjo kontratë shtyhet. Argumenti që ju sollët këtu për ta shtyrë këtë kontratë nuk është askund i parashikuar këtu, dhe për më tepër praktika që ju po prezantoni këtu nuk është e parashikuar në kontratë. Ky është problem i rëndësishëm, për sa u takon dokumenteve që vijnë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe kur bëhet fjalë për shërbimet ekskluzive monopol, që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me detyrimin e qytetarëve për t'i blerë ato.

Le të vijmë te kontrata. Kam dy probleme, ashtu si edhe kolegët e mi. I pari është problemi i natyrës ekonomike. Po e përsëris për të disatën herë: kemi të bëjmë me një shërbim publik, shërbimin e identifikimit dhe pajisjes së shtetasve me dokument identifikimi, i cili nuk është i ndarë sipas kategorive sociale. Është e drejta e gjithkujt në këtë vend, pavarësisht pasurisë, të ardhurave etj., me radhë, të pajiset me këtë dokument identifikimi, për më tepër kur qeveria e Republikës së Shqipërisë e ka vendosur kartën e identitetit si një nga elementet themelore për të marrë shërbime në të gjitha administratat e shtetit. Pikërisht në këtë moment ka prioritet edhe ana ekonomike e kontratës. Prandaj ne po e adresojmë këtë shqetësim.

Pak më parë unë pyeta se cila është kostoja e prodhimit të kartës së identitetit dhe e pasaportës. Nuk mora asnjë përgjigje. Pyeta nisur nga problemi social që ka shpërndarja e kartave të identitetit dhe e pasaportave. Gjithashtu, pyeta edhe për një element tjetër: Cila është norma e fitimit e të gjithë këtyre kompanive, që ne po u japim shërbime ekskluzive dhe që përkundrejt të cilave qytetari shqiptar është i detyruar të shkojë ta marrë? Dua të them se kur u nënshkrua kjo kontratë edhe për dokumentet aktuale të identifikimit, çmimi ishte i shtrenjtë. E kemi bërë këtë debat në sallën e Kuvendit dhe kemi pranuar se çmimi është rritur disa herë dhe është i shtrenjtë. Rritja e re e çmimit prej 75 mijë lekësh për pasaportën dhe 15 mijë lekë për kartën e identitetit, pra, 90 mijë lekë në total, e bën të papërballueshme. Mjafton t'ju them se është e barabartë me dy muaj ndihmë ekonomike; mjafton t'ju them se është e barabartë gati me një pension. Pra, pavarësisht se fillon nga 1 janari i vitit 2015, ai është i shtrenjtë.

Nga ana tjetër, përfitimi i kompanisë nga ky koncesion është shumë i madh.

Zoti Ministër, unë kam të dhënat e bilancit të kompanisë për vitin 2011. Dëgjojeni me vëmendje shifrat!

Kompania renditet e 34-ta ndër 100 kompanitë me xhiron më të madhe në vend, me vlerën prej 53 milionë dollarë, 5.3 miliardë lekë të rinj. Kompania renditet e 11-ta në listën e 100 kompanive me fitimin më të lartë në vend dhe ka një fitim të deklaruar prej 13.4 milionë dollarë, 1.3 miliardë lekë të rinj. Norma e fitimit në bazë të këtyre të dhënave është 25.2%.

Më tregoni një biznes tjetër në këtë vend që normën e fitimit e ka 25.2%! Është veprim i thjeshtë matematikor.

Nga ana tjetër, qeveria e Republikës së Shqipërisë merr një *fee* koncesionare, që është 5% dhe ka përfituar vetëm 2.6 milionë dollarë. A e kuptoni se çfarë përmasash ka përfitimi i kësaj kompanie? Në të tilla kushte si mund të pranojmë që të negociojmë rritje akoma më të madhe të çmimit të këtyre dokumenteve, që çojnë drejtpërdrejtë, në të dyja anët, në lekë që paguajnë më shumë qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe, nga ana tjetër, para që përfiton më shumë kompania koncesionare, të cilës ne i kemi dhënë monopolin e identifikimit dhe të pajisjes së shtetasve me dokumente identifikimi. Për nga ana ekonomike kjo merr një rëndësi shumë të madhe në këtë vend, për sa kohë që bëhet fjalë për një vend të varfër dhe për familje, që jetojnë në kushtet e një varfërie që vijon dhe shtohet.

Elementi i dytë dhe më i rëndësishmi ka të bëjë me sigurinë e sistemit. Unë jo më kot iu referova relacionit tuaj dhe natyrisht jo më kot bëra edhe ato pyetje. Në relacion ju thoni se do të shtoni apo do të përmirësoni element të sigurisë në kartën e identitetit që shmangin falsifikimin. Çfarë ka ndodhur deri më sot? Ju, si ministër i Brendshëm keni raste; Policia e Shtetit ka raste; Prokuroria e Përgjithshme ka raste që kanë identifikuar nga hetimet që kanë dalë në mënyrë të qartë se identiteti i shtetasve nuk është plotësisht i sigurt. Pra, ka shtetas që kanë marrë një identitet të dytë. E dini se nga buron kjo, zoti Ministër? Nga e gjithë tentativa për të manipuluar zgjedhjet.

Kam grupe familjesh, sepse këtu ka nisur, nuk ka nisur drejtpërdrejtë te prodhimi i kartave

të identitetit. Jo. Ka nisur te qëllimi i mirëfilltë për të manipuluar zgjedhjet. Këtu ndryshon emri i njërit prej përbërësve të familjes dhe shpiket një familje tjetër e tërë. (*Tregon dokumentet.*) Ja ku është, një familje tjetër. Me këtë identitet, zotëria ka marrë karta identiteti dhe ja ku janë kartat e identitetit, me numra. Këto i ka provuar prokuroria e Përgjithshme.

(*I drejtohet zotit Noka, i cili flet nga vendi.*)

Tani në qoftë se do ta përgënjeshtrosh, përgënjeshtroje! Shko në Prokurori, raportin e hetimit e ke! Prokurorinë e ke tënden! Shko, verifikoje dhe zgjidhe këtë problem!

Ky identitet i rremë ka filluar të tregtohet në individë të ndryshëm lart e poshtë Shqipërisë që e blejnë këtë identitet. Tregtohet tek ata persona, që kanë marrë penalitete në vendet fqinje. Pra, këta persona nuk mund të kthehen më në vendet fqinje. Mos më thoni që nuk e keni këtë problem! E keni, dhe e keni problem të rekomanduar edhe nga BE-ja. Pra, siguria e sistemit në momentin që me të njëjtat gjurmë gishtash paraqitet i njëjti person, por me emër tjetër, natyrisht është vënë në diskutim dhe këtë e thoni ju në relacionin tuaj. Nuk e them unë, por ju. Prandaj keni futur policinë që ta verifikojë; prandaj keni futur Gjendjen Civile që ta verifikojë; prandaj keni futur një sërë institucioneve të tjera shtetërore që ta verifikojnë këtë problem. Pra, janë dy elemente të rëndësishme, që bashkohen me njëra-tjetrën, ana ekonomike dhe siguria e sistemit.

Sot kemi gjithë ditën që flasim për koncesione. Jua thashë pak më parë se kjo praktikë e koncensimit të çdo lloj shërbimi në kushtet e eskuzivitetit, në kushte monopoli, për më tepër kur qytetarët janë të detyruar të shkojnë ta marrin atë shërbim nga ligjet e tjera në fuqi, siç janë: ai i kontrollit të automjeteve, kasave fiskale, pullat fiskale, markimi i karburanteve, skanimit, që e diskutuam sot, dhe kjo e fundit e pasaportave, sjellin në vëmendje një fakt shumë të rëndësishëm; jua përsërita edhe më parë: për 10 deri 15 vjetët në vijim qytetarët do të paguajnë mbi 1 miliard euro nga paratë e tyre. Kjo është një supertaksë që po u vendoset të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Kjo është e papranueshme për ne, sepse ndikon drejtpërdrejtë në buxhetet familjare dhe, nga anën tjetër, po shton dhe po fryn deri në fund buxhetet e këtyre koncesionarëve, të cilëve u

keni dhënë një Shqipëri të tërë publike, duke e kthyer në Shqipëri private.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së, zoti Ministër, urdhëroni!

**Flamur Noka** – Faleminderit, zonja Kryetare!

I nderuar zoti Kryeministër!

Të nderuar kolegë deputetë,

Si ministër i Brendshëm ky është një rast dhe një privilegj i veçantë që më jepet mundësia të prezantoj këtë projektligj të kontratës koncesionare, zgjatjen për një periudhë 10-vjeçare të bashkëpunimit tonë të përbashkët me koncesionarin. Ky është një bashkëpunim që i dha jetë administrimit publik në këtë vend.

Me këtë projekt Shqipëria hyri në erën e re të dokumenteve dixhitale, falë teknologjisë së lartë të ofruar; falë kombinimit optimal të elementeve të sigurisë me ato biometrike; falë pranisë kudo në territorin e vendit; falë shpejtësisë maksimale të ofruar.

Projekti ka dhënë një kontribut të patjetërsueshëm në arritjen e standardeve të larta europiane dhe atyre botërore për pajisjen me dokumente identifikimi dhe kryerjen e standardeve të Kopenhagenit të zgjedhjeve të vitit 2009 e në vazhdim. Pra, mund t'ju them se sot ky projektligj ishte një domosdoshmëri për të ardhur në parlament, pasi në korrik përfundon kontrata me koncesionarin. Sigurisht kontratën, që ju përmendët, zoti Braçe, duhet të negocionim që para 6 muajve. Ne kemi negociuar me kompaninë dhe ka qenë bindja jonë e përbashkët që këtë sukses madhor ta konsolidojmë më tej, me qëllimin që të adaptojmë të gjitha standardet më të larta që ka sot bota e qytetëruar për sa i përket identifikimit biometrik.

Kjo është një kompani ndër më të mirat dhe më cilësoret në botë. Është një kompani që ka një standard Iso 27 000 dhe konsiderohet standardi më i lartë për sa u përket prodhimit të dokumenteve të identitetit dhe të sigurisë së prodhimit të këtyre dokumenteve.

Ju, zoti Braçe, përmendët disa pika që i kishit problem, ndaj po i sqaroj përsëri. Ju thoni se kjo nuk është mënyra më e mirë. Zotëri, më thuaj një shembull, apo të çdo kolegu të grupit tënd parlamentar, të një mënyre tjetër të prodhimit të këtyre lloj dokumenteve përveçse me kompani koncesionare.

E dyta, ju thoni pse nuk e kemi sanksionuar në ligj çështjen e prodhimit, detyrimit të kompanisë për prodhimin e pasaportave për shtetasit shqiptar që jetojnë në Greqi. Unë e sqarova dhe po e sqaroj përsëri. Në bazë të ligjit, koncesionet mund të kalonin me VKM. Ne kemi bërë një projektligj, sepse me anë të tij dëshmojmë vullnetin maksimal politik për të qenë transparentë në çdo hap të kësaj procedure që ne po ndjekim. Ligji lejon që ta kalonim me VKM. Ne e sollëm vetëm për të qenë transparentë. Edhe para 5 vjetësh e kemi sjellë vetëm për të qenë transparentë. Kjo është filozofia jonë. Ne nuk kemi asgjë për të fshehur.

Ka ndokush prej jush vërejtje për cilësinë? Ka dalë zoti Ruçi këtu me disa karta të klonuara dhe ka thënë që janë dokumente të falsifikuara. Nuk kaloi një javë dhe e gëlltitët këtë që thatë. Nuk keni guxuar ta përmendni më. Thatë se i keni çuar në prokurori. Ju ato i keni çuar në shtëpi. Këto dokumente identifikimi, që prodhohen sot nga koncesionari ynë, janë 100% të sigurta, të pamanipulueshme dhe të pafalsifikueshme.

Ky nuk është thjesht vlerësimi ynë, por i të gjitha vendeve, ku ne kemi mundësi lëvizjeje të lirë. Pra, në të gjitha vendet e “Shengenit”, që shqiptarët lëvizin thuhet se dokumentet e Shqipërisë janë dokumente me standarde më të larta se të një pjese të mirë të vendeve të BE-së. Këtë duhet ta pranoni që është një sukses madhor.

Problemi tjetër ishte çështja e çmimit. Tani nuk i mban askujt të marrim letra e t'i nxjerrim këtu, duke thënë: “Ja, se kemi dokumente”. Jo, ato që thatë ju, janë të gjitha gënjeshtër, zoti Braçe dhe tërësisht të pavërteta. Nxore një listë dhe the: “Ndërron emrin, ndërron një shkronjë dhe pastaj bëhet i pakapshëm në sistemin TIM-s”. Jo, zotëri, mund ta ndërrosh emrin, ose mbiemrin tëndin dhe të gjithë familjes; mund të ndërrosh të gjitha të dhënat e emrit dhe të mbiemrit, por në Shqipëri ka një numër identifikimi që është unik. Mund ta kesh ndërruar 20 herë emrin; mund ta kesh ndërruar 30 herë mbiemrin; mund të kesh marrë 5 dënime, por ti e ke në të gjithë sistemin TIM-s që është i montuar në territorin e Republikës së Shqipërisë në të gjitha pikat kufitare. Me një klikim ti rezulton ai i pari, që ke qenë para se ta ndërroje emrin dhe mbiemrin. Pastaj i ke të gjitha të

dhënat se sa herë e ke ndërruar emrin dhe mbiemrin. Pra, nuk ka mundësi. Ti mund të aplikosh për një dokument të ri identifikimi, por në momentin që të dhënat, kur ke kërkuar për dokumentin e ri të identifikimit, të hidhen në sistem në mënyrë të menjëhershme. Të gjitha dokumentet e mëparshme që ti ke pasur dalin të jashtëligjshme. Kjo është e vërteta. Gënjeshtër mund të thoni, por e vërteta është kjo.

Zoti Braçe, për sa i përket koston, po të shohësh kontratën deri në vitin 2015, ajo është e palëvizshme. Edhe çmimi po ashtu. Tani, ti apo të tjerët, mund ta merrni pasaportën me koston e një pasaporte që prodhohej te rruga e Elbasanit në kohën kur ju qeverisnit. Ishin një tufë letrash të ngjitura me kapse dhe quhej pasaportë. Jo, zotërinj! Ky është dokument që i bën krenarë shqiptarët kudo që shkojnë. Ky është një ndër dokumentet më të sigurta. Nuk është letër bakalli, siç prodhoni ju dikur dhe i ndërruat edhe vetë. I mbani mend? Miliona pasaporta mbetën stivë në zyrat e Ministrisë së Brendshme, sepse ishin të gjitha jashtë standardeve. Sigurisht, kur prodhon një dokument me cilësi dhe me standard të tillë, ka një kosto. Koncesionari, si çdo biznes tjetër, nuk vjen të punojë nën kosto. Sigurisht, do të pranojë koston dhe fitimin e vet. Dhe minimumi është caktuar 20%.

Në vitin 2015 do të rritet çmimi, sepse do të hyjnë elemente të rinj të sigurisë. Përveç elementeve biometrike që ka sot, do të futet edhe njohja e fytyrës. Sot ju thatë se çipi ka 72 kb, por do të bëhet 100, sepse veç njohjes së fytyrës do të ketë hapësirë për të mbajtur të gjitha të dhënat e sigurimeve shoqërore, sigurimet e kujdesit shëndetësor, të bankës apo të çdolloj shërbimi tjetër. Pra, nesër qytetari nuk do të shkojë me një tufë dosjesh, siç shkonte në kohën kur qeverisnit ju, por do të ketë një kartë, e cila do t'i ketë të gjitha të dhënat.

Kjo është arritja dhe këtë nëse nuk e pranoni, të paktën mos e sulmoni.

Faleminderit!

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zoti Ministër!

Urdhëroni, zoti Kryeministër!

**Sali Berisha** – Zonja Kryetare,

Zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Jam sot këtu në parlament për të denoncuar një akt të paprecedentë në historinë e shtetit

shqiptar, i cili përbën aktin më të rëndë ndoshta në tërë historinë diplomatike dhe politike të takimeve dhe konferencave.

Ky akt qëndron në agresionin e rëndë, të turpshëm, brutal, shtazor, që kryetari i Partisë Socialiste dhe kryetari i koalicionit të pazareve dhe të ngjalave bëri ndaj njërit prej diplomatëve të rinj më të përgjegjshëm dhe më të përgatitur të këtij vendi. Unë dua të informoj shqiptarët se dje në një nga sallat më prestigjioze të Austrisë, ku zoti Rama mbante një konferencë, në Akademinë Politike të Vjenës, i sponsorizuar nga Partia Socialdemokrate austriake dhe një piktor shqiptar, pas ekspozesë së tij, pasi thotë gjithçka dhe lexon trillimet e mashtrimet e tij ndaj vendit dhe kombit të tij, duke dalë, pasi mbyllet konferenca, ai humbi tërësisht kontrollin kur e pyetën për gjëra të ndryshme. Janë të dokumentuara gjërat. Njëri nga dy diplomatët që ishte aty, qoftë edhe për t'i shërbyer zotit Rama, siç kanë porosi të gjitha ambasadat të trajtojnë zyrtarisht çdo funksionar dhe qytetar të pozitës apo të opozitës, ndër më korrektët, më të përkushtuarit, më të civilizuarit, i shtron pyetjen zotit Rama dhe i thotë: "Si ka mundësi që ju flisni në këtë mënyrë për vendin tuaj?" Pyetjes që iu bë në sallë nga emigrantët "Pse nuk lejohemi të votojmë në ambasadë", zoti Rama iu përgjigj: nuk do të lejohet sepse diplomatët janë hajdutë votash.

"Zoti Rama, - i thotë diplomati i ri, - ne jemi këtu për të shërbyer, nuk jemi hajdutë votash. Si mund të na quash hajdutë?" Kjo mjaftoi për të shtrirë dorën dhe grushtin e pakontrolluar drejt diplomatit në prani të dhjetëra e dhjetëra vetëve. Kjo mjaftoi për t'u lëshuar në sharje prej rrugaçi të mirëfilltë, me regjistër të gjendjes civile, ndaj familjes së diplomatit. Kjo mjaftoi për të dalë jashtë çdo lloj kontrolli dhe u bë një ndërhyrje e fuqishme nga të gjithë të pranishmit, sepse donte ta agresonte edhe më tej diplomatin e ri.

Të nderuar zotërinj, këtë akt të turpshëm, këtë akt të përsëritur të tij edhe ndaj jush, që jeni këtu (po juve mirë jua bën, i keni provuar mirë ju këto), unë e denoncoj në mënyrën më të ashpër. Është një akt i turpshëm, akt violent, akt brutal, amoral, i një njeriu që ose humbi çdo kontroll të fakulteteve të tij psikike, ose ishte ashtu siç e akuzojnë rëndom, nën efektin e dozave të mëdha. Por cilado që të jetë arsyeja, ky është akti më i

turpshëm. Akt të tillë në ambasada nuk kanë realizuar as etërit e zotit Rama. Por ju në këtë histeri kolektive që ju kap këtu për ta mbrojtur duhet të mendoni se ai mund të ishte djali juaj, se ai mund të ishte vëllai juaj, se ai mund të ishte njeriu juaj dhe se ai është një nga djemtë më të sjellshëm të diplomacisë shqiptare. Në historinë e politikës botërore, në Ugandën e viteve '80, ishte një person, kryetar qeverie, që quhej Idi Amin. Ai u bë i famshëm sepse me grushta rrihte ministrat e kabinetit të tij. Idi Amin Dada përfundoi në koshin e historisë. Ju garantoj se kryetari juaj do të përfundojë njësoj aty ku e meriton. Për cilin prej jush thuhet se ka rrahur gruan shtazërisht? Për cilin prej jush thuhet se ka rrahur nënën si kafshë? Për cilin prej jush thuhet se ka goditur bashkëpunëtorët e tij në zyrë? Për asnjërin prej jush nuk thuhet, për asnjërin prej jush nuk thonë një mijë e një. Të gjitha këto: se ai humbet çdo kontroll, se ai ka probleme të rënda psikike ose probleme overdozash, ai i faktoi dje në Akademinë Politike të Vjenës. Nëse doni, jemi gati që në këtë parlament të sjellim jo një, por 30 dëshmitarë, nëse doni urdhëroni komisionin hetimor, urdhëroni të krijojmë komision hetimor. Është prekur diplomacia me dhunë. Urdhëroni! Ne do të krijojmë komision hetimor.

E dini si më dukeni ju? Ju jeni ulur të gjithë në çifte, si Kostandini me Dhoqinën. E dini vetë ju! Keni parë, s'keni parë: një të vdekur me një të gjallë. Jeni të pashpresë. Ju ka hequr nga lista. Bërtisni sa të mundeni, por në listë nuk jeni.

Zoti kryetar i grupit, i propozoj grupit parlamentar të ngrejë komision hetimor parlamentar për këtë akt të turpshëm.

Ditën e hënë ky parlament do të votojë komisionin hetimor parlamentar për të hetuar deri më një aktin e paprecedentë, të turpshëm dhe amoral, aktin që nuk ka ndodhur kurrë në historinë e këtij shteti, aktin e agresionit ndaj një diplomatit të ri nga kreu i opozitës në një moment sfazimi total bipolarizmi. Absolutisht, që të gjitha do të bëhen dhe ditën e hënë do të votohet këtu komisioni, edhe më shumë për shkak të reagimit tuaj.

*(Ndërhyrje nga salla.)*

Ju e keni faktuar se sa mund të na pengoni ne. Ai ju tërheq ju nga gropa në gropë, nga humbja në humbje, nga turpi në turp, nga disfata në disfatë. Ne komisionin do ta ngremë.

**Jozefina Topalli** – Faleminderit, zoti Kryeministër!

*(Ndërrhyrje nga salla)*

Deri më 20 maj do të jeni këtu në parlament. Mos hajdeni, po deshët!

Po, zoti Kryeministër.

**Sali Berisha** – Kryeministri do të përdorë të drejtën e tij kushtetuese për të thirrur parlamentin në çdo kohë dhe për të ngritur komisionin hetimor parlamentar.

Po, bëni ç'të doni!

*(Ndërrhyrje nga salla.)*

Sigurisht, kur rriheni, nuk flisni, sepse doni të jeni në listë. Ai nuk ka kërkuar listë. Ai ka kërkuar dinjitet njerëzor. Mos kini merak!

**Jozefina Topalli** – Po, zoti Ruçi.

**Gramoz Ruçi** – Sigurisht, e prita Kryeministrin deri në fund të seancës. Mendova se do të shprehte ndonjë gjë për problemet që ka vendi, për ato projektligje që diskutuam sot, që qeveria dhe Kryeministri në ikje me vrap, me shumë vrap, po mundohen të plaçkisin vendin, duke privatizuar me kompani që nuk kanë para t'i japin për ato që ka shitur. Po nxitohet për të dhënë me koncesione aktivitete të dështuara deri tani, që edhe nesër në opozitë nëpërmjet këtyre koncesionarëve t'i rrjepë shqiptarët në doganë, me dokumente identifikimi, me gjithçka. Kryeministri në ikje sot ka planifikuar që me vrap të kapë dhe të konsolidojë shumicën në KLD, duke çuar Lulin e parlamentit në KLD, dhe duke çuar familjen e Lulit në KQZ dhe duke liruar vende bosh në Gjykatë të Lartë për ta kaluar përfundimisht, totalisht, Gjykatën e Lartë nën kontroll, sepse ka tmerr nga e nesërmja, do që të jetë absolutisht i imunizuar nga drejtësia në gjykatën e Shkallës së Parë, në gjykatën e Shkallës së Dytë dhe në Gjykatën e Lartë. Kësaj i thonë të mbuloresh me gjethen e fikut, zoti Kryeministër, se nesër, me institucione të kapura sot nga ty apo të pakapura, një postulat i vjetër thotë: "Drejtësia vonon, por nuk harron." Drejtësia do të vendoset. Ligji do të vendoset. Pandëshkueshmëria do të marrë fund. Imoraliteti politik dhe juridik i politikanëve shqiptarë të korruptuar dhe të inkriminuar do të marrë fund. Më kot përiqesh.

Nga ana tjetër vjen këtu dhe anatemon liderin e opozitës, kur e vetmja gjë që mund të pritej sot nga ty nuk do të ishte ky deklaram që bëre. Nuk do të ishte ajo konferencë shtypi që

dha Ministria e Jashtme, por do të ishte shkarkimi dhe lirimi menjëherë nga detyra i diplomatit që ti sot e more në mbrojtje. Kjo sepse, zoti Kryeministër, ai është lideri i opozitës dhe shkoi në një shtet ku e priti kreu i atij shteti si përfaqësues të opozitës shqiptare sot dhe si kryeministër i Shqipërisë nesër. E priti kreu i atij shteti, që zotëria juaj, sot Kryeministër, ke tre vjet që lutesh të të pres dhe nuk po të pret. Pra tërbimi yt është që e priti kreu i Austrisë dhe e dyta që ai takoi kreun e OSBE-së, sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, për të zgjidhur ato probleme që ti ke krijuar për votën e lirë dhe për zgjedhjet e 23 qershorit.

**Jozefina Topalli** – Që në fakt ia përplasi derën.

**Gramoz Ruçi** – Dhe zhvilloi një aktivitet me akademinë diplomatike në Vjenë për të dhënë vizionin e opozitës shqiptare dhe të tij si kryeministër i ardhshëm për problemet e rajonit, të Europës dhe të Shqipërisë. Midis problemeve të tjera, shqiptarë të nderuar, Edi Rama, me të drejtë dënoi, në përgjigje të interesimit të auditorit, nepotizmin, mungesën e profesionalizmit në përfaqësitë diplomatike shqiptare. Çfarë ndodhi? Pse dogji kjo? Dogji sepse emri që përmendi Kryeministri është diplomat në Vjenë dhe i ati kryediplomat në Romë. A ka nepotizëm më të madh? Dhe ky djali, i biri i babait ambasador, nuk mund ta honepste këtë punë. Veç kësaj, Kryeministër, sot mora vesh nga ato që the, se ai djali nuk ka shkuar vetë atje, sepse nuk kishte vend fare të shkonte atje. Në qoftë se do të kishte vend, ai do ta merrte vesh që shkoi lideri i opozitës dhe po të ishte një përfaqësues diplomacie i një vendi demokratik dhe shteti të së drejtës, duhet të dilte që në aeroport ta priste. Duhet të rrinte atje, në takimin me Presidentin e Austrisë. Duhet të rrinte atje, në takimin me Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, një ambasador i një vendi sovran dhe të pavarur. Ky është diplomati dhe jo ai diplomat që ti e përdor si mitingash, për të prishur takimin e liderit të opozitës dhe për t'i vënë njollë turpi Shqipërisë.

Askush s'mund ta imagjinojë në Austrinë demokratike që një diplomat karriere të shkojë në takim, të prishë takimin dhe të provokojë përfaqësuesin politik të vendit të tij. Ja pse ju si Kryeministër e merrni sot në mbrojtje një diplomat që duhet ta kishit shkarkuar që kur ka

anatemuar me shprehje aspak etike dhe diplomatike Papën. Ky është diplomati që ke ti, prandaj, zoti Kryeministër, e vetmja gjë që mund të bëje është t'i kërkosh falje Edi Ramës, popullit shqiptar dhe ta shkarkoje dhe liroje nga detyra për aktin e paprecedentë që shkaktoi ky diplomat, sipas teje karriere dhe me intelekt. Unë s'e njoh fare, por e gjykoj nga rasti. Ky është turpi i vendit tonë dhe turpi i atij që e ka bërë. Për më tepër, është turpi juaj, që e merrni në mbrojtje, në vend që të jepni shpjegime dhe të merrni masa për incidentin e ndodhur dhe shkaktarin e vërtetë të tij. S'është rasti i parë që ju e bëni këtë me liderin e opozitës. Ju kujtoj Brukselin. Jeni recidivist në anatemimin, provokimin dhe ndalimin me dhunë verbale dhe jo verbale të përfaqësuesve të opozitës në kancelaritë diplomatike të botës.

Është për të ardhur keq, por shyqyr Zotit se edhe dy muaj keni për këtë turp që i keni vënë Shqipërisë. Ata që do të vijnë pas jush do t'i vënë gjërat në rrugën e zgjidhjes, që trupi diplomatik nesër të të presë edhe ty, kur të jesh lider i opozitës, edhe deputetët e opozitës nesër, që ta përfaqësojnë Shqipërinë pa dokumente partie dhe të mos përdoren nga pushteti i ardhshëm, siç po i shpërdoroni zotëria juaj sot.

**Jozefina Topalli** – Zoti Kryeministër, urdhëroni!

**Sali Berisha** - Zonja Kryetare!

Zotërinj deputetë,

Zonja deputete,

Të dashur qytetarë shqiptarë,

Në çdo rrethanë, para çdo akti, njeriu, dinjiteti dhe integriteti i tij është dhe ka qenë mbi gjithçka tjetër.

Është e vërtetë që s'u ndala te ligjet, ndonëse ato japin një përmirësim shumë të madh dhe plotësojnë kërkesa të rëndësishme të fermerëve dhe qytetarëve tanë, shënojnë etapa të reja në modernizimin e këtij vendi, por dhunimi dhe agresimi publik dhe brutal i një njeriu në detyrë, i një diplomati të akredituar në një vend mik, nga kryetari i opozitës, përbën aktin më të rëndë, përbën akt të paprecedentë dhe më të turpshmin që i ka ndodhur ndonjëherë politikës dhe diplomacisë shqiptare.

Të nderuar zotërinj,

Së pari dua t'i informoj qytetarët se në respekt të liderit të opozitës dhe në respekt jo të personit, qeveria ime me ardhjen në pushtet i

garantoi me vendim qeverie liderit të opozitës statusin e ministrit. Praktikë e avancuar kjo vetëm e disa vendeve. I ka garantuar të gjithë mbrojtjen dhe e vërteta është se ministrat s'e kanë, por kryetari i opozitës e ka dhe do ta ketë.

Se i ndërron ai bodigardët për arsye që e dini ju vetë, ajo është puna e tij dhe jo imja; kjo s'më takon mua. Në çdo rast, për secilin prej jush, diplomatët kanë një porosi të prerë për të ofruar shërbimet që mund të ofrojnë dhe kjo porosi nuk do të ndryshojë.

Diplomatët janë sot të emëruar nga të gjitha qeveritë. Unë mund t'ju them se sot ka disa ambasadorë të emëruar nga qeveria juaj dhe ky është ndërtimi i diplomacisë. Por, t'i lejojmë vetes të përdorësh grushtin kundër një diplomati, kjo përbën aktin më të rëndë dhe më të dënueshëm.

Zotëri, meqenëse e shtrove çështjen si ish-ministër i Sigurimit të Shtetit, po të përgjigjem: Pse shkuan ata atje? Po ta them unë. Sepse zoti Fate Velaj, piktori i njohur nga të gjithë, ka shpërndarë ftesa në të katër anët, jo vetëm në Vjenë. Dhe ka bërë shumë mirë. Donte të organizonte një konferencë sa më të plotë të kryetarit të PS-së. Përgëzime! Por nuk ke të drejtë të thuash se si shkuan ata, sepse edhe ata u njoftuan. Por edhe po të mos ishin njoftuar, ata duhet të jenë në shërbim të kryetarit të opozitës. Dhe nuk u ngritën në asnjë rast gjatë fjalës së tij dhe nuk bënë asnjë pyetje. As edhe një. Kanë qenë aty mbi 100 vetë. Ndaj do të jetë komisioni hetimor që do t'ju thotë shqiptarëve çdo gjë që kanë bërë. Prekja dhe grushtimi i diplomatit të akredituar në një vend, grushtimi i një punonjësi në detyrë, përbën vepër të rëndë penale.

Meqenëse po më thonë këto, unë po ju them se ai vjen nga një familje me kryqëzim të mrekullueshëm. Ai është stërnipi i Petro Nini Luarasit, i Migjenit, prandaj të mos hyjmë në biografi. Është nipi i Skënder Luarasit, nipi i Migjenit dhe ato epitete që po i përdor kundër tij nuk të bëjnë nder.

Për të gjitha këto do të ngrihet një komision hetimor parlamentar, sepse ai nuk është jetim dhe i braktisur, por është bir i këtij vendi dhe punonjës i këtij shteti, ndaj askush nuk mund të veprojë si veproi kryetari juaj.

Për ta mbyllur, po them se përshëndes sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së dhe e falënderoj, pasi ai i kërkoi publikisht dhe

botërisht të plotësojë vendet vakante në KQZ. Ai s'më takoi mua. Mua vjen të më takojë në zyrë. Por Rama shkoi për të hequr vetullat, dhe nxorri sytë. Mori atë që s'e donte kurrë.

Për ta mbyllur me KQZ-në. Ne nuk kemi mbajtur ndonjëherë zi për vdekje politike, por 10 herë më erdhi në mendje të ngrihesha një minutë në këmbë për heshtje politike për Jani Janin.

Në muret e këtij parlamenti, në historinë e pluralizmit shqiptar, në historinë e zgjedhjeve ajo që bëtë ju me Jani Janin do të mbetet njolla më e zezë. E trajtuat si skllav një përfaqësues të minoritetit dhe një burrë me integritet, një familjar dhe intelektual, një ekspert dhe specialist. Mos kujtoni se do ta kaloni lehtë, se këtu do të vijnë votimet! Ju i shndërruat komisionerët në plaçkë tregu dhe në skllavër e hiça. Bëni ç'të doni! Po të doni plotësojini, po të doni jo! Meqenëse përmendët boksën, po ju them se më 23 qershor do të përfundoni jashtë ringut. Nokaut një herë e përgjithmonë. Po të shkruan mesazhe tani. Por unë nuk i thashë të gjitha.

**Jozefina Topalli** - Zoti Ruçi, urdhëroni!

**Gramoz Ruçi** – Së pari, unë nuk funksionoj me mesazhe dhe këtë që them besoj e keni provuar në këto 22 vjet.

Me fjalinë e fundit tuajën, se 23 qershorin e mendove ring boksën, nuk tregove asgjë më shumë, veçse faktit që je i pandryshuar; ai që ke qenë do të ngelesh, në raport me zgjedhjet e lira dhe demokratike. Këtë e dinë të gjithë shqiptarët, e dinë edhe ndërkombëtarët. E pohove edhe vetë, të paktën.

Së dyti, duke dëgjuar për djalin e Neritan Cekës, që e përmende se është sojli, nipi i Migjenit e Petro Ninit, menjëherë më vajti mendja në një fjalim në këtë podium të Neritan Cekës, babait të diplomatit që merrni në mbrojtje. E dini si ka qenë fjalimi, që mbështetej në dy fjalë: "Në politikën shqiptare ka sojli dhe sojzi".

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Rri, mor evlat, se s'ka mbaruar fjalja. Neritan Ceka quante "sojli" veten, dhe kështu është; "sojzi" të quante ty, o Sali. Është apo nuk është kështu.

E pra, ky sojliu i gjatë po zbaton porositë e sojsëzitet dhe po bëhet sojzi vetë. Ky është problemi.

**Jozefina Topalli** - Zoti Kryeministër, keni fjalën.

**Sali Berisha** - Ndaj edhe duhet vërsulur mbi të me grushte. Por të jesh i sigurt që kjo nuk do të kalojë lehtë, se është punonjësi i këtij shteti dhe agresori do të marrë të gjithë përgjegjësinë për aktin vandal, për brutalitetin që ka dëshmuar dhe agresionin që ka bërë.

**Jozefina Topalli** - Zonja dhe zotërinj deputetë, këta, kur dëgjojnë fjalën "sojli", ikin me vrap.

Hapet votimi për prezencën, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 74 deputetë të pranishëm.

Fillojmë me votimin në parim të projektligjit: "Kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë "Rapiscan Security", si koncesionar për financimin, ngritjen, dhe operimin e shërbimit të kontenerëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën e shërbimit të skanimit"

Hapet votim në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton projektligjin në parim.

Kalojmë në votimin nen për ne, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit!

Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit!

Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Faleminderit!

Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te projektligji i dytë: "Për një ndryshim në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit!

Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te projektligji "Për koncesionet dhe partneritetin publik".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

(Neni 2 deri në nenin 52 miratohen në të njëjtën mënyrë.)

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te projektligji "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Zoti Hida, urdhëroni!

**Sybi Hida** - Para se të fillojmë me nenin 1, kisha një saktësim. Meqenëse në nenin 7 dhe 8 shtyhet hyrja në fuqi deri në 1 janar 2014, kam propozimin që pas nenit 42 të shtohet neni 42/1 me këtë përmbajtje: "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji deri më 1 janar 2014, baza e llogaritjes së kontributit dhe përqindjes mbi të, të bëhet si më poshtë...", llogaritje që korrespondon me atë të nenit 10 të ligjit nr.7870 të vitit 1994.

**Jozefina Topalli** - Zoti Ministër, jeni dakord?

(Ministri shprehet dakord.)

Faleminderit!

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes INSTIS-SA dhe marrëveshjes së agjencisë INSTIS-SA ndërmejt Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për financimin e projektit të portit të peshkimit të Durrësit".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Hapet votim në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin.

Kalojmë te projektligji tjetër "Për ratifikimin e marrëveshjes INSTIS-SA dhe agjencisë INSTIS-SA ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për ndërtimin e sektorit Qukës-Qafë-Plloç të korridorit rrugor Tiranë-Korçë".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit!  
Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Urdhëroni, zoti Ministër!



**Ridvan Bode** - Desha të bëja vetëm një vërejtje përpara votimit në tërësi të ligjit.

Ky është një ligj që lidhet me një kredi që merret për ndërtimin e segmentit rrugor nga Qukësi në Qafë-Plloçë dhe nuk e konsideroj rastësi që grupi socialist largohet nga salla për të mos e votuar këtë ligj, sepse nuk kanë votuar as Rrugën e Kombit, nuk votuan as rrugën Tiranë-Elbasan, nuk votuan as rrugën Fier-Vlorë dhe nuk pranojnë të votojnë as segmentin për të shkuar në Korçë. Ky është një veprim i qëllimshëm i tyre për të mos marrë pjesë në votimin e akteve kryesore nacionale.

**Jozefina Topalli** - Faleminderit, zoti Ministër!

Atëherë, vazhdon votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë në votimin e projektligjit "Për gjendjen civile".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

*(Neni 2 deri në nenin 16 miratohen në të njëjtën mënyrë.)*

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë në votimin e projektligjit "Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimin e kontratës së koncesionit për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit "Morfo" dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? S'ka. Abstenime? S'ka.

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te vendimi për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të një projektligji: "Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 28 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi: shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar"

2. Shqyrtimi i projektligjit në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe komisioni përgjegjës bëhet brenda datës 29.04.2013

3. Paraqitja e amendamenteve në komisionin përgjegjës të bëhet deri më datën 27.04.2013.

4. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet brenda datës 2.05.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton vendimin për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar.

Kalojmë te votimi i një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator, ku janë propozuar dy emra: zoti Abaz Aliko dhe zoti Ramiz Kamani.

Është votim i fshehtë.

Hapet votimi me elektronikë për Abaz Alikon.

Mbyllet votimi.

72 pro, s'ka kundër, s'ka abstenime.

Kuvendi miraton kandidaturën e zotit Abaz Aliko si anëtar të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Ka propozim të kandidaturës së zotit Lulzim Lelçaj për anëtar të KLD-së.

Është votim i fshehtë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.  
71 pro, 1 abstenim.  
Kuvendi miraton kandidaturën e zotit Lulzim Lelçaj si anëtar të KLD-së.  
Kalojmë te votimi i dekreteve të Presidentit.

Votimi i dekretit nr.8115, datë 19.04.2013 “Për emërimin e zotit Admir Thanza anëtar të Gjykatës së Lartë”.

Ndërkohë, sekretariati i votimit të ndjekë votimin. Atëherë, unë bëj leximin e emrave, ju bëhuni gati për t’u përgjigjur.

- |                             |                                |
|-----------------------------|--------------------------------|
| 1. Abazi Sadri (Mungon)     | 40. Dokle Namik (Mungon)       |
| 2. Ahmetaj Arben (Mungon)   | 41. Doshi Tom (Mungon)         |
| 3. Alibeaj Enkelejd: Pro.   | 42. Dule Vangjel (Mungon)      |
| 4. Aliolli Ledina: Pro.     | 43. Dushaj Besnik: Pro.        |
| 5. Babasi Ndriçim: Pro.     | 44. Felaj Ermonela (Mungon)    |
| 6. Balla Taulant (Mungon)   | 45. Fino Bashkim (Mungon)      |
| 7. Bano Ilir: Pro.          | 46. Gaçi Artan (Mungon)        |
| 8. Baraj Besnik (Mungon)    | 47. Gashi Hazir (Mungon)       |
| 9. Barka Koço: Pro.         | 48. Gjana Jemin: Pro.          |
| 10. Beci Astrit (Mungon)    | 49. Gjermani Eglantina(Mungon) |
| 11. Beja Fatos: Pro.        | 50. Gjikhuri Damian(Mungon)    |
| 12. Bejtja Ilir (Mungon)    | 51. Gjonaj Adriana:Pro.        |
| 13. Bello Marko (Mungon)    | 52. Gjoni Ilir (Mungon)        |
| 14. Berisha Sali: Pro.      | 53. Gumi Viktor: Pro.          |
| 15. Bizhga Gazmir (Mungon)  | 54. Halimi Eduard: Pro.        |
| 16. Blushi Ben (Mungon)     | 55. Hasa Skënder (Mungon)      |
| 17. Boçi Luçiano: Pro.      | 56. Hida Sybi: Pro.            |
| 18. Bode Ridvan: Pro.       | 57. Hoti Paulina: Pro.         |
| 19. Bogdani Gerti (Mungon)  | 58. Hoxha Bedri: Pro.          |
| 20. Braçe Erion (Mungon)    | 59. Hoxha Fatos: Pro.          |
| 21. Bregu Majlinda:Pro.     | 60. Hoxha Ismail: Pro.         |
| 22. Bulku Rajmonda:Pro.     | 61. Hoxha Rajmond:Pro.         |
| 23. Bumçi Aldo: Pro.        | 62. Hoxha Paulina (Mungon)     |
| 24. Bushati Astrit: Pro.    | 63. Hysi Vasilika (Mungon)     |
| 25. Bushati Ditmir (Mungon) | 64. Idrizi Shpëtim: Pro.       |
| 26. Bylykbashi Aurel: Pro.  | 65. Imami Arben: Pro.          |
| 27. Cara Igli: Pro.         | 66. Isaraj Arben (Mungon)      |
| 28. Çaçi Albert (Mungon)    | 67. Islami Kastriot Pro.       |
| 29. Çipi Kreshnik: Pro.     | 68. Kadeli Gjovalin Pro.       |
| 30. Çobaj Ramiz: Pro.       | 69. Kadilli Fatbardh:Pro.      |
| 31. Çota Rrahim: Pro.       | 70. Klosi Blendi (Mungon)      |
| 32. Çuko Arben (Mungon)     | 71. Koçi Ervin (Mungon)        |
| 33. Dade Arta (Mungon)      | 72. Kodheli Mimi (Mungon)      |
| 34. Dalipi Alfred (Mungon)  | 73. Koka Lefter (Mungon)       |
| 35. Deda Eltar (Mungon)     | 74. Kola Ndue (Mungon)         |
| 36. Deda Ndrecë (Mungon)    | 75. Konomi Edison(Mungon)      |
| 37. Demi Leonard: Pro.      | 76. Ksera Spiro: Pro.          |
| 38. Doda Mesila: Pro.       | 77. Lama Ylli: Pro.            |
| 39. Dogjani Asllan:Pro.     | 78. Leka Agim (Mungon)         |
|                             | 79. Leskaj Valentina(Mungon)   |
|                             | 80. Ligor Shegush (Mungon)     |
|                             | 81. Lutaj Pirro (Mungon)       |
|                             | 82. Majko Pandeli (Mungon)     |
|                             | 83. Malaj Arben (Mungon)       |
|                             | 84. Maliqi Lefter Pro.         |
|                             | 85. Marku Mark: Pro.           |
|                             | 86. Mediu Fatmir: Pro.         |
|                             | 87. Meta Ilir (Mungon)         |
|                             | 88. Metalla Osman:Pro.         |
|                             | 89. Mima Florian: Pro.         |
|                             | 90. Minxhozi Qemal(Mungon)     |

Pro

91. Muçaj Arion (Mungon)  
 92. Naço Nasip (Mungon)  
 93. Ngresi Vasillaq:Pro.  
 94. Noka Flamur: Pro.  
 95. Oketa Gazmend(Mungon)  
 96. Olldashi Sokol: Pro.  
 97. Paloka Edi: Pro.  
 98. Paluca Ndue: Pro.  
 99. Papa Gjergji: Pro.  
 100. Patozi Astrit: Pro.  
 101. Përnaska Lajla:Pro.  
 102. Peza Dashamir(Mungon)  
 103. Pollo Genc: Pro.  
 104. Prenga Armando(Mungon)  
 105. Prifti Dritan: Pro.  
 106. Qefalia Xhemal(Mungon)  
 107. Ruçi Gramoz (Mungon)  
 108. Ruka Ethem (Mungon)  
 109. Ruli Genc: Pro.  
 110. Rusmali Ilir: Pro.  
 111. Shalsi Eduard (Mungon)  
 112. Shehu Sherefedin:Pro.  
 113. Shehu Tritan: Pro.  
 114. Shkreli Enkelejda(Mungon)  
 115. Skuqi Luan: Pro.  
 116. Spahiu Klodiana(Mungon)  
 117. Spaho Edmond:Pro.  
 118. Sterkaj Paulin:(Mungon)  
 119. Strazimiri Gent:Pro.  
 120. Subashi Armando(Mungon)  
 121. Sula Dashnor: Pro.  
 122. Tabaku Vath: Pro.  
 123. Tafaj Myqerem:Pro.  
 124. Tahiri Dashamir:Pro.  
 125. Tahiri Saimir (Mungon)  
 126. Tare Auron (Mungon)  
 127. Tavo Vangjel (Mungon)  
 128. Toçi Fatmir (Mungon)  
 129. Topalli Jozefina:Pro.  
 130. Trashani Arenca:Pro.  
 131. Turku Ardian: Pro.  
 132. Ul dedaj Gjokë:Pro.  
 133. Vokshi Albana:Pro.  
 134. Xhaçka Olta (Mungon)  
 135. Xhafaj Fatmir (Mungon)  
 136. Xheka Mehmet:Pro.  
 137. Xhepa Selami:Pro.  
 138. Xhindi Anduel(Mungon)  
 139. Xhuvani Luiza(Mungon)  
 140. Ylli Fidel (Mungon)  
 Urdhëroni, zoti Gumi!

**Viktor Gumi** – Zonja Kryetare, në votimin për zotin Admir Thanza kanë marrë pjesë 72 deputetë, 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi jep pëlqimin për këtë kandidaturë.

**Jozefina Topalli** - Faleminderit!

Atëherë, zoti Admir Thanza është anëtar i Gjykatës së Lartë dhe i bëjmë urimet më të mira.

Kalojmë te dekreti nr. 8116 “Për emërimin e zotit Tom Ndreca, anëtar i Gjykatës së Lartë”.

1. Abazi Sadri (Mungon)
2. Ahmetaj Arben (Mungon)
3. Alibeaj Enkelejd: Pro.
4. Aliolli Ledina: Pro.
5. Babasi Ndrëçim: Pro.
6. Balla Taulant (Mungon)
7. Bano Ilir: Pro.
8. Baraj Besnik (Mungon)
9. Barka Koço: Pro.
10. Beci Astrit (Mungon)
11. Beja Fatos: Pro.
12. Bejtja Ilir (Mungon)
13. Bello Marko (Mungon)
14. Berisha Sali: Pro.
15. Bizhga Gazmir (Mungon)
16. Blushi Ben (Mungon)
17. Boçi Luçiano: Pro.
18. Bode Ridvan: Pro.
19. Bogdani Gerti (Mungon)
20. Braçe Erion (Mungon)
21. Bregu Majlinda:Pro.
22. Bulku Rajmonda:Pro.
23. Bumçi Aldo: Pro.
24. Bushati Astrit: Pro.
25. Bushati Ditmir (Mungon)
26. Bylykbashi Aurel:Pro
27. Cara Igli: Pro.
28. Çaçi Albert (Mungon)
29. Çipi Kreshnik: Pro.
30. Çobaj Ramiz: Pro.
31. Çota Rrahim: Pro.
32. Çuko Arben (Mungon)
33. Dade Arta (Mungon)
34. Dalipi Alfred (Mungon)
35. Deda Eltar (Mungon)
36. Deda Ndreçë (Mungon)
37. Demi Leonard: Pro.
38. Doda Mesila: Pro.
39. Dogjani Asllan:Pro.
40. Dokle Namik (Mungon)
41. Doshi Tom (Mungon)

42. Dule Vangjel (*Mungon*)  
 43. Dushaj Besnik: Pro.  
 44. Felaj Ermonela (*Mungon*)  
 45. Fino Bashkim (*Mungon*)  
 46. Gaçi Artan (*Mungon*)  
 47. Gashi Hazir (*Mungon*)  
 48. Gjana Jemin: Pro.  
 49. Gjermeni Eglantina(*Mungon*)  
 50. Gjikhuri Damian(*Mungon*)  
 51. Gjonaj Adriana:Pro.  
 52. Gjoni Ilir (*Mungon*)  
 53. Gumi Viktor: Pro.  
 54. Halimi Eduard: Pro.  
 55. Hasa Skënder (*Mungon*)  
 56. Hida Sybi: Pro.  
 57. Hoti Paulina: Pro.  
 58. Hoxha Bedri: Pro.  
 59. Hoxha Fatos: Pro.  
 60. Hoxha Ismail: Pro.  
 61. Hoxha Rajmond:Pro.  
 62. Hoxha Paulina (*Mungon*)  
 63. Hysi Vasilika (*Mungon*)  
 64. Idrizi Shpëtim: Pro.  
 65. Imami Arben: Pro.  
 66. Isaraj Arben (*Mungon*)  
 67. Islami Kastriot: Pro.  
 68. Kadeli Gjovalin:Pro.  
 69. Kadilli Fatbardh:Pro.  
 70. Klosi Blendi (*Mungon*)  
 71. Koçi Ervin (*Mungon*)  
 72. Kodheli Mimi (*Mungon*)  
 73. Koka Lefter (*Mungon*)  
 74. Kola Ndue (*Mungon*)  
 75. Konomi Edison(*Mungon*)  
 76. Ksera Spiro: Pro.  
 77. Lama Ylli: Pro.  
 78. Leka Agim (*Mungon*)  
 79. Leskaj Valentina(*Mungon*)  
 80. Ligori Shegush (*Mungon*)  
 81. Lutaj Pirro (*Mungon*)  
 82. Majko Pandeli (*Mungon*)  
 83. Malaj Arben (*Mungon*)  
 84. Maliqi Lefter: Pro.  
 85. Marku Mark: Pro.  
 86. Mediu Fatmir: Pro.  
 87. Meta Ilir (*Mungon*)  
 88. Metalla Osman:Pro.  
 89. Mima Florian: Pro.  
 90. Minxhozi Qemal(*Mungon*)  
 91. Muçaj Arion (*Mungon*)  
 92. Naço Nasip (*Mungon*)  
 93. Ngresi Vasillaq:Pro.  
 94. Noka Flamur: Pro.  
 95. Oketa Gazmend(*Mungon*)  
 96. Olldashi Sokol: Pro.  
 97. Paloka Edi: Pro.  
 98. Paluca Ndue: Pro.  
 99. Papa Gjergji: Pro.  
 100. Patozi Astrit: Pro.  
 101. Përnaska Lajla:Pro.  
 102. Peza Dashamir(*Mungon*)  
 103. Pollo Genc: Pro.  
 104. Prenga Armando(*Mungon*)  
 105. Prifti Dritan: Kundër.  
 106. Qefalia Xhemal(*Mungon*)  
 107. Ruçi Gramoz (*Mungon*)  
 108. Ruka Ethem (*Mungon*)  
 109. Ruli Genc: Pro.  
 110. Rusmali Ilir: Pro.  
 111. Shalsi Eduard (*Mungon*)  
 112. Shehu Sherefedin:Pro.  
 113. Shehu Tritan: Pro.  
 114. Shkreli Enkelejda(*Mungon*)  
 115. Skuqi Luan: Pro.  
 116. Spahiu Klodiana(*Mungon*)  
 117. Spaho Edmond:Pro.  
 118. Sterkaj Paulin:(*Mungon*)  
 119. Strazimiri Gent:Pro.  
 120. Subashi Armando(*Mungon*)  
 121. Sula Dashnor: Pro.  
 122. Tabaku Vath: Pro.  
 123. Tafaj Myqerem:Pro.  
 124. Tahiri Dashamir:Pro.  
 125. Tahiri Saimir (*Mungon*)  
 126. Tare Auron (*Mungon*)  
 127. Tavo Vangjel (*Mungon*)  
 128. Toçi Fatmir (*Mungon*)  
 129. Topalli Jozefina:Pro.  
 130. Trashani Arenca:Pro.  
 131. Turku Ardian: Pro.  
 132. Ulledaj Gjokë:Pro.  
 133. Vokshi Albana:Pro.  
 134. Xhaçka Olta (*Mungon*)  
 135. Xhafaj Fatmir (*Mungon*)  
 136. Xheka Mehmet:Pro.  
 137. Xhepa Selami:Pro.  
 138. Xhindi Anduel(*Mungon*)  
 139. Xhuvani Luiza(*Mungon*)  
 140. Ylli Fidel (*Mungon*)  
 Urdhëroni, zoti Gumi!  
**Viktor Gumi** – Zonja Kryetare, në votimin për kandidaturën e zotit Tom Ndreca, për anëtar i

Gjykatës së Lartë, kanë marrë pjesë në votim 72 deputetë, nga të cilët 71 kanë votuar pro, 1 kundër dhe asnjë abstenim.

**Jozefina Topalli** – Atëherë, zoti Tom Ndreca emërohet anëtar i Gjykatës së Lartë.

Kalojmë te votimi i dekretit nr.8120 “Për emërimin e kryetarit të Gjykatës së Lartë, zotit Xhezair Zaganjori”.

1. Abazi Sadri (Mungon)
2. Ahmetaj Arben (Mungon)
3. Alibeaj Enkelejd: Pro.
4. Aliolli Ledina: Pro.
5. Babasi Ndrim: Pro.
6. Balla Taulant (Mungon)
7. Bano Ilir: Pro.
8. Baraj Besnik (Mungon)
9. Barka Koço: Pro.
10. Beci Astrit (Mungon)
11. Beja Fatos: Pro.
12. Bejtja Ilir (Mungon)
13. Bello Marko (Mungon)
14. Berisha Sali: Pro.
15. Bizhga Gazmir (Mungon)
16. Blushi Ben (Mungon)
17. Boçi Luçiano: Pro.
18. Bode Ridvan: Pro.
19. Bogdani Gerti (Mungon)
20. Braçe Erion (Mungon)
21. Bregu Majlinda: Pro.
22. Bulku Rajmonda: Pro.
23. Bumçi Aldo: Pro.
24. Bushati Astrit: Pro.
25. Bushati Ditmir (Mungon)
26. Bylykbashi Aurel: Pro.
27. Cara Igli: Pro.
28. Çaçi Albert (Mungon)
29. Çipi Kreshnik: Pro.
30. Çobaj Ramiz: Pro.
31. Çota Rrahim: Pro.
32. Çuko Arben (Mungon)
33. Dade Arta (Mungon)
34. Dalipi Alfred (Mungon)
35. Deda Eltar (Mungon)
36. Deda Ndreca (Mungon)
37. Demi Leonard: Pro.
38. Doda Mesila: Pro.
39. Dogjani Asllan: Pro.
40. Dokle Namik (Mungon)
41. Doshi Tom (Mungon)
42. Dule Vangjel (Mungon)
43. Dushaj Besnik: Pro.

Pro

44. Felaj Ermonela (Mungon)
45. Fino Bashkim (Mungon)
46. Gaçi Artan (Mungon)
47. Gashi Hazir (Mungon)
48. Gjana Jemin: Pro.
49. Gjermani Eglantina (Mungon)
50. Gjikhuri Damian (Mungon)
51. Gjonaj Adriana: Pro.
52. Gjoni Ilir (Mungon)
53. Gumi Viktor: Pro.
54. Halimi Eduard: Pro.
55. Hasa Skënder (Mungon)
56. Hida Sybi: Pro.
57. Hoti Paulina: Pro.
58. Hoxha Bedri: Pro.
59. Hoxha Fatos: Pro.
60. Hoxha Ismail: Pro.
61. Hoxha Rajmond: Pro.
62. Hoxha Paulina (Mungon)
63. Hysi Vasilika (Mungon)
64. Idrizi Shpëtim: Pro.
65. Imami Arben: Pro.
66. Isaraj Arben (Mungon)
67. Islami Kastriot: Pro.
68. Kadeli Gjovalin: Pro.
69. Kadilli Fatbardh: Pro.
70. Klosi Blendi (Mungon)
71. Koçi Ervin (Mungon)
72. Kodheli Mimi (Mungon)
73. Koka Lefter (Mungon)
74. Kola Ndue (Mungon)
75. Konomi Edison (Mungon)
76. Ksera Spiro: Pro.
77. Lama Ylli: Pro.
78. Leka Agim (Mungon)
79. Leskaj Valentina (Mungon)
80. Ligori Shegush (Mungon)
81. Lutaj Pirro (Mungon)
82. Majko Pandeli (Mungon)
83. Malaj Arben (Mungon)
84. Maliqi Lefter: Pro.
85. Marku Mark: Pro.
86. Mediu Fatmir: Pro.
87. Meta Ilir (Mungon)
88. Metalla Osman: Pro.
89. Mima Florian: Pro.
90. Minxhozi Qemal (Mungon)
91. Muçaj Arion (Mungon)
92. Naço Nasip (Mungon)
93. Ngresi Vasillaq: Pro.
94. Noka Flamur: Pro.

95. Oketa Gazmend(*Mungon*)  
 96. Olldashi Sokol: Pro.  
 97. Paloka Edi: Pro.  
 98. Paluca Ndue: Pro.  
 99. Papa Gjergji: Pro.  
 100. Patozi Astrit: Pro.  
 101. Përnaska Lajla:Pro.  
 102. Peza Dashamir(*Mungon*)  
 103. Pollo Genc: Pro.  
 104. Prenga Armando(*Mungon*)  
 105. Prifti Dritan: Pro.  
 106. Qefalia Xhemal(*Mungon*)  
 107. Ruçi Gramoz (*Mungon*)  
 108. Ruka Ethem (*Mungon*)  
 109. Ruli Genc: Pro.  
 110. Rusmali Ilir: Pro.  
 111. Shalsi Eduard (*Mungon*)  
 112. Shehu Sherefedin:Pro.  
 113. Shehu Tritan: Pro.  
 114. Shkreli Enkelejda(*Mungon*)  
 115. Skuqi Luan: Pro.  
 116. Spahiu Klodiana(*Mungon*)  
 117. Spaho Edmond:Pro.  
 118. Sterkaj Paulin:(*Mungon*)  
 119. Strazimiri Gent:Pro.  
 120. Subashi Armando(*Mungon*)  
 121. Sula Dashnor: Pro.  
 122. Tabaku Vath: Pro.  
 123. Tafaj Myqerem:Pro.  
 124. Tahiri Dashamir:Pro.  
 125. Tahiri Saimir (*Mungon*)  
 126. Tare Auron (*Mungon*)  
 127. Tavo Vangjel (*Mungon*)  
 128. Toçi Fatmir (*Mungon*)  
 129. Topalli Jozefina:Pro.  
 130. Trashani Arenca:Pro.  
 131. Turku Ardian: Pro.  
 132. Uldedaj Gjokë:Pro.  
 133. Vokshi Albana:Pro.  
 134. Xhaçka Olta (*Mungon*)  
 135. Xhafaj Fatmir (*Mungon*)  
 136. Xheka Mehmet:Pro.  
 137. Xhepa Selami:Pro.  
 138. Xhindi Anduel(*Mungon*)  
 139. Xhuvani Luiza(*Mungon*)  
 140. Ylli Fidel (*Mungon*)  
 Urdhëroni, zoti Gumi!

**Viktor Gumi** – Në votimin për kryetar të Gjykatës së Lartë të kandidaturës së zotit Xhezair Zaganjori, morën pjesë në votim 72

deputetë, nga të cilët 72 votuan pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

**Jozefina Topalli** - Faleminderit!

Zoti Xhezair Zaganjori emërohet kryetar i Gjykatës së Lartë.

Kalojmë në votimin e dekretit nr.8121, datë 24.04.2013 “Për emërimin e zotit Fatos Lulo, anëtar i Gjykatës Kushtetuese”.

1. Abazi Sadri (*Mungon*)
2. Ahmetaj Arben (*Mungon*)
3. Alibeaj Enkelejd: Pro.
4. Aliolli Ledina: Pro.
5. Babasi Ndrëçim: Pro.
6. Balla Taulant (*Mungon*)
7. Bano Ilir: Pro.
8. Baraj Besnik (*Mungon*)
9. Barka Koço: Pro.
10. Beci Astrit (*Mungon*)
11. Beja Fatos: Pro.
12. Bejtja Ilir (*Mungon*)
13. Bello Marko (*Mungon*)
14. Berisha Sali: Pro.
15. Bizhga Gazmir (*Mungon*)
16. Blushi Ben (*Mungon*)
17. Boçi Luçiano: Pro.
18. Bode Ridvan: Pro.
19. Bogdani Gerti (*Mungon*)
20. Braçe Erion (*Mungon*)
21. Bregu Majlinda:Pro.
22. Bulku Rajmonda:Pro.
23. Bumçi Aldo: Pro.
24. Bushati Astrit: Pro.
25. Bushati Ditmir (*Mungon*)
26. Bylykbashi Aurel:Pro
27. Cara Igli: Pro.
28. Çaçi Albert (*Mungon*)
29. Çipi Kreshnik: Pro.
30. Çobaj Ramiz: Pro.
31. Çota Rrahim: Pro.
32. Çuko Arben (*Mungon*)
33. Dade Arta (*Mungon*)
34. Dalipi Alfred (*Mungon*)
35. Deda Eltar (*Mungon*)
36. Deda Ndrecë (*Mungon*)
37. Demi Leonard: Pro.
38. Doda Mesila: Pro.
39. Dogjani Asllan:Pro.
40. Dokle Namik (*Mungon*)
41. Doshi Tom (*Mungon*)
42. Dule Vangjel (*Mungon*)
43. Dushaj Besnik: Pro.

44. Felaj Ermonela (*Mungon*)  
 45. Fino Bashkim (*Mungon*)  
 46. Gaçi Artan (*Mungon*)  
 47. Gashi Hazir (*Mungon*)  
 48. Gjana Jemin: Pro.  
 49. Gjermani Eglantina(*Mungon*)  
 50. Gjikhuri Damian(*Mungon*)  
 51. Gjonaj Adriana:Pro.  
 52. Gjoni Ilir (*Mungon*)  
 53. Gumi Viktor: Pro.  
 54. Halimi Eduard: Pro.  
 55. Hasa Skënder (*Mungon*)  
 56. Hida Sybi: Pro.  
 57. Hoti Paulina: Pro.  
 58. Hoxha Bedri: Pro.  
 59. Hoxha Fatos: Pro.  
 60. Hoxha Ismail: Pro.  
 61. Hoxha Rajmond:Pro.  
 62. Hoxha Paulina (*Mungon*)  
 63. Hysi Vasilika (*Mungon*)  
 64. Idrizi Shpëtim: Pro.  
 65. Imami Arben: Pro.  
 66. Isaraj Arben (*Mungon*)  
 67. Islami Kastriot: Pro.  
 68. Kadeli Gjovalin:Pro.  
 69. Kadilli Fatbardh:Pro.  
 70. Klosi Blendi (*Mungon*)  
 71. Koçi Ervin (*Mungon*)  
 72. Kodheli Mimi (*Mungon*)  
 73. Koka Lefter: Pro.  
 74. Kola Ndue (*Mungon*)  
 75. Konomi Edison(*Mungon*)  
 76. Ksera Spiro: Pro.  
 77. Lama Ylli: Pro.  
 78. Leka Agim (*Mungon*)  
 79. Leskaj Valentina (*Mungon*)  
 80. Ligori Shegush (*Mungon*)  
 81. Lutaj Pirro (*Mungon*)  
 82. Majko Pandeli (*Mungon*)  
 83. Malaj Arben (*Mungon*)  
 84. Maliqi Lefter: Pro.  
 85. Marku Mark: Pro.  
 86. Mediu Fatmir: Pro.  
 87. Meta Ilir (*Mungon*)  
 88. Metalla Osman:Pro.  
 89. Mima Florian: Pro.  
 90. Minxhozi Qemal(*Mungon*)  
 91. Muçaj Arion (*Mungon*)  
 92. Naço Nasip (*Mungon*)  
 93. Ngresi Vasillaq:Pro.  
 94. Noka Flamur: Pro.
95. Oketa Gazmend (*Mungon*)  
 96. Olldashi Sokol: Pro.  
 97. Paloka Edi: Pro.  
 98. Paluca Ndue: Pro.  
 99. Papa Gjergji: Pro.  
 100. Patozi Astrit: Pro.  
 101. Përnaska Lajla:Pro.  
 102. Peza Dashamir(*Mungon*)  
 103. Pollo Genc: Pro.  
 104. Prenga Armando(*Mungon*)  
 105. Prifti Dritan: Pro.  
 106. Qefalia Xhemal(*Mungon*)  
 107. Ruçi Gramoz (*Mungon*)  
 108. Ruka Ethem (*Mungon*)  
 109. Ruli Genc: Pro.  
 110. Rusmali Ilir: Pro.  
 111. Shalsi Eduard (*Mungon*)  
 112. Shehu Sherefedin:Pro.  
 113. Shehu Tritan: Pro.  
 114. Shkreli Enkelejda(*Mungon*)  
 115. Skuqi Luan: Pro.  
 116. Spahiu Klodiana(*Mungon*)  
 117. Spaho Edmond:Pro.  
 118. Sterkaj Paulin (*Mungon*)  
 119. Strazimiri Gent:Pro.  
 120. Subashi Armando(*Mungon*)  
 121. Sula Dashnor: Pro.  
 122. Tabaku Vath: Pro.  
 123. Tafaj Myqerem:Pro.  
 124. Tahiri Dashamir:Pro.  
 125. Tahiri Saimir (*Mungon*)  
 126. Tare Auron (*Mungon*)  
 127. Tavo Vangjel: Pro.  
 128. Toçi Fatmir (*Mungon*)  
 129. Topalli Jozefina:Pro.  
 130. Trashani Arenca:Pro.  
 131. Turku Ardian: Pro.  
 132. Uldedaj Gjokë:Pro.  
 133. Vokshi Albana:Pro.  
 134. Xhaçka Olta (*Mungon*)  
 135. Xhafaj Fatmir (*Mungon*)  
 136. Xheka Mehmet: Pro.  
 137. Xhepa Selami: Pro.  
 138. Xhindi Anduel (*Mungon*)  
 139. Xhuvani Luiza (*Mungon*)  
 140. Ylli Fidel (*Mungon*)  
 Urdhëroni, zoti Gumi!
- Viktor Gumi** – Në votimin e kandidaturës për detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të zotit Fatos Lulo morën pjesë në votim 74

LEGJISLATURA VII - PROCESVERBAL - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 25 PRILL 2013

deputetë, nga të cilët ishin 74 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

**Jozefina Topalli** – Me 74 vota pro, zoti Fatos Lulo emërohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen dhe për bashkëpunimin në këtë seancë me shumë ligje të rëndësishme!

Mirupafshim!

*(Seanca u mbyll në orën 17:15)*

**Sekretari për Procedurat dhe Votimin**

**Viktor Gumi**

**Kryetarja e Kuvendit**

**Jozefina Topalli (Çoba)**



